

ZYRA E EULEX-it PËR PROGRAME
ZYRA E SHEFIT TË MISIONIT EULEX KOSOVË
MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIMIN E LIGJIT

EULEX

RAPORTI PËR PROGRAMET 2010

“Bashkë ndërtojmë ndryshimin e qëndrueshëm”

LISTA E SHKURTESAVE

PeK	Policia e Kufirit
VK	Vendkalim kufitar
CCTV	Televizion ne qark të mbyllur (monitorues)
SDP	Sistemi i të drejtës penale
SIMGJ	Sistemi informativ për menaxhimin e gjykatave
ARC	Agjencia për regjistrimin civil
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
ATD	Administratat tatimore dhe doganore
NJK	Njësia korrektuese
GJQ	Gjykata e qarkut
DAK	Drejtoria për analizë të krimit
DHKEK	Drejtoria për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit
DML	Departamenti i mjekësisë ligjore
DP	Drejtori i përgjithshëm
DMH	Departamenti për migracion dhe të huaj
DKO	Drejtoria për krimet e organizuara
RDGJ	Raportet ditore të gjendjes
ECLO	Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian
KE	Komisioni Evropian
IEDDNJ	Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut
BE	Bashkimi Evropian
EU-CTA	Përkrahja e BE-së për administratat doganore dhe tatimore
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
BNJ	Burimet njerëzore
ZDNJGJ	Zyra për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore
MIK	Menaxhimi i integruar i kufirit
SIID	Sistemi informativ i integruar i doganës
ICITAP	Programi ndërkombëtar i ndihmës për trajnim në hetimet penale
NJMEI	Njësia kundër mjeteve eksplozive të improvizuara
NJAEI	Njësia kundër armëve eksplozive të improvizuara
KGJPN	Këshilli gjyqësor dhe prokuroria ndërkombëtare
NJN	Ndihma juridike ndërkombëtare
PBI	Puna policore e bazuar në inteligjencë
INP	Instrumenti i ndihmës gjatë para-anëtarësimit
DI	Të drejtat intelektuale
BPSH	Bordi i pavarur për shqyrtim
TI	Teknologjia informative
NJAGJ	Njësia për auditim gjyqësor
KDGJ	Komisioni disiplinor gjyqësor
BPBSL	Bordi i përbashkët për bashkërendimin e sundimit të ligjit

DK	Dogana e Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
IDK	Instituti Demokratik i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e udhëhequra nga NATO në Kosovë
KIPRED	Instituti kosovar për hulumtim dhe zhvillim të politikave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
QKRT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
GJK	Gjykata Komunale
KKSK	Këshillat komunale për sigurinë e komuniteteve
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MMK	Monitorim, Mentorim dhe Këshillim
MiM	Memorandum i Mirëkuptimit
MD	Ministria e Drejtësisë
EP	Ekip i përzier
OJQ	Organizatë Joqeveritare
KO	Krimi i organizuar
KOTQNJ	Spektori për krimin e organizuar dhe trafikimin e qenieve njerëzore
ZAD	Zyra e avokatit disiplinues
OMPF	Zyra për persona të pagjetur dhe mjekësi ligjore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
NJMO	Njësia për mbështetje operative
AKPK	Agjencia Kosovare e Privatizimit
DAP	Doracak për administratën e prokurorisë
GPB	Grupi për përcjelljen e të burgosurve
PISCES	Sistemi për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal
SIMP	Sistemi informativ për menaxhimin e prokurorisë
PP	Prokuroria publike
DFP	Departamenti për fuqizimin e policisë
RECCIU	Njësitë rajonale për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit
SiL	Sundimi i Ligjit
SIMR	Sistemi informativ për menaxhimin e resurseve
NJRMO	Njësia rajonale për mbështetje operative
NSH	Ndërmarrje shoqërore
KOS	Korniza operative strategjike
PSO	Procedura standarde të operimit
NJOS	Njësia për operacione të specializuara
PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
NJSM	Njësitë e specializuara për mbështetje
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
TAIEX	Instrumenti i KE-së për Asistencë Teknike në Shkëmbimin e Informatave

TQNJ	Trafikimi i qenieve njerëzore
TIMS	Sistemi i menaxhimit të informatave tregtare
RKS KB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	5
PARATHËNIE	6
QASJA PROGRAMORE – FAZA II	7
PËRMBLEDHJE	10
POLICIA	17
Progresi i përgjithshëm i PK-së.	18
Përbushja e programit MMK për Policinë	20
LUFTIMI EFEKTIV I KRIMIT	21
PATRULLIMI EFEKTIV DHE SIGURIMI I RENDIT PUBLIK	24
SIGURIMI I KUFIJVE	26
KRIJIMI I NJË ORGANIZATE TË QËNDRUESHME	28
DREJTËSIA	31
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	33
Gjykatësit	36
PROKURORËT PUBLIK	45
PROKURORIA SPECIALE E KOSOVËS (PSRK)	48
MINISTRIA E DREJTËSISË	50
ZYRA PËR PERSONA TË ZHDUKUR DHE MJEKËSI LIGJORE (OMPF)	54
SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS (SHKK)	55
DOGANA	61
Integrimi i Strategjive Qeveritare në Planet Operative.	63
Përmirësimi i komunikimit të brendshëm.	64
Bashkëpunimi me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit.	65
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK).	66
SHOQËRIA CIVILE	68
SHOQËRIA CIVILE NË VEPRIMET MMK	69
REKOMANDIMET E KORRIKUT 2009	71
QASJA PROGRAMORE DHE SHOQËRIA CIVILE –RRUGA PËRPARA	74

PARATHËNIE

Kam kënaqësinë që t'ua paraqes raportin më të ri për Programe të EULEX-it. Publikimi i tij shënon edhe një moment tjetër të rëndësishëm – i cili u ofron qytetarëve mundësinë që ta përcjellin progresin e monitorimit, mentorimit dhe këshillimit (MMK) në ndihmë të sundimit të ligjit në Kosovë. I tërë ky angazhim ka mëtuar që ta vazhdojë më tej punën e cila kulmoi me bërjen publike të Raportit për Programe të EULEX-it në korrik 2009 duke përgatitur plane të hollësishme për adresimin e fushave me dobësi në policinë, drejtësinë dhe doganën kosovare. Planifikimi i ndryshimeve të domosdoshme ka qenë një punë e përbashkët e personelit të EULEX-it dhe të homologëve të tyre në kuadër të gjithë komponentëve të sundimit të ligjit. Personeli i EULEX-it ka ofruar ndihmë dhe e ka monitoruar aktivisht procesin e zbatimit, i cili ka qenë në përgjegjësinë e plotë të profesionistëve në kuadër të policisë, drejtësisë dhe doganës kosovare.

Siç është thënë në raport, është arritur një progres pozitiv, gradual, real dhe i qëndrueshëm. Megjithatë, të gjithë ne duhet ta dimë se problemet të cilat janë duke u trajtuar janë substanciale dhe se nuk ka zgjidhje të shpejta për to. Shkalla e zhvillimit varet në masë të madhe nga resurset dhe kapacitetet e policëve, doganierëve, prokurorëve, gjykatësve dhe administratorëve të gjykatave; ata e kanë në dorë dhe e kontrollojnë procesin e ndryshimeve, ndërsa EULEX-i i ndihmon me anë të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. Në shumë fusha, ky proces përplotësohet edhe nga Komisioni Evropian, organizatat tjera ndërkombëtare dhe/ose projektet e financuara nga donatorët.

Shfrytëzoj rastin që t'i falënderoj partnerët tonë nga fusha e Sundimit të Ligjit në Kosovë për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe shumë pjesëtarë të EULEX-it, përkushtimi dhe puna e madhe e të cilëve është pasqyruar në këto faqe.

Yves de Kermabon

Shef i Misionit

EULEX Kosovë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

QASJA PROGRAMORE – FAZA II

Deklarata e Misionit e EULEX-it i përmend gjashtë synime kryesore: do të thotë se, ai do t'i ndihmojë institucionet, organet e drejtësisë dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë në progresin e tyre drejt:

- ✓ qëndrueshmërisë,
- ✓ llogaridhënies,
- ✓ shumë-etnicitetit,
- ✓ lirisë nga ndërhyrjet politike,
- ✓ zbatimin të standardeve të njohura ndërkombëtarisht, dhe
- ✓ përputhjes me praktikën më të mira evropiane.

Këto synime të rëndësishme e përkufizojnë vizionin e përbashkët për të ardhmen e institucioneve kosovare të sundimit të ligjit, vizion ky arritjen e të cilit do ta ndihmojë EULEX-i. Për më shumë, ato e përcaktojnë një agjendë për perspektivën evropiane të Kosovës.

Prandaj, ajo që parashihet me anë të Deklaratës së Misionit të EULEX-it në Kosovë është një proces i reformimit: lëvizjen e Policisë, Drejtësisë dhe Doganës së Kosovës nga "gjendja aktuale" e tyre drejt një "gjendjeje të dëshiruar". Sikur në çdo udhëtim tjetër, është me rëndësi për të gjithë ata që punojnë në kuadër të sundimit të ligjit në Kosovë ta dinë se ku ndodhen ata në pikën fillestare, si dhe ku dëshirojnë të jenë në të ardhmen.

Ndërmjet muajve dhjetor 2008 dhe qershor 2009 EULEX-i e ka realizuar Fazën I të *qasjes programore* të tij. Ajo përbëhej nga një vlerësim i hollësishëm i përmbylljes së detyrave të punës të Sundimit të Ligjit në Kosovë, me fjalë tjera, EULEX-i e vlerësoi "gjendjen aktuale" në polici, drejtësi dhe doganë, dhe i kishte identifikuar partnerët e mundshëm të shoqërisë civile për aktivitetet e MMK të tij. Rezultatet e këtij vlerësimi qenë sqaruar në Raportin për Programe të EULEX-it të korrikut 2009, i cili solli një numër të madh të rekomandimeve për ndryshime në të ardhmen.

Qasja Programore e EULEX-it bazohet në një përputhshmëri rigoroze me parimin e "pronësisë vendase". Në praktikë kjo nënkupton se përgjegjësia përfundimtare për shndërrimin e secilit rekomandim në një Veprim MMK ishte në duart e institucioneve përkatëse kosovare të sundimit të ligjit. Kësisoj, qasja programore e EULEX-it është paraparë që t'u ndihmojë organeve kosovare të sundimit të ligjit që ndryshimet t'i bëjnë vetë, në vend se të mbështeten në praninë ndërkombëtare dhe ajo ta bëjë këtë në vend të tyre. Derisa profesionistët kosovarë të sundimit të ligjit i realizojnë ndryshimet, personeli i EULEX-it ofron ndihmë dhe mentorim të vazhdueshëm, duke e ndihmuar kështu procesin e ndryshimeve organizative. Po ashtu, personeli i EULEX-it bën monitorimin e procesit dhe përgatit raporte të hollësishme dhe informuese lidhur me progresin, apo të tjera.

Raporti për Programe 2010 i EULEX-it i sistemon dhe i paraqet të dhënat për përmbylljen e punës nga periudha kritike e zbatimit të Veprimeve MMK, përgjatë muajve të fundit dhe më shumë se kaq. Kjo është një pjesë thelbësore e mandatit të EULEX-it, që të jetë llogaridhënës dhe transparent lidhur me punën të cilën është duke e bërë ai.

"Katalogun" e të gjitha Veprimeve MMK mund ta shkarkoni në formatin PDF nga faqja zyrtare e internetit e EULEX-it:

<http://www.eulex-kosovo.eu/en/tracking/>.

Por kjo nuk është e tëra. Duke e shfletuar rregullisht faqen e mësipërme të internetit, ju mund të

monitoroni punën e EULEX-it përkitazi me MMK-në dhe të shihni deri në ç'masë janë duke shënuar progres institucionet kosovare në zhvillimin e sundimit të ligjit. Ne do të vazhdojmë të jemi të hapur dhe me qasje për opinionin e gjerë. Ne i kemi inkurajuar organizatat joqeveritare (OJQ) dhe shoqërinë civile që të kenë komunikim të hapur dhe të rregullt me neve. Duke ia bërë të ditur qytetarëve se cilat janë reformat e pritura dhe se si të jenë të informuar nëpër secilën fazë të procesit është pjesa kryesore e punës sonë.

Me zbatimin e Veprimeve MMK, po ecën përpara edhe sundimi i ligjit në Kosovë. Një prej kritereve më të rëndësishme për Kosovën në zhvillimin e perspektivës evropiane të saj është përmirësimi i sundimit të ligjit. Kjo është arsyeja pse mundësia e qytetarëve të Kosovës që ta përcjellin progresin do të kontribuojë që t'i sjell ata më afër Bashkimit Evropian (BE).

Tabela e mëposhtme paraqet një pasqyrë të progresit të institucioneve kosovare të sundimit të ligjit në fushat ku EULEX-i është duke inkurajuar ndryshime organizative nëpërmjet monitorimit, mentorimit dhe këshillimit (MMK). Rezultatet dhe analizat janë paraqitur më hollësisht në këtë Raport.

FUSHA E SUNDIMIT TË LIGJIT	Sektorët	2010 krahasuar me 2009	Faqet përkatëse në këtë raport
POLICIA	Luftimi efektiv i krimit	B	16-18
	Patrullimi efektiv dhe sigurimi i rendit publik	B	18-20
	Sigurimi i kufijve	A	20-21
	Krijimi i një organizate të qëndrueshme	B	22-23
	DREJTËSIA	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	B
	Gjykatësit	B/C	29-38
	Prokurorët publik	B/C	38-42
	Prokuroria Speciale (PSRK)	B	42-44
	Ministria e Drejtësisë	B/C	45-49
	Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore	B/C	48-49
	Shërbimi Korrektues	A/B	49-54
DOGANA	Integrimi i strategjive të qeverisë në planet e punës	B	56
	Përmirësimi i komunikimit të brendshëm	B/C	57
	Bashkëpunimi me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit.	B	58
	Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.	B/C	60

A = Progres

B = Progres i ngadalshëm/Nevojitet më shumë stimulim

C = Problematik/Progres shumë i vogël ose aspak

D = Shqetësim serioz/kthim mbrapa

Roy Reeve

Zëvendës Shef i Misionit

EULEX Kosovë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

Alessio Zuccarini

Shef i Zyrës për Programe

EULEX Kosovë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

PËRMBLEDHJE

Policia. Përparimi në aspektin e veprimeve të MMK-së¹ lidhur me çështjet policore është varur nga ekzistimi i burimeve të mjaftueshme të Policisë së Kosovës (PK).

Nevojitet zhvillim i konsiderueshëm i kapacitetit të PK-së për t'i shndërruar politikat ose dokumentet strategjike (shpesh të hartuara në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare) në veprime të zbatuara. Shembuj të kësaj janë rrjedha e veprimit e Strategjisë për luftimin e krimit të organizuar dhe Plani i Veprimit kundër narkotikëve.

Përkundër këtyre vështirësive, PK-ja ka arritur të bëjë përparim sa i përket zhvillimit strategjik të organizatës duke hartuar planin strategjik pesë-vjeçar 2011-2015. Plani strategjik lidhur me prioritetin në treguesit e performancës, qartësinë e qëllimeve dhe objektivave kryesore si dhe aspektet e marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe opinionit të gjerë duhet të vlerësohen tutje.

Ristrukturimi i organizatës është dëshmuar të jetë proces i vështirë: ende është duke u zhvilluar dhe në bazë të mungesës së vërejtur të bashkërendimit ndërmjet aktorëve institucionalë të përfshirë në të, sugjerohet që të bëhet një analizë e kujdesshme e 'formës' përfundimtare të PK-së. Duhet shmangur dyfishimet e mundshme dhe mospërputhjet brenda organizatës së re. Me të përfunduar ristrukturimi i PK-së, rishikimi gjithëpërfshirës i shpërndarjes së burimeve duhet ta sigurojë shpërndarjen e duhur të personelit në mbarë PK-në.

Është shënuar përparim në bartjen e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e Kufirit të Gjellbër me Shqipërinë: bartja e përgjegjësisë prej KFOR-it te PK-ja është bërë më 28 prill 2010. Janë vënë në veprim patrulla të përbashkëta dhe të sinkronizuara (KFOR-i, Policia Kufitare e PK-së, EULEX-i) dhe në fillim të vitit 2010 është bërë rekrutimi i 127 pjesëtarëve të rinj. Në vijat e tjera të kufijve është shënuar përparim i kufizuar apo nuk është shënuar kurrfarë përparimi: procesi i demarkacionit të kufirit me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) ka përfunduar por plani i kalimit të kompetencave është ende në përgatitje e sipër dhe pritët që procesi të fillojë në fund të kësaj vere.

¹ Veprimet e Monitorimit, Mentorimit dhe Këshillimit

PK-ja ka marrë detyra të reja të cilat bartin me vete sfida të mëdha operative por të cilat po ashtu kanë pasur rëndësi të madhe simbolike – siç janë hapat e parë të marrjes së përgjegjësisë për sigurimin e objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore nga KFOR-i.

Futja në përdorim e kryerjes së shërbimeve policore të udhëhequra nga inteligjenca (PUI) është zbatuar dobët. Që nga marsi i vitit 2010, PK-ja ka ndarë për të më shumë burime dhe energji. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të kërkesës që PK-ja ia ka bërë Komisionit Evropian (KE) sipas kornizës për ndihmë "IPA 2010", kryesisht në fushën e Teknologjisë Informative.

EULEX-i dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) do të vazhdojnë të monitorojnë për së afërmi zhvillimin e këtij veprimi.

Një hap pozitiv drejt ndalimit të krimit ekonomik, atij financiar dhe korrupsionit ka qenë krijimi i Drejtorisë për Hetime e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së (DP PK) në dhjetor 2009. DHKEK ka juridiksion në mbarë Kosovën dhe bashkërendon hetimet në nivelin qendror (shtabi kryesor) dhe në nivelin rajonal (Njësitë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe të Korrupsionit – NJRHKEK). Zgjedhja e pjesëtarëve kryesorë është ende duke vazhduar por tashmë janë vërejtur pengesa të tjera siç janë mjetet logjistike dhe shpërndarja e burimeve njerëzore në nivelin e pajtueshëm.

Është vënë re ca përparim në zhvillimin e aftësisë së PK-së për kontrollin e turmës dhe të trazirave. Njësitë e dikurshme për Mbështetje Rajonale Operative (NJMRO) janë bashkuar në një zinxhir të vetëm komandues (tani quhen Njësi për Mbështetje Operative – NJMO) duke e hapur mundësinë për ndikim pozitiv në menaxhimin e burimeve, në aftësim dhe në funksionim.

Në mënyrë që ta përcjellë procesin e decentralizimit dhe krijimin pasues të komunave të reja, PK-ja ka krijuar një grup punues tematik për të planifikuar krijimin e stacioneve të reja policore në këto vende. Në Gjilan është duke u ndërtuar shtabi i ri rajonal. Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare në Veri, Drejtoria Rajonale e Ferizajt dhe stacionet dhe nën-stacionet tjera janë duke u rinovuar.

Zyra e EULEX-it për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Gjinore (ZDNJGJ) ka monitoruar raportet e përditshme të gjendjes (RPGJ) (të përkthyer) të mbledhura dhe të sistemuara nga PK-ja. Të dhënat statistikore të përfshira në raportet e përditshme lidhur me gjendjen janë të kategorizuara para së gjithash sipas kundërvajtjeve dhe krimeve të parapara me ligjin e zbatueshëm. ZDNJGJ e EULEX-it ka zbuluar që PK-ja nuk është duke mbajtur statistika të kombinuara që do t'i krahasonin për shembull

kategoritë e viktimave, të autorëve të krimit dhe të krimeve (sipas parametrave siç janë gjinia, përkatësia etnike ose nën-kategoritë e krimeve). EULEX-i ka mendim të prerë që nevojitet përdorim më i sofistikuar i të dhënave të papërpunuara që janë në raportet ditore lidhur me gjendjen në mënyrë që të paraqes një studim gjithëpërfshirës lidhur me krimet. Për t'i identifikuar mostrat dhe shkaqet rrënjësore të krimit dhe si rrjedhojë, për t'i hartuar programet e planifikuara korigjuese, PK-ja ka nevojë për mjete dhe tregues të besueshëm për t'i përshtatur reagimet e veta.

Organizata e PK-së ka arritur rezultate modeste, por po ashtu ka treguar aftësi në rritje e sipër për të bërë ndryshime organizative në shkallë të gjerë. Në këtë kuptim, gjetjet e EULEX-it duket që konfirmojnë se PK-ja ka filluar të bëhet 'organizatë që po mëson'. Në kuptimin e vërtetë, kjo aftësi që po shfaqet mund të përshkruhet si veprim shtesë i fshehur i MMK-së.

Drejtësia. Hartimi dhe zbatimi i veprimeve të MMK-së brenda sistemit të drejtësisë të Kosovës vazhdon të ndiqet nga ekspertët e EULEX-it të cilët e ndajnë kohën e tyre ndërmjet funksioneve të tyre kryesore ekzekutive (p.sh. hetimi i krimeve dhe ndjekja penale e personave që dyshohen për shkelje dhe gjykimi i rasteve në gjykatë) dhe ofrimit të ndihmës përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit të strukturuar. Ky organizim ka sjellë disa ndryshime të rëndësishme në pjesë të caktuara të sistemit të drejtësisë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) tani është funksional dhe mundësitë për ngritjen e aftësive institucionale do të vazhdojnë t'i nënshtrohen veprimeve të MMK-së. Përkundër përparimit të bërë gjatë periudhës raportuese, KGJK-ja është ende duke punuar në aspektet sfiduese dhe gatishmëria e tij për të luajtur rol kryesor në sigurimin e pavarësisë dhe të paanësisë së sistemit gjyqësor të Kosovës do të testohet gjatë muajve të ardhshëm.

Efektshmëria e sistemit të drejtësisë së Kosovës është ende duke treguar shenja të dukshme të dobësisë. Është vërejtur ndërhyrje në nivele të ndryshme dhe në forma të ndryshme. Kjo ndërhyrje në punën e sistemit të drejtësisë, si në procedurat penale ashtu edhe në ato civile, shpesh ka pasur për pasojë probleme praktike (siç është abstenimi paraprak i gjykatësve dhe prokurorëve vendor për t'u marrë me raste të ndjeshme).

Numri i madh i rasteve të pazgjdhura, sidomos i atyre civile, tregon që gjykatësit dhe prokurorët vendor nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë përparim në trajtimin e kësaj çështjeje urgjente.

Kapaciteti i sistemit të drejtësisë penale të Kosovës për të ecur përpara me agjendën e reformave ka mbetur shumë i brishtë dhe i parregullt. Mungesa e përparimit në krijimin e mekanizmave themelore për bashkëpunim dhe bashkërendim ndërmjet prokurorëve dhe Policisë së Kosovës, si edhe ndërmjet prokurorive dhe gjykatave, mbeten faktorë shqetësues. Për më tepër, përpjekjet e prokurorisë dëmtohen nga menaxhimi i dobët dhe mungesa e personelit ndihmës.

Krijimi i një grupi punues kundër korrupsionit në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSK) është pa dyshim një hap pozitiv; përparimi i vazhdueshëm në këtë fushë pa dyshim që do t'i kontribuonte përmirësimit të përgjithshëm në luftën kundër krimit financiar dhe korrupsionit.

Përfundimi i procesit të verifikimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe të prokurorëve të Kosovës pa dyshim që do të ndihmojë në krijimin e "hapave" të duhur për përcjelljen e reformave të nevojshme. Ky aspekt duhet të lidhet me çështjen e burimeve njerëzore: numri i personelit nuk është i mjaftueshëm dhe duhet të bëhet më tepër në mënyrë që të sigurohet plotësimi i pozitave kryesore dhe shpërndarja e duhur e personelit ndihmës.

Cilësia dhe transparenca e procesit legjislativ duhet të përmirësohet në masë të madhe, jo vetëm për t'i ofruar Kosovës një kornizë ligjore të shëndoshë por po ashtu për ta përmirësuar besimin në sistemin juridik.

Në bazë të praktikës së monitoruar deri tani vërehet që nevojitet përparim i mëtejshëm në trajtimin e viktimave të dhunës në familje, në rastet që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore dhe në rastet që kanë të bëjnë me çështjet gjinore.

Shërbimi Korrektues i Kosovës po tregon një qasje më pro-aktive ndaj zhvillimit të shërbimeve të tyre, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha nismat e përbashkëta. Është shënuar përparim në menaxhimin e Administratës së Burgut, të Operativës dhe të Sigurisë, të burgosurve me rrezikshmëri të lartë, të përcjelljes së të burgosurve dhe të sigurisë së gjykatës.

Dogana. Rekomandimet si në Raportin e Programit të EULEX-it të vitit 2009 ashtu edhe në Raportin për Analizimin e Projekteve të Doganës të ZNKE/BE të vitit 2009 duket që i kanë drejtuar përpjekjet e Doganës së Kosovës për ta përmirësuar efektshmërinë e saj.

Udhëzimi Administrativ me dispozitat zbatuese të Kodit të Kosovës për Doganën dhe Akcizën ka hyrë në fuqi në shtator 2009. Është bërë përparim i madh në nxjerrjen e udhëzimeve administrative në

harmoni me legjislacionin e ri për doganën. Ka filluar hartimi i amendamenteve për Kodin në mënyrë që të përfshihen nenet specifike të cilat e rregullojnë mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave. Procesi i hartimit të dispozitave të zbatueshme të Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale është në fazën përfundimtare.

Asnjë përparim nuk është shënuar në funksionimin e Bordit të Pavarur Shqyrtues dhe në reduktimin e ankesave të pazgjidhura doganore, pavarësisht nga zotimet e përsëritura të institucioneve të Kosovës për mënjanimin e pengesave për funksionimin e duhur të organit të ankesës.

Me mbështetjen e KE-së është financuar programi “Mbështetja e BE-së për Administratën Doganore dhe atë Tatimore” (BE-ADT) dhe është kryer një vlerësim për nevojat për aftësim në Doganën e Kosovës, përfshirë aftësimin më të specializuar për zbatimin e ligjit.

Vlerësimi i doganës do të vazhdojë të jetë një fushë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet EULEX-it, BE-ADT dhe Doganës së Kosovës, po ashtu edhe në frymën e ndikimit të drejtpërdrejtë në mbledhjen e të hyrave.

Nuk është arritur asnjë përparim i dukshëm në futjen në përdorim të një sistemi të integruar të burimeve njerëzore në Doganën e Kosovës, edhe pse janë shqyrtuar zgjidhjet e mundshme.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave ka vendosur ta zëvendësojë sistemin ekzistues të TI-së2 me një sistem të integruar informativ për doganë që është në pajtim me standardet e BE-së. Kjo nuk duhet të paraqes vetëm një përparësi të përpunimit të përmirësuar digjital të dokumenteve por po ashtu e mundëson edhe përdorimin e konceptit të një “sporteli” të vetëm, një përzgjedhje të përmirësuar të kontrolleve doganore dhe një zbulim më efikas të tregtisë së paligjshme dhe të krimit të rëndë.

Përqindjet e pakicës etnike (12%) dhe ato gjinore (24% femra) në burimet njerëzore të Doganës së Kosovës kanë mbetur mjaft të njëtrajtshme, ndërsa numri i plotë i personelit është rritur për 30 pjesëtarë më 2009.

Integrimi i strategjive qeveritare në planet operative: Dogana e Kosovës e ka hartuar një Kornizë të re Strategjike Operative (KSO) për periudhën 2010-2012. Projekti i KSO duhet të përqendrohet më tepër në nivelin strategjik, në vizionin specifik dhe në fushat kryesore të përmbushjes për periudhën e menduar tri-vjeçare. EULEX-i ka rekomanduar të bëhet ristrukturimi i përmbajtjes së KSO.

² Teknologjia Informative

Sa i përket Planit të Veprimit 2010, natyra integruese e këtij plani të përbashkët ishte e dobishme, meqë ai mbështetet në KSO; ndoshta ka nevojë të ri-radhitet sipas formës përfundimtare të KSO.

Përmirësimi i komunikimit të brendshëm: është shënuar përparim i kufizuar në zhvillimin e këtij veprimi MMK, po ashtu edhe për shkak të numrit të pamjaftueshëm të burimeve njerëzore në kuadër të Komponentit të Doganës të EULEX-it. Në pranverë të vitit 2010 EULEX-i ka ndarë më shumë burime njerëzore. Doganierët e Kosovës kanë marrë pjesë në një trajnim të realizuar nga Projekti i Binjakëzimit i KE-së "Forcimi i sundimit të ligjit" me Policinë Kufitare të Kosovës.

Është shënuar përparim në zbatimin e veprimit të MMK-së lidhur me bashkëpunimin me agjencitë tjera për zbatimin e ligjit. Ky grup i aktiviteteve përqendrohet në Drejtorinë Ligjore dhe në atë për Zbatimin e Ligjit të Doganës së Kosovës në mënyrë që ta rrisë bashkëpunimin me agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit dhe në veçanti me Prokurorinë Publike. Dogana e Kosovës ka hartuar një plan për një veprim të përbashkët me Policinë e Kosovës në mënyrë që ta zbulojnë importimin dhe eksportimin e paligjshëm të parave nga udhëtarët në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës. Ky vendim është marrë me qëllim që të krijohet një njësi e re në kuadër të Drejtorisë Ligjore për ndërlidhje dhe bashkëpunim me prokurorët publikë, edhe pse ende nuk është funksionale. Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi i cili i vendosë themelet për një bashkëpunim më të ngushtë. Disa marrëveshje për bashkëpunim të doganës dhe ndihmë reciproke janë nënshkruar me vendet fqinje, ndërsa për të tjerat janë duke u zhvilluar bisedime ose janë duke u përgatitur.

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufijve (MIK): edhe pse bashkëpunimi ndërmjet agjencive lidhur me MIK mbetet i kufizuar, është shënuar pak përparim në zbatimin e veprimeve "brenda" agjencisë në DK, p. sh. Hartimi i Udhëzimeve Administrative ose Procedurat Standarde të Veprimit (PSV). Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës janë pajtuar t'i këmbëjnë të dhënat lidhur me kontrollin por kjo inter alia varet nga përtëritja e sistemit të TI-së të Doganës. Kapaciteti i harduerit të TI-së në vendkalimet kufitare/të kufijve është përmirësuar, ndërsa Dogana është duke i ndarë lokalet e kontrollit (dhomën operative, CCTV-në) me PK-në dhe janë vendosur disa kabina të përbashkëta në disa vendkalime kufitare.

Shoqëria civile dhe OJQ-të. Përfshirja e shoqërisë civile në aktivitetet e

MMK-së të EULEX-it është një çështje e karakterit të përgjithshëm, me rëndësi për të gjithë komponentët. Edhe pse nuk ka veprime specifike të MMK-së mbi partneritetin me organizatat vendore joqeveritare, në shumë dokumente programore thuhet që ekziston bashkëpunimi me këta akterë të mbikëqyrjes në Kosovë. Si rezultat i këshillimeve me palët e interesuara të shoqërisë civile,

të institucioneve të Kosovës dhe të personelit të angazhuar në MMK të EULEX-it, në qasjen programatike janë përfshirë një numër i rezultateve dhe i aktiviteteve përgjatë veprimeve të ndryshme të MMK-së duke iu referuar në mënyrë specifike shoqërisë civile.

Sa i përket çështjeve gjyqësore, aktivitetet programore i shohin organizatat joqeveritare si partnerë konsultativ për çështjet që kanë të bëjnë me MMK, duke u përpjekur në këtë mënyrë t'i stimulojnë ndërveprimet e shpeshta ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve vendore të sundimit të ligjit. Për shembull, veprimi i MMK-së mbi KGJK-në cakton takime të rregullta me shoqërinë civile dhe përfshinë përfaqësuesit e saj në proceset përkatëse të reformës së drejtësisë.

Përderisa akterët joqeveritarë kanë rol të kufizuar në aktivitetet e MMK-së të Doganës – dhe nuk përmenden në mënyrë specifike në veprimet e MMK-së së këtij komponenti – roli i tyre në Programin MMK të Policisë është më i qartë. Disa veprime MMK të Policisë përfshijnë aktivitetet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë publik dhe ju referohen përfaqësuesve të shoqërisë civile si palë që duhet të përfshihen në fazën e zbatimit.

Funksionimi i institucioneve të sundimit të ligjit – dhe në veçanti lufta kundër korrupsionit mbetet prioritet i lartë për shumë organizata joqeveritare në Kosovë; gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar ka pasur shumë analiza, raporte dhe rekomandime të politikave lidhur me këto tema. OJQ-të kanë treguar kapacitet të shquar në identifikimin e përparësive dhe dobësive në mekanizmat e Kosovës për sundimin e ligjit.

POLICIA

Progresi i përgjithshëm i PK-së.

Progresi në aspektin e veprimeve MMK lidhur me policinë është varur nga ekzistimi i burimeve të mjaftueshme të Policisë së Kosovës (PK).

Nevojitet zhvillim i konsiderueshëm i kapacitetit të PK-së për t'i shndërruar politikat ose dokumentet strategjike (shpesh të hartuara në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare) në veprime të zbatuara. Shembull i kësaj është zbatimi i Strategjisë për luftimin e krimit të organizuar dhe i planit të veprimit kundër narkotikëve.

Riorganizimi i strukturës është dëshmuar të jetë proces i vështirë. Ky riorganizim është ende në zhvillim e sipër dhe në bazë të mungesës së vërejtur të bashkërendimit ndërmjet aktorëve institucionalë të përfshirë në të mund të shihet që duhet të bëhet një analizë e kujdesshme e 'formës' përfundimtare të PK-së. Duhet shmangur dyfishimet e mundshme dhe mospërputhjet brenda organizimit të ri. Me të përfunduar ristrukturimi i PK-së, rishikimi gjithëpërfshirës i shpërndarjes së burimeve duhet ta sigurojë shpërndarjen e duhur të personelit në mbarë PK-në.

Është shënuar progres në bartjen e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e kufirit të gjelbër me Shqipërinë. Bartja e përgjegjësisë prej KFOR-it te PK-ja është bërë më 28 prill 2010. Janë vënë në veprim patrulla të përbashkëta dhe të sinkronizuara (KFOR-i, Policia Kufitare e PK-së, EULEX-i) dhe në fillim të vitit 2010 është bërë rekrutimi i 127 pjesëtarëve të rinj. Në vijat e tjera të kufijve është shënuar progres i kufizuar apo nuk është shënuar kurrfarë progresi. Procesi i demarkacionit të kufirit me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) ka përfunduar por harta e kalimit rrugor është ende në përgatitje e sipër dhe pritet që procesi të fillojë në fund të kësaj vere.

PK-ja ka marrë detyra të reja të cilat bartin me vete sfida të mëdha operative por të cilat po ashtu kanë pasur rëndësi të madhe simbolike, siç janë hapat e parë të marrjes së përgjegjësisë për sigurimin e objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore nga KFOR-i.

Puna policore e bazuar në inteligjencë (PBI) është zbatuar dobët. Prej marsit 2010, PK-ja ka ndarë më shumë burime dhe energji, duke marrë parasysh edhe kërkesën për ndihmesë (kryesisht në fushën e Teknologjisë Informative) që PK-ja ia ka bërë Komisionit Evropian (KE) në kuadër të kornizës "IPA 2010".

EULEX-i dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO) do të vazhdojnë me monitorimin e afërt të zhvillimit të këtij veprimi.

Një hap pozitiv drejt ndalimit të krimit ekonomik, atij financiar dhe korrupsionit ka qenë krijimi i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) nga ana e Drejtorit të Përgjithshme të PK-së (DP PK) në dhjetor 2009. DHKEK ka juridiksion në mbarë Kosovën dhe i bashkërendon hetimet në nivelin qendror (shtabi kryesor) dhe në nivelin rajonal (Njësitë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe të Korrupsionit – NJRHKEK). Zgjedhja e pjesëtarëve kryesorë është ende duke vazhduar por tashmë janë vërejtur disa pengesa të tjera siç janë mjetet logjistike dhe shpërndarja e burimeve njerëzore në nivelin e miratuar.

Është vënë re ca përparim në zhvillimin e aftësive të PK-së për kontrollin e turmës dhe të trazirave. Njësitë e dikurshme Rajonale për Mbështetjen Operative (NJRMO) janë bashkuar në një zinxhir të vetëm komandues (tani quhen Njësi për Mbështetje Operative – NJMO) duke e hapur mundësinë për ndikim pozitiv në menaxhimin e burimeve, në aftësim dhe në funksionim.

Në mënyrë që ta përcjellë procesin e decentralizimit dhe krijimin pasues të komunave të reja, PK-ja e ka krijuar një grup punues tematik për ta planifikuar krijimin e stacioneve të reja policore në këto vende. Në Gjilan është duke u ndërtuar një Shtab i ri Rajonal. Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare në Veri, Drejtoria Rajonale e Ferizajt dhe stacionet dhe nën-stacionet e tjera janë duke u rinovuar.


Zyra e EULEX-it për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Gjinore (ZDNJGJ) i ka monitoruar raportet ditore të gjendjes (RDGJ) (të përkthyer) të mbledhura dhe të sistemuara nga PK-ja. Të dhënat statistikore të përfshira në raportet ditore lidhur me gjendjen janë të kategorizuara para së gjithash sipas kundërvajtjeve dhe krimeve të parapara me ligjin në fuqi. ZDNJGJ e EULEX-it ka vërejtur se PK-ja nuk është duke mbajtur statistika të kombinuara që do t'i krahasonin për shembull kategoritë e viktimave, të autorëve të krimit dhe të krimeve (sipas parametrave siç janë gjinia, përkatësia etnike ose nën-kategoritë e krimeve). EULEX-i ka mendim të prerë që nevojitet shfrytëzim më i sofistikuar i të dhënave të papërpunuara që janë në raportet ditore lidhur me gjendjen në mënyrë që të paraqitet një studim gjithëpërfshirës lidhur me krimet. Për t'i identifikuar llojet dhe shkaqet rrënjësore të krimeve dhe si rrjedhojë për t'i hartuar programet e planifikuara rregulluese, PK-ja ka nevojë për një instrument dhe tregues të besueshëm për t'i përshtatur reagimet e veta.

Përmbushja e programit MMK për Policinë

Në diagramin 1.1 është paraqitur një përmbledhje e progresit të PK-së lidhur me 36 veprimet MMK që janë miratuar pas Raportit të Programit 2009. Gjithsej 7 (19%) prej veprimeve MMK janë shtyrë për më vonë. Nga 29 veprimet e tjera MMK, dy janë përmbushur me sukses, 27 ndodhen nëpër faza të ndryshme të zbatimit apo nuk i kanë përmbushur fazat e tyre të planifikimit (3). Ndonëse modeste, kjo arritje është shënuar përkundër kufizimeve të vërejtura të burimeve të PK-së. Raportet e EULEX-it tregojnë se progresi i dobët mund të jetë pasqyrim i përvojës së kufizuar që menaxherët e PK-së kanë mbi ndryshimet organizative dhe mekanikën e masave reformuese. Disa rreziqe të caktuara që kanë qenë të njohura në fazën planifikuese të veprimeve të MMK kanë dalë të jenë faktorë dhe shkaktar domethënës në progresin e vështirë të disa fushave. Ndër këto rreziqe është ndikimi i ndërrimit të personelit të EULEX.


Organizata e PK-së ka dhënë një numër modest të rezultateve, por gjithashtu ka demonstruar një aftësi në rritje e sipër për të sjellë ndryshime organizative të mëdha. Në këtë aspekt, të gjeturat e EULEX-it duket të konfirmojnë atë se PK-ja ka filluar të bëhet 'organizatë e mësimnxënies'. Me shumë vërtetësi, kjo aftësi ngritëse mund të përshkruhet si veprimi i fshehtë shtesë i MMK-së.

Figura 1.1 - Progresi i Veprimit të MMK - Policia e Kosovës



LUFTIMI EFEKTIV I KRIMIT

Gjithsej 11 (30%) prej veprimeve MMK për policinë i janë caktuar Shtyllës së PK-së për luftimin e krimeve. Siç shihet në diagramin 1.2, 5 veprime MMK janë në zbatim e sipër por ka kohë që ato të arrijnë rezultatet e planifikuara. Një veprim MMK është në fazën e hershme të planifikimit dhe 5 veprime të tjera janë shtyrë për më vonë.



Drejt një Sistemi efektiv të Drejtësisë Penale (SDP). Një numër i propozimeve të dhëna nga faza e parë kishin të bëjnë me aftësitë organizative të SDP-së. Këto veprime MMK kanë dalë nga të dhënat që kanë treguar për mungesë të harmonisë dhe koherencës në marrëdhënien e punës së Shtyllës së PK-së për luftimin e krimeve dhe Prokurorisë Publike (PP). Në veçanti, ato veprime kanë kërkuar gjenerimin e një kuptimi më të madh se hetuesit policorë dhe prokurorët përbëjnë një realitet të vetëm, që është SDP-ja e Kosovës, dhe kanë përgjegjësi të përbashkët për sukseset dhe dështimet e saj. EULEX-i është munduar që të arrijë këtë qëllim të përgjithshëm përmes një vargu të objektivave të ndërlidhura së afërmi:

- krijimi i një menaxhimi strategjik të përbashkët (PK dhe PP) të SDP-së,

- sistem i përbashkët i kategorizimit të statistikave të krimeve,
- zhvillimi i një qasje ekipore për hetimin e krimeve,
- publikimi i një raporti vjetor të përbashkët për SDP-në dhe llogaridhënia e shtuar publike lidhur me përmbushjen e detyrave të SDP-së.

Progresi lidhur me arritjen e këtyre veprimeve të rëndësishme 'të ndërthurura' të MMK-së është dëshmuar të jetë shumë i ngadalshëm, pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme nga ana e personelit të EULEX-it dhe homologëve të tyre nga PK-ja. Në mars 2010 është arritur një vendim që veprimet MMK lidhur me bashkëpunimin mes Shtyllës së PK-së për luftimin e krimeve dhe PP-së të shtyhen për më vonë. Ky vendim pasoi nga një varg raportesh mujore nga monitoruesit përkatës të EULEX-it që tregonin se progresi është dëshmuar të jetë jashtëzakonisht i vështirë, në veçanti për shkak të pamundësisë së prokurorëve publikë vendas për të ofruar kohë dhe angazhim për përkrahjen e punës programore.

Në mënyrë që të gjendej një rrugëdalje, është vendosur që këto vështirësi të raportohen në Bordin e Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL, maj 2010), ku Ministri i Drejtësisë si dhe ai i Punëve të Brendshme janë pajtuar se ekziston nevoja për një shtytje më të madhe në këto fusha.

Strategjia mbi luftimin e krimit. Ulja e rasteve të krimeve në Kosovë, në veçanti të rasteve të krimeve të rënda dhe atyre të korrupsionit, ka qenë objektivi kryesor i PK-së. EULEX-i ka vërejtur se PK-ja është duke shënuar progres për sa i përket caktimit të personelit të specializuar për të trajtuar veprat e kryera nga ana e të miturve, sigurimit të dhomave të posaçme për intervistimin e të miturve, përgatitjes së udhëzimeve administrative për Komitetet Lokale të Sigurisë Publike (siç kërkohet me Ligjin për Policinë), dhe aranzhimit të trajnimeve specifike për veprat e kryera nga ana e të miturve.

Për sa i përket rishikimit të sistemit të PK-së për grumbullimin dhe sistemimin e statistikave të krimeve të raportuara, EULEX-i ka vërejtur se ka pasur progres për sa i përket identifikimit të kategorive të krimeve që kanë qenë në pajtueshmëri me kategoritë e përdorura në disa shtete të BE-së, gjë që ka mundësuar analizat krahasuese.

Është pranuar se nëse do të arrihej synimi kryesor për uljen e rasteve të krimeve, një faktor i rëndësishëm do të ishte suksesi i ripozicionimit të Drejtorisë për Analizë të Krimeve (DAK) si qendër kryesore e sistemit të PK-së për inteligjencën e nevojshme në luftimin e krimeve. EULEX-i ka vërejtur se ka pasur progres me krijimin e njësisë 'për analiza nga burimet e hapura', themelimin e Zyrës

Ndërlidhëse të Inteligjencës me agjencitë e tjera dhe integrimin e Njësive Rajonale të Inteligjencës në kuadër të strukturës së përgjithshme të DAK-ut.

Puna për përmirësimin e Drejtorisë për luftimin e Krimeve të Organizuara (DKO) është vonuar nga çështjet më madhore që kanë dalë nga ristrukturimi i PK-së. Megjithatë, në shkurt 2010 ekspertët nga EULEX-i kanë theksuar se “është shënuar progres në dhënien e këshillave mbi mënyrat e shfrytëzimit më të mirë të sistemit të tanishëm të inteligjencës dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me DAK-un, si dhe në diskutimin dhe miratimin e zgjidhjeve potenciale lidhur me punën policore të bazuar në inteligjencë”. Struktura e re e DKO-së duhet të përbëhet prej katër shtyllave dhe secila do të kishte nga një njësi të vogël për inteligjencë. Ekspertët nga EULEX-i kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me strukturën e propozuar e cila do të shpinte në një ndarje të asaj që do të duhej të ishte struktura e vetme e inteligjencës.

Puna Policore e Bazuar në Inteligjencë (PBI). Siç është cekur në

Raportin e Programit 2009, parakusht vendimtar për suksesin e organizatës është nevoja për një zhvillim të shpejtë të shfrytëzimit të inteligjencës penale në mbarë PK-në. Ekspertët nga EULEX-i kanë theksuar nevojën e zhvillimit të një kulture të mbledhjes së inteligjencës për të siguruar bazën e një strategjie proaktive për luftimin e krimeve të organizuara dhe atyre të rënda, korrupsionit qeveritar dhe krimin ndërkufitar. Në këtë aspekt, ekspertët nga EULEX-i për luftimin e krimeve kanë përkrahur fuqishëm propozimin që plani ekzistues “i punës policore të bazuar në inteligjencë” të përbëjë themelet e një programi të gjerë për zbatimin e shfrytëzimit më efektiv të inteligjencës në mbarë PK-në. Kjo ka rezultuar në përpjekjen për të shtuar dy veprime shtesë MMK (“Puna policore e bazuar në inteligjencë” dhe “inteligjenca e përmirësuar ndërkufitare”). Pavarësisht kërkesave nga ana e EULEX-it, PK nuk ka arritur që të vendosë burime të duhura dhe të mjaftueshme. Në maj 2010, si rezultat i një iniciative të përbashkët mes EULEX-it/ECLO-së në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), u formua një ekip i ri i PK-së nën autoritetin e një zyrtari të ri të PK-së.


Menjëherë në muajin mars, filloi puna e një angazhimi të përbashkët mes PK-së/OSBE-së për të projektuar dhe zbatuar trajnime të specializuara dhe të avancuara lidhur me punën policore të bazuar në inteligjencë. Në mes të muajit prill 2010, u organizua një punëtori e cila është mundësuar nga OSBE-ja dhe e cila kishte për qëllim miratimin e strategjisë së projektit për PBI dhe planin e veprimit për PBI të PK-në. Menaxhmenti i lartë i PK-së kishte shprehur dëshirën e madhe për zbatimin më të shpejtë të projektit të punës policore të bazuar në inteligjencë në tërë organizatën e PK-së, dhe ushtruesi i detyrës i sapozgjedhur i drejtorit të përgjithshëm e ka caktuar këtë çështje si detyrë

prioritare e tij dhe personelit të tij.

PATRULLIMI EFEKTIV DHE SIGURIMI I RENDIT

PUBLIK

Gjithsej 8 (22%) prej veprimeve MMK të Policisë janë caktuar për Shtyllën e PK-së për Operacione. Siç është paraqitur në diagramin 1.3, një veprim MMK është finalizuar dhe shtatë të tjera janë në zbatim e sipër.



EULEX-i, MPB-ja dhe PK-ja kanë vërejtur se ekziston nevoja për aftësi policore për një rend publik të fuqishëm dhe efektiv, aftësi të cilat do të mund të përballeshin me trazira të organizuara dhe spontane në çdo pjesë të Kosovës. Njësitë e mëparshme NJRMO janë unifikuar nën një zinxhir të vetëm komandues (tani ato quhen NjPO) duke hapur kështu skenarë për një ndikim pozitiv në menaxhimin e burimeve, trajnimeve dhe operacioneve. Në shkurt 2010 ekspertët përkatës nga EULEX-i raportuan se ishte shënuar progres lidhur me vlerësimin e mospërputhjeve me procedurat e reja standarde të operimit të PK-së, si dhe në punën e monitorimit të trajnimit të pjesëtarëve të njësisë së operacioneve të specializuara të PK-së.

Në mars 2010, filloi puna për fillimin e zbatimit të “planeve vjetore të patrullimeve” si projekt testues në drejtoritë rajonale të Gjilanit dhe Pejës. Në muajin prill, policët e PK-së filluan punën në një numër fushash, përfshirë kështu takimin me udhëheqësit e komuniteteve, shqyrtimin e projekteve të zbatuara nga njësitë e stacioneve për komunitetin, identifikimin e brengave kryesore të sigurisë dhe trendet e krimeve dhe vlerësimin e burimeve që janë në dispozicion. EULEX-i do të vazhdojë të përkrahë zbatimin e këtij veprimi.

Njësitë e Përkrahjes së Specializuar (NjPS). PK-ja dhe homologët e tyre nga EULEX-i me sukses e kanë përmbushur (në prill 2010) veprimin MMK për përcjelljen e Njësisë për Intervenime të Specializuara (NjIS) dhe Njësisë kundër armëve eksplozive të improvizuara (NJAEI). EULEX-i ka kërkuar që të mentorojë dhe këshillojë personelin përkatës të lartë të PK-së lidhur me zhvillimin e një sistemi të kategorizimit dhe regjistrimit të të gjitha incidenteve që kërkojnë praninë e burimeve të NjIS-së dhe atyre kundër armëve eksplozive të improvizuara, dhe të demonstrojë se si të dhënat e tilla mund të përdoren për të planifikuar burimet dhe për të vlerësuar performancën. Gjatë periudhës fillestare të vlerësimit të performancës së PK-së nga ana e EULEX-it (janar – qershor 2009), është zbuluar se menaxherët përkatës të PK-së kishin informata të kufizuara rreth shfrytëzimit të NjIS-së dhe NJAEI. Lidhur me pyetjen e arsyes financiare të vërtetë dhe nevojës për këto njësi, dhe nëse opsione alternative apo më pak të shtrenjta mund të jenë kaq efektive është menduar pak.


Departamenti i EULEX-it për fuqizimin e policisë ka vendosur që të përqendrohet në tri çështje kryesore: 1) zhvillimin e personelit; 2) sistemin efektiv të orarit/ndërrimit të punës dhe 3) një sistem për përcjelljen e përmbushjes së detyrave. Ky departament ka kërkuar krijimin e një sistemi kryesor në të cilin këto tri pjesë do të vepronin në harmoni bazuar në rregulla të përbashkëta. KP-ja është këshilluar që të përgatisë një doracak teknik për personelin që do të përmbante kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë për t’ju bashkuar njësisë. Personeli i EULEX-it gjithashtu e ka këshilluar PK-në që të themelojë regjistra personal që do të përmbanin informata rreth trajnimeve, kurseve, përvojës, certifikimit dhe çështje të tjera. Lidhur me cilësinë e çështjeve të personelit, janë dhënë këshilla që të bëhen ricertifikime të rregullta të tërë personelit të NJAEI-së për të siguruar rifreskimin e shkathtësive dhe njohurive mbi çështjet e NJAEI-së. Personeli i DFP-së gjithashtu ka ofruar mentorim dhe këshillim mbi instalimin e një sistemi të ri elektronik për orarin/ndërrimet e punës që mundëson një pasqyrë të qartë të veprimtarive të planifikuara paraprakisht që secili duhet t’i kryej për çdo muaj.

Gjithashtu, sistemi i të dhënave statistikore të PK-së është zhvilluar më tej dhe ky zhvillim përfshin informata rreth llojeve të incidenteve që janë vijuar, numrit të personelit të dërguar, një përkrahje të

shkurtë të angazhimit dhe rezultatet e operacioneve. PK-ja ka miratuar një sistem të unifikuar të thirrjeve për të ndihmuar një rrjedhë të unifikuar të informatave për çdo thirrje për angazhim. Tani të gjitha thirrjet regjistrohen dhe kalojnë përmes linjës së caktuar për të shmangur ndonjë keqinterpretim të informatave dhe për të eliminuar vonesat e panevojshme për të reaguar ndaj incidenteve ku janë të përfshirë eksplozivët.

SIGURIMI I KUFIJVE

Gjithsej 8 (22%) prej veprimeve MMK për Policinë janë caktuar për Shtyllën e PK-së për Kufij.



Në raportin e programit 2009 është rekomanduar që Shtylla e PK-së për Kufij të përmirësojë dhe rrisë cilësinë e infrastrukturës së saj. Kjo ka përfshirë zhvillimin e strukturave të përhershme dhe ndërtesa të reja, renovimin e ndërtesave ekzistuese, përmirësimi i lidhjeve të shërbimeve dhe atyre komunale, shtimin e lidhjeve bazike më të forta të komunikimit dhe shtimin e hapësirave për intervistimin e të dyshuarve, personave të rrezikuar dhe hapësirat për ndalim të përkohshme. Puna në këtë fushë ka qenë në vazhdim e sipër si pjesë e një projekti ekzistues të PK-së dhe një programi të financuar nga donatorët, dhe ekspertët nga EULEX-i kanë pasur mundësinë të ofrojnë vlera shtesë dhe përkrahje përmes një vargu të veprimtarive të përqendruara të MMK-së, me një theks të fuqishëm për pajtueshmërinë me praktikën më të mirë evropiane dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht.

Deri në shkurt 2010, ekipi i EULEX-it ka raportuar për një progres domethënës. Planifikimi për veprimet në vazhdim e sipër dhe caktimi i afatit kohor për inspektimin e objekteve të ndalimit në të gjitha rajonet, përfshirë edhe në aeroport, vlerësimin e gjendjes aktuale të qelive të ndalimit dhe pajisjet e tjera përkatëse, dhe miratimi i një liste të propozimeve prioritare për përmirësimin e punës janë finalizuar. Në prill 2010, PK-ja konfirmoi se nuk do të kërkonte përkrahje shtesë nga donatorët për arritjen e rezultateve kyçe të këtij veprimi MMK. Udhëheqësit nga PK-ja konfirmuan se nuk kishte ndonjë projekt emergjent me kosto të lartë që nuk do të mund të mbulohej nga buxheti i PK-së apo nga ndonjë prej bashkëbiseduesve ekzistues (tani më është planifikuar asistencë specifike nga BE-ja dhe ICITAP-i).

PK-ja gjithashtu ka konfirmuar se, për të përmirësuar infrastrukturën e komunikimit në Kufij, ka mundësi të ketë nevojë për investime të konsiderueshme kapitale, dhe kështu të ngritet nevoja për ndihmesë domethënëse nga donatorët për të zhvilluar një sistem adekuat dhe modern digjital të komunikimit. Kjo e fundit duket të jetë përtej mundësive buxhetore të PK-së për investime kapitale në afatin e mesëm.

Progres është shënuar edhe për sa i përket hartimit dhe zbatimit të strategjisë për përmirësimin e komunikimeve dhe rrjedhës së informatave në këtë shtyllë. Me përfshirjen e ekspertëve përkatës, është përgatitur një projekt-strategji e PK-së për të përmirësuar komunikimet dhe rrjedhën e informatave dhe kjo përfshinë një përpjekje për të gjetur zgjidhje të përshtatshme për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e PK-së në shpërndarjen e informatave operative nga "lartë poshtë". PK-ja gjithashtu është duke gjetur zgjidhje të përshtatshme për të përmirësuar përdorimin efektiv dhe efikas të sistemeve të veta ekzistuese të komunikimit (siç është PISCES, telefonia, interneti, etj.). Në prill 2010, në vendkalimet kufitare 1 dhe 31 është instaluar lidhja e internetit si dhe lidhja e telefonisë fikse lokale. Ekspertët PK-së për TI kanë deklaruar se 90% e vendkalimeve kufitare janë pajisur me linjë të posaçme të pandërprerë. Për shkak të pranisë së linjave analoge, lidhjet direkte mes pikëkalimeve kufitare nuk kanë mundur të instaloheshin, por kjo do të ishte shumë jopraktike dhe do të kërkonte numër të madh të numrave lokal telefonik për secilin VK. EULEX-i mendon se një opsion i mundshëm do të ishte të pritej për instalimin e rrjetit të planifikuar digjital në mbarë Kosovën.

Përpjekjet për të përkrahur strategjinë afatgjate të Shtyllës së PK-së për Kufij për një sistem të inteligjencës efektive dhe plotësisht të integruar në sistemin global të inteligjencës së PK-së ka parë zhvillime në një numër fushash. Në shkurt 2010 ekspertët nga EULEX-i kanë raportuar se "është duke u shënuar progres i mirë në një numër detyrash, përfshirë zgjerimin e sistemit të komunikimit me

radio dhe shpërndarjen e përmirësuar të informatave brenda Shtyllës së PK-së për Kufij”.

Një fushë tjetër shumë e rëndësishme e zhvillimit të Shtyllës së PK-së për Kufij ishte hartimi dhe zbatimi i strategjisë mbi migracionin e paligjshëm. Në këtë aspekt, EULEX-i ka kërkuar që ekspertët e tij të lejohen që të mentorojnë dhe këshillojnë personelin e lartë përkatës të PK-së lidhur me hartimin dhe zbatimin e strategjisë mbi migracionin e paligjshëm.

Në prill 2010 personeli përkatës i DFP-së raportuan për progres nga ana e homologëve të tyre nga PK-ja. Në mesin e zhvillimeve të tjera, ia vlen të theksohet se PK-ja:


- Ka përgatitur dy Procedura Standarde të Operimit (PSO) për njësitë e Departamentit për Migrim dhe të Huajve (DMH);
- Ka bartur disa përgjegjësi të DMH-së në Departamentin për Shtetësi dhe Azil (DShA) (në kuadër të MPB-së), përfshirë edhe regjistrimin e të huajve;
- Ka zhvilluar një program të përshtatur të trajnimit për personelin kufitar të PK-së, që do të mbahet në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) në Vushtrri;
- Ka përgatitur një udhëzues për çështjet e politikave të vizave, dhe
- Ka transferuar bazën e të dhënave të dokumenteve të Aeroportit në bazën e të dhënave qendrore të PK-së.

Siç është rasti me fushat e tjera të përgjegjësisë së komandës së PK-së, është vërejtur se ka vend për përmirësim të aftësive planifikuese edhe në Shtyllën e PK-së për Kufij. EULEX-i kërkon që të ndihmojë në këtë përpjekje përmes mentorimit dhe këshillimit të personelit të lartë të PK-së lidhur me zhvillimin e PSO-së me hollësi të mjaftueshme për dokumentet planifikuese dhe raportet e vlerësimit, në përputhje me praktikën më të mirë evropiane. Personeli nga EULEX-i do të monitorojë zbatimin e PSO-së si dhe përputhshmërinë nga ana e mbikëqyrësve dhe personelit menaxhues. Progresi i PK-së ka qenë i ngadalshëm dhe data e dakorduar për përfundimin e rishikimit të PSO-së është shtyrë tri herë. Në prill 2010, PK-ja i ka prezantuar homologëve të saj nga EULEX-i një projekt të PSO-së dhe shpresohet se zbatimi i procesit të rishikuar të planifikimit të mund të fillojë gjatë muajve të verës.

KRIJIMI I NJË ORGANIZATE TË QËNDRUESHME

Gjithsej 9 (25%) prej veprimeve MMK për Policinë janë caktuar për Shtyllat e PK-së për Administratë (personeli, trajnimet dhe shërbimet e mbështetjes).

Figura 1.5 - Progresi i Veprimit të MMK - Administrata e PK



Gjatë fazës së dytë të qasjes programore, policia e EULEX-it intensifikoi përkrahjen e drejtpërdrejtë të mentorimit për shumicën e personelit komandues të lartë të PK-së. Në muajin shkurt 2009, u themeluan dy pozita të reja të zëvendës drejtorëve të përgjithshëm. EULEX-i caktoi dy këshilltarë kryesorë për të zhvilluar kapacitetet e posteve të zëvendës drejtorëve dhe për të ngritur më tej bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes të gjithë menaxherëve të lartë të Policisë së Kosovës.

Mentorimi dhe këshillimi formal është përqendruar në çështjet themelore të menaxhimit dhe udhëheqjes, që ndër të tjera përfshin përmirësimin e përkrahjeve të vendeve të punës së zëvendësve, shtimin e ndarjes së kompetencave për vendimmarrje brenda PK-së, përmirësimin e shkathtësive të komunikimit dhe menaxhimit brenda ekipit të lartë menaxhues të PK-së, dhe ndihma e ofruar zëvendësve për të qenë më shumë proaktiv dhe efektiv si vendimmarrës. Si rezultat i intervenimit të tyre të drejtpërdrejtë, këshilltarët nga EULEX-i gjithashtu kanë ndihmuar në vendimin për të përfshirë zëvendësit në projektin e shqyrtimit dhe rishikimit të strukturës së organizimit të PK-së dhe për të siguruar se i tërë materiali informues dhe dokumentet kyçe të jenë në dispozicion në të dy gjuhët.

Këshilltarët nga EULEX-i gjithashtu kanë ofruar përkrahje të konsiderueshme të MMK-së për zëvendës drejtoreshën në përgjegjësinë e saj të veçantë për zhvillimin e strategjisë së re pesëvjeçare të PK-së. Këshilltarët nga EULEX-i për zëvendësit dhe grupin e lartë komandues do të vazhdojnë ta

ndërtojnë partneritetin e suksesshëm lidhur me MMK-në, për sa i përket përgjegjësiive strategjike për strukturën e PK-së, strategjisë pesëvjeçare dhe stacionet e reja policore për të përcjellë procesin e decentralizimit.

Shërbimet e qëndrueshme të TI-së. Një numër i veprimeve MMK, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kanë të bëjnë me përdorimin e bazave të të dhënave dhe teknologjisë informative (TI). Çështja e qëndrueshmërisë së këtyre fushave të zhvillimit lidhet me çështjen thelbësore të kapaciteteve të TI-së së PK-së, në veçanti sa i përket kapaciteteve njerëzore. Siç është cekur në raportin e programit të korrikut 2009, deri në fillim të vitit 2009 PK-ja ishte e varur nga përkrahja e jashtme. Sikurse institucionet e tjera të Kosovës, PK-ja nuk kishte mundësi që të mbante personelin e saj të TI-së dhe të bazave të të dhënave, kryesisht për shkak të pagave më të larta që ofrohen në sektorin privat.

EULEX-i me sukses ka kërkuar që të mentorojë dhe këshillojë personelin e larë përkatës të PK-së mbi përgatitjen e një strategjie për të punësuar, trajnuar dhe, ajo që është më e rëndësishmja, për të mbajtur një ekip të specialistëve vendas të TI-së/komunikimeve për t'i dhënë fund varshmërisë nga specialistët e jashtëm. Ekipet e PK-së dhe të EULEX-it kanë tejkaluar objektivin e tyre fillestar dhe janë duke zhvilluar kompetencat e përgjithshme të personelit të TI-së së PK-së, si dhe janë duke e zgjeruar vargun e shërbimeve të TI-së që ofrohen.

EULEX-i gjithashtu ka kërkuar që të mentorojë dhe këshillojë personelin përkatës të lartë të PK-së mbi kushtet e regjistrave dhe gatishmërinë për t'i integruar ato në një sistem të vetëm kontrollues (regjistrat e qytetarëve, regjistrat e veprave penale, regjistrat e armëve, të pasaportave, të patentë shoferëve, të veturave dhe të veturave të vjedhura). EULEX-i gjithashtu ka ofruar mentorim dhe këshillim lidhur me strukturën e projekteve të ndryshme të TI-së/komunikimeve të PK-së: siç janë dokumentet organizative, llogaritjen e kostove të kohëzgjatjes, nevojat e personelit dhe nevojat e tyre për trajnime, pjesët rezervë dhe mirëmbajtjen. Progresi ka qenë i mirë, ku dy prej gjithsej shtatë rezultateve janë përmbushur (28%).

Ky veprim e plotëson vendimin e marrë në fillim të këtij viti nga Ministri i Punëve të Brendshme për të themeluar një agjenci të re ekzekutive, "Agjencia e Regjistrimit Civil" (ARC). Themelimi i ARC-së bazohet në një vendim të Qeverisë që është marrë në maj 2009. ARC-ja do të jetë përgjegjëse për regjistrimin civil, regjistrimin e gjendjes civile, prodhimin e letërnjoftimeve, regjistrimin e veturave dhe lëshimin e pasaportave dhe patentë shoferëve.

DREJTËSIA

Planifikimi dhe zbatimi i veprimeve të MMK në kuadër të gjyqësorit të Kosovës vazhdon të përcillet nga ekspertët e EULEX-it të cilët e ndajnë kohën e tyre ndërmjet funksioneve kryesore ekzekutive (p.sh. hetimin e krimit dhe ndjekjen e personave të dyshuar për vepra të ndryshme, dhe rastet e gjykimit nëpër gjykata) dhe ofrimin e ndihmës përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit të strukturuar. Ky aranzhim ka kontribuar në ndryshime të rëndësishëm në disa pjesë të gjyqësorit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është funksional dhe kapacitetet e tij për të zhvilluar kompetencat institucionale, do të vazhdojnë të jenë objekt i monitorimit, mentorimit dhe këshillimit (MMK). Pavarësisht progresit të dukshëm i cili është arritur gjatë periudhës së raportimit, KGJK vazhdon të punojë drejt aspekteve sfiduese, ndërkohë që gatishmëria për të luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor të Kosovës do të testohet në muajt e ardhshëm.

Përmbushja e detyrave të punës nga sistemi gjyqësor i Kosovës ende manifeston shenja të dobësisë. Janë vërejtur ndërhyrje në forma dhe nivele të ndryshme. Kjo ndërhyrje në punën e sistemit të drejtësisë, si në procedurat penale ashtu edhe në ato civile, shpesh ka rezultuar me probleme praktike (si për shembull abstenimet e parakohshme të gjykatësve dhe prokurorëve vendas të cilët merren me rastet e ndjeshme).

Numri i madh i lëndëve të pazgjidhura, e sidomos të atyre me natyrë civile, tregon se gjykatësit dhe prokurorët nuk ishin në gjendje të arrijnë progres në adresimin e këtij problemi urgjent.

Kapaciteti i sistemit të drejtësisë penale në Kosovë për të arritur progres në agjendën e reformave, ka mbetur akoma shumë i brishtë dhe i paqëndrueshëm. Mungesa e progresit në krijimin e mekanizmave bazë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet prokurorëve dhe Policisë së Kosovës, siç parashihet me ligj, ende mbetet një faktor shqetësues. Për më tepër, përpjekjet e prokurorisë janë penguar nga menaxhimi i dobët dhe mungesa e personelit mbështetës.

Krijimi i një Task-Force anti-korrupsion në Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK) padyshim se është një hap pozitiv përpara; dhe, përparimi i vazhdueshëm në këtë fushë me siguri që do të kontribuonte në fuqizimin e përgjithshëm në luftën kundër krimit financiar dhe korrupsionit.

Përfundimi i procesit të verifikimit dhe riemërimit për gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës do të ndihmojë në krijimin e një "elani" të duhur për t'i shoqëruar reformat e nevojshme. Ky aspekt duhet të shoqërohet me çështjet e burimeve njerëzore: nivelet e personelit nuk janë të mjaftueshme dhe duhet bërë më shumë që të sigurohet se pozitat e rëndësishme janë të plotësuara me kuadro dhe se personeli ndihmës është i ndarë siç duhet.

Cilësia dhe transparenca e procesit legjislativ duhet të përmirësohet dukshëm, dhe atë vetëm për ta siguruar një kornizë ligjore për Kosovën por për ta përmirësuar edhe besueshmërinë në sistemin ligjor.

Praktika e monitoruar deri më tani tregon se përmirësimi i mëtejshëm është i nevojshëm, në trajtimin e viktimave të dhunës në familje, në rastet e lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore dhe në rastet që ndërlidhen me aspektin gjinor.


Shërbimi Korrektues i Kosovës, shfaq një qasje më proaktive për sa i përket zhvillimit të shërbimit, me anë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha iniciativat e përbashkëta. Ky progres është shënuar në administrimin e burgjeve, menaxhimin e operacioneve dhe të sigurisë, të burgosurit me rrezikshmëri të lartë, përcjelljen e të burgosurve dhe të sigurisë në gjykatë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e pavarësisë dhe të efikasitetit të sistemit gjyqësor. KGJK-ja është një institucion plotësisht i pavarur që ka për synim sigurimin e pavarësi së gjykatave, rolin e tyre profesional dhe të paanshëm, si dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Kosovës duke ndjekur parimet e barazisë gjinore.

Kjo është arritur me rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërimë dhe riemërimë në pozitat brenda gjyqësorit, si dhe ndjekjet disiplinore të gjykatësve. Në mbështetje të qëllimeve të mira të KGJK-së, është përpiluar një veprim MMK me një objektiv të përgjithshëm me qëllim që të ndihmohet KGJK-ja që të bëhet një institucion gjyqësor që promovon një gjyqësi të pavarur, transparente dhe të besueshme, si dhe një institucion që mbështet një qasje të orientuar kah shërbimi.

Ekzistojnë 10 rezultate ambicioze për KGJK-në, duke filluar nga politika e re që e parandalon qasjen e drejtpërdrejtë te gjykatësit, deri te korniza rregullative për përzgjedhjen dhe promovimin, ose për krijimin e sistemit të menaxhimit dhe caktimit të rasteve.



Për shkak të vonesave në emërimë KGJK (në përbërjen e saj të përkohshme) ka filluar punën në mes të gushtit të vitit 2009. Në fazën e parë, KGJK filloi punën me 3 pjesëtarë vendas që nuk janë gjykatës dhe 2 anëtarë ndërkombëtarë (një gjykatës dhe një prokuror nga EULEX-i). Në këtë fazë iniciues KGJK-ja ishte krejtësisht e zënë me çështje disiplinore të mbetura prapa dhe më fazën e parë të procesit të ri-emërimit.

Që atëherë KGJK është marrë më 11 raste të ankesave disiplinore dhe ka bërë disa emërimë të ushtruesve të detyrës së kryetarëve dhe prokurorëve së bashku me disa transfere dhe dorëheqje të gjykatësve dhe prokurorëve. I ka përcjellë rekomandimet e gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe të prokurorëve të Prokurorisë së Shtetit dhe Prokurorisë Speciale, të gjitha të kushtëzuara nga Këshilli

Gjyqësor dhe Prokurorial Ndërkombëtar (KGJPN), te Kryetari i Kosovës. Në këtë periudhë KGJK gjithashtu me vonesë ka aprovuar raportet e gjysmë vjetorit të parë (2009) të Sekretariatit mbi:

- Statistikat,
- Financat,
- Logjistikën,
- TI-në,
- Resurset njerëzore,
- Kontrollat (Auditimet) Gjyqësore dhe
- Zyrën e Komisionit Disiplinor.

Ndikimi i miratimit të raporteve është i ulët, pasi që KGJK nuk ishte e ngarkuar dhe as përgjegjëse gjatë periudhës së raportimit.

Një nga pengesat kyçe për realizimin e detyrave të plota të KGJK-së në fazën e parë të përbërjes së përkohshme të saj ishte ngase nuk ishte akoma e përbërë nga gjykatësit apo prokurorët kosovarë, por vetëm nga avokatë të Kosovës dhe gjykatës ndërkombëtar. Kjo e bëri Këshillin që të hezitojë në marrjen e vendimeve me pasoja afatgjata dhe radikale; sikur kishte tendencë që të përmbahej dhe të merrej vetëm me çështje ditore si një "administrator" i mirë, ndërsa ishin në pritje të anëtarëve të rinj nga gjyqësori (Gjykata Supreme) që t'u bashkohen.

Që nga shkurti i 2010, Këshilli është pasuruar me tre anëtarë të rinj nga gjyqësori: dy gjykatës nga Gjykata Supreme dhe një prokuror nga SPRK. Këshilli e ka votuar gjykatësin (e Gjykatës Supreme) për Kryetar të ri. Meqenëse tashmë Gjyqësori është i përfaqësuar në Këshill, do të ketë edhe më shumë mundësi për Këshillin që të fokusohet në nevojat afatgjate të organizimit të Gjyqësorit. Ndonëse është shumë herët për shenja konkrete të progresit, megjithatë, me miratimin e *Doracakut për Menaxhimin e Gjykatave* në mbarë Kosovën, janë bërë hapat e parë. Aftësia për t'i zbatuar këto masa, në bashkëpunim me Menaxhmentin e Gjykatave, do të jetë një tregues i qartë nëse do bëhen ndryshime të vërteta dhe nëse mund të pritet një progres në të ardhmen e afërt.

Komisioni disiplinor gjyqësor (KDGJ) dhe Zyra e Këshillit Disiplinor (ZKD). Në fazën fillestare të ZKD-së kishte më shumë se 25 seanca dëgjimore dhe 4 vendime (dy suspendime, një shpallje pafajësie dhe një qortim me vërejtje) në përafërsisht 35 raste. Pas një periudhe të diskutimeve të shqyrtuara mbi propozimin për Afatin e Parashkrimit në rastet e vjetra, nga ana e KGJK-së rrodhi përfundimi se një propozim i tillë do të ishte i paligjshëm, prandaj, edhe është refuzuar. Në bazë të këtij vendimi, më 13 prill 2010 KDGJ vendosi mbi 13 raste të mbetura: përfshirë këtu, dy dorëheqje, një anulim të suspendimit për shkak të shpalljes së pafajësisë në një rast kriminal, një rast disiplinor, 5 raste të pafajësisë, 2 raste qortimi me vërejtje, 1 shpallje pafajësie për shkak të shëndetit fizik, dhe 3 fajësi pa sanksione për shkak të kohës që ka kaluar.

Zyra e Këshillit Disiplinor tani është plotësisht funksionale. Shumica e vendeve të lira të punës (hetues dhe përkthyes) janë plotësuar dhe ZKD është dëshmuar e aftë për t'i menaxhuar rreth 60 raste (të shkallës së parë dhe ankesat). Në gjysmën e dytë të 2009, ZKD është bartur nga Ministria e Drejtësisë (MD) te KGJK. Meqenëse ZKD është një trup i pavarur i KGJK-së është shumë e rëndësishme që të sigurohet pavarësia dhe konfidencialiteti gjatë trajtimit të rasteve disiplinore. Në periudhën e vonshme, kishte disa fërkime në mes të Sekretariatit të KGJK-së dhe ZKD-së për disa çështje administrative. Kjo fushë mbetet si çështje për t'u monitoruar edhe më tutje.

Njësia për Auditim Gjyqësor (NJAGJ).

Ndonëse, deri më sot KGJK as nuk është pajtuar dhe as nuk ka aprovuar asnjë raport të NJAGJ-së,

njësia gjatë vitit të kaluar (2009) ka kompletuar 6 raporte auditimi, mbi çështjet që kanë të bëjnë me organizimin gjyqësor. Gjatë muajve të parë të vitit 2010, njësia ka përgatitur një plan 3-vjeçar të auditimit, në konsultim me shumë persona kyç, brenda dhe jashtë gjyqësisë, përfshirë këtu bashkëpunëtorët ndërkombëtar siç janë OSBE dhe EULEX. Përfshirja e rekomandimeve që dalin nga raporti i auditimit në menaxhimin e përditshëm të Gjyqësorit do të jetë një sfidë e vazhdueshme për KGJK-në gjatë viteve në vijim.

Sekretariati. Sekretariati i KGJK-së është një organizatë e centralizuar, si brenda Sekretariatit ashtu edhe në marrëdhëniet e tij me gjykatat dhe menaxhmentin e tyre. Vendimet, edhe ato më të voglat, merren kryesisht në nivelin e lartë, që si tendencë kanë pengimin e iniciativave proaktive dhe kreative. Çështjet që janë me rëndësi për administratën e gjyqësorit ka tendencë t'i caktohen departamenteve/zyrave të ndryshme të Sekretariatit, por në atë formë që kryesisht është e kufizuar në administratë. Cilësia dhe sasia e punës mbetet shumë më e mangët krahasuar me praktikën e mira të BE-së.

Që nga zbatimi i veprimeve MMK që kanë të bëjë me KGJK-në, një përparim është bërë sa i përket çështjeve në vijim:

Logjistika

- ✓ Një sistem i ri i decentralizuar i kërkimit dhe shpërndarjes së furnizimeve për zyre.

TI dhe Statistikat

- ✓ Propozimi për zhvillimin dhe funksionalizimin e planit të IT-së,
- ✓ Bashkëpunimi i KGJK-së dhe EULEX-it mbi SIML,
- ✓ Regjistrimi i rasteve të mbetura në SIML,
- ✓ Trajnimet e SIML për personelin e gjykatave dhe prokurorisë,
- ✓ Nomenklaturat për menaxhimin e informatave,
- ✓ Përafërsisht 85 sekretarë dhe personel tjetër punojnë në mënyrë të efektshme në SIML, dhe
- ✓ Trajnimi individual i SIML për të gjithë gjykatësit dhe personelin relevant në Gjykatën Supreme.

Strategjike

- ✓ Planifikimi i buxhetit (pjesërisht kërkesat buxhetore të menaxhmentit të Gjykatave),
- ✓ Rikryçja e profesionistëve serb të Kosovës në Sistemin Gjyqësor të Kosovës,
- ✓ Vlerësimi i situatës së sigurisë dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë në Gjykatën Supreme,
- ✓ Pilot projekti mbi informatat e gjykatës, dhe
- ✓ Zbatimi i disa Projekt Modeleve të Gjykatave - doracaku për administrimin e gjykatës dhe renovimi i ndërtesave të gjykatave.

Shumica e këtyre të arriturave janë iniciuar ose mbështetur nga bashkëpunëtorët ndërkombëtar.

Në mesin e shumë sfidave, në vijim janë sfidat që ia vlen të theksohen:

- Përgatitja adekuate e takimeve të KGJK-së,
- Të lejohet KGJK të punojë në mënyrë pro-aktive dhe me vizion,
- Të zhvillojë dhe zbatojë një sistem të decentralizuar të planifikimit dhe kontrollit në të

gjitha nivelet (sidomos në buxhet dhe menaxhim të prokurimit, duke pasur parasysh se mbi 20% e buxhetit të viteve 2008 dhe 2009 ka ngelur i pashpenzuar),

- Të decentralizohet dhe profesionalizohet vendim-marrja,
- Të përmirësohet niveli i shërbimeve brenda gjykatave,
- Të sigurohet ambient pune i mbrojtur dhe i sigurt për gjithë personelin e gjyqësorit,
- Të sigurohen shërbime të sigurta të TI-së dhe të internetit,
- Të zhvillohen politika moderne për resurset njerëzore,
- Të prezantohet dhe mirëmbahet zhvillimi i menaxhmentit,
- Të profesionalizohet përmbajtja informative e ueb faqes dhe informatave tjera publike,
- Të nxitet dhe mbështetet zbatimi i plotë i Sistemit Informativ të Menaxhmit të Lëndëve jo vetëm në një nivel të TI-së, por – edhe në nivelin menaxhues dhe kulturor – që edhe është më e rëndësishmja, dhe
- Të ripërpilohen procedurat dhe të rrimërohet personeli.

Krahas këtyre sfidave, Sekretariati do të ballafaqohet me një numër çështjesh tjera, përfshi këtu: zbatimin e Ligjit mbi Gjykatat, Ligjit mbi KGJK-në, Ligjin e punës/Shërbyesit Civil, zhvendosja në vende tjera të punës e qindra gjykatësve, dhe ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë në Prishtinë. Ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë ka për qëllim ngritjen e funksionalizimit, qasjen e opinionit të gjerë dhe besueshmërinë, si dhe perceptimin mbi sistemin e drejtësisë. ECLLO ka paralogaritur një mbështetje të drejtpërdrejtë nga BE në vlerë prej 25 milion EUR, nën ombrellën e Programit IPA të vitit 2008.

Gjykatësit

Puna e MMK-së e bërë nga ana e gjykatësve të EULEX-it, e mbështetur nga zyrtarët ligjor/këshilltarët e EULEX-it, është fokusuar në KGJK (3 fusha të zhvillimit) dhe Gjykata (4 fusha të zhvillimit).

- Fuqizimi dhe mbrojtja e pavarësisë së Gjyqësorit (KGJK);
- Sistemi i caktimit të lëndëve në gjykatat e Kosovës (KGJK);
- Shpërndarja e Gazetës Zyrtare në të gjitha Gjykatat e Kosovës (KGJK);
- Menaxhimi i ekzekutimit të rasteve pas ankimit (Gjykatat);
- Qasja në Gjykata (Gjykatat);
- Themelimi i sistemit për regjistrim, vlerësim dhe shërbime të ankesave dhe rasteve penale (Gjykatat); dhe
- Krijimi i një sistemi për caktimin adekuat të lëndëve (Gjykatat).

Pavarësia. Pas gati dy vjet pjesëmarrje të EULEX-it në sistemin gjyqësor të Kosovës, është arritur pika kyçe që ka reflektuar me një numër të rasteve (penale dhe civile) dhe situatave që ndërlidhen me rastet, që për efekt kishte krijimin e pengesave për realizimin e duhur dhe të saktë të detyrave ligjore dhe funksioneve ligjore:

(1) Në Komunën e Vitisë, Kryetari i Komunës dhe Asambleja Komunale vazhdojnë të mos i respektojnë vendimet e ndryshme të gjykatës, e sidomos ato që kanë të bëjnë me çështje pronësore, në veçanti ato që kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Shoqërore (NSH). Duket se Kryetari i Komunës sidomos nuk e respekton funksionin e Agjencisë Kosovare për Privatizim (AKP), i cili tani – 15 qershor 2008 – ka marrë përsipër funksionet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), sipas Nenit. 1 të Ligjit mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim, Gazeta Zyrtare nr. 30/2008. Pretendohet se problemi bazohet në mospërputhshmërinë mes Rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të

Kombeve të Bashkuara dhe Kushtetutës së Kosovës, e që kjo e fundit mund të njihet si e vlefshme vetëm nëse deklarata e pavarësisë së Kosovës do të shihej si e vlefshme dhe në pajtueshmëri me ligjet ndërkombëtare. Përderisa AKM është funksionalizuar përmes Rezolutës së UNMIK-ut, dhe në pajtim me këtë edhe është miratuar përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), AKP është themeluar përmes Ligjit mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Gazeta Zyrtare nr. 30/2008, që është nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës, dhe është shpallur nga Kryetari i Kosovës, por jo edhe nga PSSP-ja. Për më tepër, funksionet e AKP-së si pasardhëse e AKM-së në përgjithësi nuk pranohen aq më tepër që AKM nuk ka pushuar së ekzistuari por vetëm ka pushuar së punuari. Sidoqoftë, kryetari i komunës së Vitisë duket se është i mendimit se ish NSH tashmë në mënyrë automatike janë bërë pronë e komunës meqenëse procesi i privatizimit nuk është përfunduar nga AKP-ja – dhe kështu veprimet e tija kanë krijuar pengesa për procedurat e rregullta (gjyqësore) dhe e dëmtojnë sistemin juridik të Kosovës si dhe ndikojnë në besimin e opinionit të gjerë në Legjislativin e Kosovës.

(2) Me kërkesë të Gjykatës Komunale të Vitisë dhe Gjykatës së Qarkut në Gjilan, EULEX ka marrë përsipër rastin e parë në rajon “Klubi i Gjuetarëve Drenusha” (E. nr. 393/08) mbi të drejtat pronësore, rast ky tashmë në fazën e ekzekutimit. Shoqata e gjuetarëve “Drenusha” ka parashtruar një ankesë kundër Komunës së Vitisë si detyruës për kthim të pronësisë dhe përdorim të pronës. Pasi që vendimi i parë për shpronësim, i marrë nga Gjykata Komunale (GJK) e Vitisë kundër Komunës së Vitisë dhe në favor të Shoqatës së Gjuetarëve, është ekzekutuar me sukses, Komuna, pas disa ditësh në mënyrë ilegale e ka zënë të njëjtin objekt dhe me këtë ka nxitur nevojën për një ri-shpronësim. Për shkak të përpjekjeve serioze të ndërmarra nga Komuna, e që ndërlidhen me sigurinë, EULEX e ka zhvilluar një plan për ri-shpronësim, i cili është dashur të bëjë të mundur ekzekutimin në tre hapa dhe atë gjatë një periudhe kohore dyjavore. PK është dashur të bëjë ekzekutimin e vendimit për shpronësim. Një natë para se është dashur të bëhet shpronësimi fizik, disa keqbërës me maska i kanë zënë rojet e objektit në fjalë, kanë vendosur eksploziv dhe e kanë ngritur ndërtesën në ajër.

(3) EULEX-i gjithashtu e ka marrë përsipër edhe rastin e komunës së Vitisë si ankues kundër Klubit të Gjuetarëve Drenusha si debitor në të drejtat pronësore (C. Nr. 66/2009) si dhe rastit të Banjës/Qendrës Rehabilituese në Kllokot si ankues kundër Komunës së Vitisë si debitor në verifikimin e pronësisë (C. nr. 220/08). Të dy rastet nuk e kanë arritur akoma fazën finale dhe akoma mund të parashtrohen ankesa, por kanë prapaska të ngjashme si dhe rasti i mëparshëm.

(4) Në rastin që ndërlidhet me krimet e luftës, kundër “Grupit të Llapit”, që është gjykuar nga një panel i përzier (dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjykatës kosovar) i Gjykatës së Qarkut (GJQ) Prishtinë, dhe me ç’rast, në mesin e të pandehurve ishte edhe një anëtar i Qeverisë së Kosovës, vet Kryeministri i Kosovës ka intervenuar personalisht, duke deklaruar për media se ai priste që EULEX-i të ishte më i mençur se sa që ishte UNMIK-u, dhe se ai është i bindur se asnjë vendim tjetër nuk mund të merret nga gjykata veç atij se pjesëtari i qeverisë, një luftëtar për lirinë e Kosovës, nuk ishte fajtor dhe se do të shpallej i pafajshëm. Pas marrjes së vendimit nga ana e GJQ me ç’rast të pandehurit u shpallën fajtorë, dhe u dënuan prej dy deri në katër vjet burgim, gjykatësi vendas i është drejtuar Gjykatësit Kryesues të EULEX-it dhe i ka kërkuar që ta fshijë emrin e tij nga procesverbali – pasi që nuk u përfill kërkesa e tij – ai dha një intervistë për TV me ç’rast deklaroi se ai ishte detyruar të marrë pjesë në procesin gjyqësor dhe se më pas ishte mbivotuar nga gjykatësit ndërkombëtar. KGJK ka ndërmarrë masa disiplinore kundër tij për mosrespektim të fshehtësisë me paramendim.

(5) Në rastin penal kundër Albin Kurtit, një rrjet i organizatave të shoqërisë civile ka mbledhur rreth 150.000 nënshkrime në mesin e qytetarëve të Kosovës dhe në mesin e popullatës shqiptare në shtetet përreth, dhe kështu ka mbështetur një peticion i cili i është dërguar Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që ta ndalin urdhëresën për një proces gjyqësor kundër Albin Kurtit. Kuvendi i Kosovës ka diskutuar për çështjen dhe ndarjen e përgjegjësive por ka refuzuar të flasë për arsyeshmërinë e

petitionit. Sido që të jetë, në gjykatën e Qarkut në Prishtinë paneli kryesor i gjykimit përbëhej prej dy gjykatësve të EULEX-it dhe një gjykatësi kosovar, por një numër i pengesave është shpërfaqur dhe e ka bërë deri më tani të pamundur që të vazhdohet me rastin. Pastaj i pandehuri nuk është paraqitur para Gjykatës me ç'rast një urdhër-arrest është lëshuar nga Gjykatësi Kryesues i EULEX, dhe për habi gjykatësi kosovar është deklaruar i sëmure dhe ka shkuar në shtëpi. Për një kohë të gjatë as nuk ishte e mundur që të bindej gjykatësi që të kthehej në panel (edhe pse ai/ajo nuk ka dhënë asnjë dëshmi mjekësore për sëmundjen e tij/saj) dhe as që të gjendej një gjykatës kosovar i cili do të ishte i gatshëm që ta zëvendësonte atë. Gjithashtu, asnjë avokat kosovar nuk ishte i gatshëm që ta mbronte Albin Kurtin. Prandaj, urdhër-arresti nuk është ekzekutuar, sepse nuk ekzistonte një panel gjyqësor për seancën dëgjimore. Më në fund, me kërkesë të KGJK-së, gjykatësi kosovar është kthyer në panel dhe një mbrojtës është caktuar me sukses për rastin. Ai është shfaqur para Gjykatës vetëm një herë (edhe pse i pandehuri nuk është paraqitur) dhe më pas ka refuzuar që të vazhdojë me mbrojtjen e Albin Kurtit. Gjykatësi kryesues nuk e ka liruar avokatin mbrojtës por e ka emëruar kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës. Më pas, urdhër-arresti është ekzekutuar kundër Albin Kurtit. PK në dy raste nuk ia doli që ta ekzekutoj urdhër-arrestin. Rasti akoma është i hapur.

(6) Në rastin penal kundër kryesve të supozuar të vrasjes të familjes së Hamëz Hajra (Hamëz Hajra më përpara ishte i punësuar nga Qeveria e Serbisë si polic) e cila në vitin 2001 po kthehej në shtëpi nga një dasmë dhe me këtë rast është zënë në pritë dhe është ekzekutuar duke u goditur nga armë automatike AK47 përderisa ishin të ulur në automjetin e tyre (Hamëz Hajra dhe gruaja e tij, djali i madh dhe dy nga tri vajzat e mitura janë vrarë, ndërsa një vajzë ka mbijetuar dhe është shfaqur si dëshmitare para gjykatës), 10 kryerës të supozuar të veprës janë akuzuar dhe gjykuar me të njëjtën procedurë. Në shkallën e parë shumica e tyre janë shpallur fajtor dhe janë dënuar me burg prej katër deri në 30 vjet. Në shkallën dytë, sidomos dënimet e gjata prej 30 vjet kundër Agim Ramadanit dhe Arben Këçina janë konfirmuar. Gjithashtu edhe në shkallën e tretë, gjykata Supreme i ka konfirmuar këto dënime. Që të tre të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre kanë parashtruar kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë. Para se rasti të merrej nga Gjykata Supreme dhe para se të caktohej gjykatësi, Vetëvendosja ka organizuar një demonstratë, në të cilën të tre të pandehurit e lartpërmendur janë ngritur deri në hero të luftës dhe me ç'rast kryetari i Gjykatës Supreme është sulmuar personalisht sepse ishte i ulur si gjykatës në njërin prej paneleve të lartpërmendur. Gjithashtu janë varur posterë në Prishtinë, përmes të cilëve kërkohej "Drejtësi për Heronjtë". Për më tepër, një nga avokatët mbrojtës të njërit prej të pandehurve e ka botuar një broshurë me të cilën fajëson UNMIK-un dhe EULEX-in për padrejtësitë që janë bërë në të tre rastet e "heronjve" të pafajshëm, në bazë të ligjit penal.

(7) Në rastin Ukshini që ka të bëjë me krimet e luftës, i cili akoma është duke u proceduar në GJQ të Gjilanit, është caktuar një gjykatës kosovar për panelin që përbëhet prej tre gjykatësve dhe që atëherë ka marrë kërcënime anonime përmes telefonit si dhe e ka kuptuar se disa persona të panjohur në mënyrë të frikshme po ia përcjellin të birin nëpër rrugë. Për këtë arsye gjykatësi ka kërkuar masa por akoma nuk ka shpërfaqur ndonjë intencë që të tërhiqet nga rasti.

(8) Dhe së fundi, situatë e pakënaqshme në Mitrovicë. Gjykatësit shqiptar të Kosovës, për arsye sigurie, janë të vendosur në objektet e Gjykatës Komunale të Vushtrrisë, nga ku ata merren ekskluzivisht me çështje të procedurës paraprake, ndërsa EULEX-i ka krijuar një panel krejtësisht ndërkombëtar, i cili i ka përzgjedhur 50 raste urgjente për t'i shqyrtuar, ngase të pandehurit janë në paraburgim në pritje të gjykimit për një kohë të gjatë, e në disa raste për vite të tëra. Deri më tani nuk ishte e mundur që të angazhohen dy gjykatës serb për GJQ në Mitrovicë në mënyrë që të arrihet balansi etnik në mesin e gjykatësve. EULEX-i e ka paraparë si zgjidhje emërimin e dy gjykatësve serb, të cilët janë akoma nën kontratë të UNMIK-ut por që nuk punojnë më në Kosovë. Sidoqoftë, ata në ndërkohë janë gjithashtu nën kontratë si gjykatës edhe në Serbi. Edhe pse Serbia ishte e gatshme që ta diskutojë dhënien e një pushimi të veçantë për gjykatësit dhe t'i dërgojë me punë në Mitrovicë, kjo

zgjdhje nuk është pranuar, as nga Kryetari i Kosovës dhe as nga KGJK-ja.

Shembujt e mësipërm ilustrojnë sfidat nëpër të cilat kalojnë gjykatësit, prokurorët dhe avokatët mbrojtës vendas në mjedisin tejte të politizuar të Kosovës. Gatishmëria e tyre që të marrin pjesë apo/dhe që të marrin primatin në gjykimin e rasteve të korrupsionit ose krimin të organizuar shpesh është i paralizuar nga kërcënimet kundër tyre dhe familjeve të tyre. Sidoqoftë, shumë shpesh ngurrimi për të marrë pjesë në hetime dhe gjykime ndonjëherë mund të interpretohet edhe si mospajtim i heshtur me veprimet e EULEX-it në fushën e drejtësisë (p.sh. dënimi i "heronjve të luftës").

Mentorimi aktiv do të vazhdojë që t'i mbështesë kolegët vendas në marrjen e veprimeve/reaksioneve të drejtpërdrejta në mbrojtje të pavarësisë dhe parandalimin e cenimit të gjyqësorit.

Gazeta Zyrtare. Gjykatësit e EULEX-it raportojnë se zbatimi i MMK-ve për shpërndarjen e Gazetës Zyrtare nëpër gjykata është përmbushur. Dhe tani varet nga KGJK-ja vazhdimi i zbatimit të këtij aktiviteti në mbarë Kosovën, duke siguruar një shpërndarje adekuate të gazetës në të dy gjuhët zyrtare në të gjitha gjykatat.

Sistemi informativ për menaxhimin e gjykatave (SIMGJ).

Trajnimi i të gjithë gjykatësve përkatës të EULEX-it është kompletuar, dhe ata janë lidhur me rrjetin SIMGJ. Problemet aktuale që kanë të bëjnë me lidhjet, e që po e rëndojnë përdorimin efikas të sistemit, në momentin e shkrimit janë zgjidhur nga KGJK-ja.

Sistemi i caktimit të lëndëve.

Një progres i konsiderueshëm është arritur në përdorimin e sistemit transparent dhe objektiv të caktimit të lëndëve. Një numër udhëzimesh të propozuara për sa i përket caktimit të rasteve nuk janë vënë në të shkruar. Caktimi i lëndëve për gjykatësit tani bëhet në baza rotative, që varet në numrin referues të lëndës. Në fillim të çdo muaji një fletë me informata të detajuara për lëndët është në dispozicion në një tabelë (përfshirë këtu numrin referues, datat e seancave dëgjimore, llojet e lëndëve, sallat gjyqësore, etj.) Nëse një gjykatës është në raport me ndonjërin nga palët në kontest, një tjetër gjykatës do të emërohet që të punojë në lëndë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka një diagram të organizatës, i cili rinovohet çdo vit, dhe i cili i ndan gjykatësit sipas degëve: penale, civile dhe administrative, dhe i cili paraqet përbërjen e paneleve si dhe shpërndarjen e çështjeve të ndryshme në mes të paneleve të ndryshme. Përkundër praktikave të mira të lartpërmendura, megjithatë ka akoma një ngurrim që të fuqizohet sistemi i caktimit të lëndëve në çdo gjykatë pasi që KGJK-ja akoma nuk e ka aprovuar një rregullore të përgjithshme. Problemet e jashtëzakonshme përfshijnë me sa vijon:

- Diagramet e organizatave akoma nuk janë zhvilluar në të gjitha gjykatat e Kosovës;
- Ka akoma hezitim në përqafimin e diagrameve të shkruara ngase ato janë në kundërshtim me "rregullat tradicionale" ose ngase besohet se është absurd të bësh publike gjërat si këto;
- Në disa gjykata, ndarja e lëndëve mbetet e pabarabartë mes gjykatësve;
- Disa GJK më të vogla e kanë të pamundur që t'i caktojnë lëndët sipas rregullave;
- Një sistem i rrotacionit për zëvendësimin e gjykatësve akoma nuk është vendosur (p.sh. në rast të ndonjë të papriture e cila pamundëson pjesëmarrjen e gjykatësit kryesues në një sesion, sekretari do t'i njoftoj palët për shtyrjen e seancës dëgjimore);
- Në disa gjykata, përkundër ekzistimit të sistemit të caktimit, është kryetari i GJK ai i cili

vendosë së cila lëndë është për cilin gjykatës;

- Sistemi i caktimit të lëndëve duhet të organizojë edhe zëvendësimin e gjykatësit raportues, zëvendësimin e gjykatësit të diskualifikuar si dhe sistemin e kujdestarisë në- thirrje për raste urgjente gjatë vikendit (p.sh. për ankesat kundër urdhëresave për paraburgim me kërkesë ose masa tjera të sigurisë).

Veprimi MMK për sistemin e caktimit të lëndëve me të madhe është pranuar, dhe në një masë të madhe është zbatuar. Vetëm disa gjykata kërkojnë aktivitete të monitorimit të afërt në këtë çështje. Sidoqoftë, ia vlen të nënvizohet se nuk ka ndonjë strategji relevante të KGJK-së mbi sistemin e caktimit të lëndëve dhe nuk është miratuar asnjë udhëzim administrativ në këtë temë. Kjo është një pengesë, ngase disa nga gjykatësit vendas konsiderojnë se sistemi nuk është në gjendje të funksionojë në mënyrë të tërësishme pa u qeverisur në mënyrë të centralizuar nga një akt ligjor që është në tërësi i zbatueshëm në sistemin gjyqësor. Në mungesë të këtij akti, zbatimi i një sistemi objektiv të caktimit të lëndëve mbetet i paqëndrueshëm.

Përmirësimi i sistemit të drejtësisë së Kosovës në gjykata.

Ka akoma disa dobësi në veprimtarinë ditore të gjykatave:

- Disa Gjykatave të Qarkut (GJQ) dhe Gjykatave Komunale (GJK) u mungon sistemi i rotacionit që siguron disponueshmërinë e personelit të gjykatës në çdo kohë edhe gjatë pranimit në gjykatë, sidomos gjatë orëve të pushimit të drekës;
- Në një GJQ, është zhvilluar një praktikë shqetësuese e cila ndërhyjnë me natyrën publike të gjykimit: çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë në gjykim duhet të plotësojë të ashtuquajturën “kërkesë për pjesëmarrje në gjykimin kryesor” disa ditë para seancës gjyqësore, dhe kjo duhet të aprovohet nga gjykatësi kryesues. Forma kërkon informata personale, si marrëdhënia me palën dhe nëse personi është dëshmitarë ose jo.

Zbatimi i veprimeve MMK mbi qasjen në gjykata i ofron opinionit të gjerë qasje më gjithëpërfshirëse në dosjet dhe dokumentet gjyqësore, si dhe informatat për orarin e punës së gjykatës. Sidoqoftë, një monitorim dhe mentorim i afërt gjithashtu janë ende të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e praktikave të reja.

Rastet e krimeve të rënda. Një numër i rasteve të krimeve të rënda është monitoruar gjatë periudhës raportuese, në mënyrë që të vlerësohet gjykimi përkatës i rastit. Listat e verifikimit janë përdorur gjatë punës, si dhe gjykimi ligjor dhe është vlerësuar pesha e dëshmive. Në mesin e të dhënave më të rëndësishme të nxjerra nga personeli i EULEX-it janë:

- Statistikat (të disponueshme në KGJK) tregojnë një ngritje të rasteve të mbetura të tentim vrasjeve, vrasjeve të rënda, vrasjeve nga pakujdesia, dhe dëmtimeve të rënda trupore;
- Në shumë raste seancat gjyqësore kanë filluar me më shumë se 30 minuta vonesë, shpesh pa dhënë ndonjë shpjegim adekuat për vonesën nga ana e gjykatësit kryesues;
- Në të dy rastet si ato të krimeve dhe në të tjerat, seancat janë shtyrë/pezulluar disa herë për javë dhe muaj të tërë; disa seanca janë pezulluar për shkak të mos paraqitjes së dëshmitarëve, avokatëve dhe prokurorëve;
- Me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit paneli ka vazhduar menjëherë me fjalimet përmbjllëse, dhe asnjë provë tjetër nuk është paraqitur në gjykimin kryesor;
- Gjatë marrjes së vendimit është praktikë e zakonshme që personit të dënuar t’i kërkohej që të bëjë një shpresë me të cilën do të shkruaj se ai/ajo nuk e ka ndërmend të parashtrij ankesë: kjo praktikë e paligjshme ka ndryshuar pas diskutimit me administratorin e gjykatës;
- Ka një tendencë në mesin e gjykatësve që të kenë preferenca karshi prokurorëve në dëm

të pandehurve (p.sh. kundërshtimi i kërkesës së mbrojtjes); mungesa e objekteve të specializuara për personat me sëmundje mendore të cilët kanë marrë dënimin e përkujdesjes; hutim në rastet e masës mbrojtëse.

Nisur nga këto të dhëna MMK do të vazhdojë të jetë një çështje me prioritet.

Grupet e pambrojtura, të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore.

Praktika të mira janë vërejtur në disa raste për të miturit, me gjykatës i cili i jep një rëndësi të veçantë të drejtave të pandehurit. Në monitorimin e rasteve të dhunës në familje, gjykatësit e EULEX-it kanë vërejtur me sa vijon:

- Oraret në përgjithësi respektohen;
- Të paditurit mungojnë në seanca në bazë të kërkesës së mbrojtjes;
- Viktimave iu mundësohet që të shprehen lirshëm;
- Gjykatësit provojnë të bëjnë pajtimin e qifteve në vend se të nxjerrin një urdhër për mbrojtje;
- Masat e nxjerra në urdhëresën mbrojtëse kanë tendencë të jenë të buta karshi përgjegjësit (për shembull, një masë me të cilën i ndalohet të paditurit që të mbesë në shtëpi kurrë nuk është lëshuar); dhe
- Veprat penale të pandehurit si lëndimet e lehta trupor dhe/ose shkelja e urdhrave të mbrojtjes rrallë janë trajtuar *sipas detyrës zyrtare*.

Gjykatësit e EULEX-it nuk i kanë monitoruar gjykimet në rastet të trafikimit të qenieve njerëzore (TQNJ), meqenëse nuk pati as edhe një rast mes dhjetorit të 2009 dhe prillit të 2010.

Gjatë monitorimit të rasteve që kanë të bëjnë me gjininë, si abuzimi seksual/dhunimi, është vërejtur se gjykatësit kanë tendencë të merren me rastin vetëm atëherë kur i pandehuri pranon fajësinë; kjo praktikë nuk lë hapësirë për hetime gjithëpërfshirëse dhe vënien në vend të fakteve. Gjithashtu, keq-projektimi i veprës penale (p.sh. përdorimi i nocionit abuzim seksual në vend të nocionit dhunim) është vërejtur në disa raste. Dhe së fundmi në rastet e shkurorëzimeve, gjykatësit vendas i kanë mohuar viktimave femra, të cilat kanë qenë pre e dhunës familjare, të drejtën e angazhimit dhe prezencës së avokatit gjatë seancës (dhe me këtë ofrimin e mbështetjes ligjore).

Praktikat e monitoruara deri më tani kanë demonstruar nevojën për përmirësime të mëtutjeshme në trajtimin e viktimave dhe MMK-ja do të vazhdojë me dhunën në familje dhe trafikimin me qenie njerëzore si dhe me seancat që kanë të bëjnë me gjininë. Kjo periudhë e monitorimit mund të pasohet më një fazë monitoruese në të gjitha GJK/GJQ në mes të gjykatësve të EULEX-it dhe atyre vendas mbi trajtimin e viktimave nga ana e gjyqësorit dhe përmirësimet e mundshme.

Reagimi i gjyqësorit në deklaratat e rrejtshme të dëshmitarëve.

Në bazë të monitorimit të EULEX-it, duket së përdorimi i dëshmimeve të rreme ose atyre shumëkuptimshme, ose e deklaratave gjysmake është një dukuri shumë e përhapur në gjykime. Meqenëse ky trend është i ndërlidhur me një numër ta faktorëve kulturor, veprimi MMK ka qenë i kufizuar në ngritjen e vetëdijes në mesin e kolegëve vendas mbi këtë çështje kyçe dhe metodat e ndërhyrjes ose minimizimit të ndikimit të tyre në proceset gjyqësore (p.sh. përmes teknikave të ekzaminimit të hollësishëm dhe pyetjes adekuate nga gjykatësi kryesues). EULEX do të

vazhdoj me ngritjen e vetëdijes për sa i përket kësaj çështje dhe në pajtim me këtë do t'i monitoroj edhe gjykimet.

Mbrojtja e dëshmitarëve. Duket se gjyqësori dhe prokuroria vendase në masë të madhe i anashkalojnë dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale për respektimin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Gjykatësit thonë se nuk janë në pozitë që t'i mbrojnë dëshmitarët, duke rikujtuar se edhe ata janë duke vuajtur nga i njëjti problem: mungesa e sigurisë personale. Sidoqoftë, pas këshillave mbi masat e ndryshme mbrojtëse dhe urdhëresave për anonimitet ata kanë theksuar se nuk kishin njohuri praktike për implementimin e tyre dhe kërkuan këshilla nga EULEX. Në disa raste "të profilit të lartë" është vënë re se përpjekjet janë bërë që të garantohet mbrojtja e dëshmitarëve për dëshmitarët kryesor gjatë gjykimet. Në një rast, gjykatësi kryesues i ka vendosur dy zyrtarë policie për kontakt dhe përcjellje të dëshmitarit. Gjatë shqyrtimit zërat e tyre janë shtrembëruar dhe ishin vendosur fizikisht në një dhomë të veçantë, me hyrje të veçantë.

Nëse e shpërfillim faktin se niveli i mbrojtjes mbetet i ulët, duket se përgjegjësia për ndërmarrjen e iniciativave për organizimin e mbrojtjes për dëshmitarë është marrë si opsion primar prokurorial në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Urdhër-arrestet. Ekzekutimi i urdhër-arresteve vendore dhe ndërkombëtare është një nga vështirësitë kryesore me të cilën ballafaqohet Gjyqësori i Kosovës. Përkundër një mori burimesh që shpjegojnë gabimet në ekzekutimin e urdhër-arresteve, duhet theksuar se për gjykatësit vendas ato janë të jashtme.

Urdhër-arrestet vendase zakonisht lëshohen kur i pandehuri, pasi që është lajmëruar në kohë, nuk paraqitet para gjykatësit. Është një mendim i gjykatësve vendas se Policia e Kosovës në përgjithësi i ekzekuton ato sipas kërkesës, përveç në raste të rralla kur ka të bëjë me ndonjë rast të ndjeshëm. Në këto raste mund të priten vonesa të gjata para se të gjendet i pandehuri.

Paraburgimi në pritje të gjykimet. Gjykatësit e EULEX-it kanë bërë një MMK mbi paraburgimin në pritje të gjykimet në të gjitha GJQ dhe në disa GJK në mënyrë që t'i inkurajojnë gjykatësit që t'i marrin parasysh masat alternative të cilat do të sigurojnë paraqitjen e të pandehurit në seancën gjyqësore. Në mesin e gjykatësve vendas kishte një tendencë që në rastet serioze të përdoret paraburgimi në pritje të gjykimet si alternativë e vetme. MMK-ja do të vazhdojë ta reduktojë këtë tendencë, gjatë përpjekjes për të fuqizuar faktorin kohë dhe arsyen e paraburgimit, së bashku me familjarizimin me masat alternative.

Përmbartimi i vendimeve të gjykatës civile. Të dhënat mbi përmbartimin e rasteve të ankesave kanë dalë nga monitorimi dhe mentorimi i aktiviteteve të gjykatësve të EULEX-it, në konsultim të afërt me bashkëpunëtorët e tyre. Këto aktivitete kanë zbuluar se në gjykatat e shkallës së parë – në praktikë – tentohet të ndalohet një procedurë kur është bërë ankesë ndaj rastit në përmbartim dhe nuk vazhdojnë me përmbartimin derisa gjykata të mos marrë një vendim.

Prandaj, duke synuar uljen e grumbullimit të rasteve të mbetura, ekspertët e EULEX-it kanë rekomanduar që, çdo herë kur është paraqitur ankesë në rastet për përmbartim, një kopje e vërtetuar e dosjes duhet të mbetet me gjykatën e shkallës së parë në mënyrë që të lejohet përmbartimi i procedurës derisa të mos vendoset mbi ankesën nga shkalla e dytë dhe atë me dokumente origjinale.

Analizimi i rasteve tregon praktikën e gjykatave në përgjithësi nuk janë në përputhje me ligjin.

Vështirësitë kryesore përfshijnë:

- Kohëzgjatjen e përmbartimit (në disa raste duhen vite të tëra, për shkak të mungesës së gjykatësve përmbartues dhe zyrtarëve);
- Në disa GJK, numri i rasteve të përmbartuara është shtuar ndjeshëm, sidomos rastet që kanë të bëjnë me "shërbimet komunale" (p.sh. Korporata Energjetike e Kosovës-KEK);
- Në disa raste, kur ka ankesë ndaj përmbartimit të një rasti civil, skeda origjinale në tërësi është akoma nga gjykata komunale për në gjykatën e qarkut, dhe asnjë kopje nuk është mbajtur në gjykatën e shkallës së parë; prandaj, përmbartimi mbahet peng deri sa të mos vendoset mbi ankesën nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Përkundër faktit se disa gjykata tani i dërgojnë vetëm kopjet e dosjeve të rastit tek gjykata ku është bërë ankesa dhe i mbajnë skedat origjinale të rastit në mënyrë që të vazhdojnë me procedurat e përmbartimit, megjithatë këshilla nuk është përfillur në mbarë Kosovën. Përpjekja e konsiderueshme përmes monitorimit të gjykatësve vendas do të vazhdojë, në mënyrë që të përmirësohen praktikat vendore.

Rastet e pezulluara përkohësisht. Një numër prej rreth 20,000 – 22,000 kërkesave për kompensim është regjistruar në periudhën 2004-2005 kundër KFOR-it, UNMIK-ut dhe autoriteteve vendase të Kosovës (Komunat dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse). Sipas parashtruesve të ankesave, këto organizata kanë dështuar në mbrojtjen e pronës së ankuesve gjatë ngjarjeve të vitit 1999 dhe trazirave të marsit të vitit 2004, prandaj në mënyrë indirekte kanë shkaktuar dëme të pronës dhe pasurisë private. Pjesën më të madhe të ankesave e kanë parashtruar serbët e Kosovës. Një pjesë tjetër e ankesave është parashtruar nga ana e komunitetit shqiptarë kundër qeverisë serbe, kundër Republikës së Serbisë dhe Malit të zi dhe ish-Republikës së Jugosllavisë, duke kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara nga trupat serbe në tërheqje në vitin 1999. Pezullimi i këtyre rasteve është bërë duke u bazuar në një letër të departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut e cila në gusht të vitit 2004 i drejtohej gjykatave të Kosovës. Përmes një komunikimi të dytë ne shtator të 2008, UNMIK-u e hoqi pezullimin dhe gjykatave iu mundësua fillimi i përbaljes me këtë numër të madh të lëndëve të mbetura. Zvogëlimi i numrit të madh të rasteve është deklaruar si prioritet i gjykatësve të EULEX-it.

Përmes monitorimit të punës së gjykatave të Kosovës, gjykatësit e EULEX-it kanë identifikuar një numër të problemeve me rastet e pezulluara, duke përfshirë:

- Numri shumë i madh i lëndëve;
- Resurse të pamjaftueshme, përfshirë të dyja, stafin (numrin e pamjaftueshëm të gjykatësve dhe personelit për t'i përkthyer ankesat sidomos nga gjuha serbe) dhe pajisjet teknike;
- Sipas nenit 68 të ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe llogaridhënies, të gjitha rastet e mbetura të cilat përmbajnë ankesa kundër "Autoritetit Publik" duhet t'i raportohen MD-së dhe MEF-it. Meqenëse një numër i rasteve të mbetura janë kërkesa për kompensim të cilat i drejtohen autoriteteve publike të Kosovës (Komunës ose Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes), gjykatat janë të obliguara që t'i njoftojnë ministritë. Cilido rast i kësaj natyre do të pezullohet në mënyrë automatike deri në skadimin e periudhës prej 180 ditësh nga momenti i njoftimit të ministrive.
- Problemet më të mëdha të kopjeve të gjitha rasteve, kryesisht për shkak të burimeve të pamjaftueshme;
- Dërgimi i ftesës dhe kontaktimi i palëve (shpesh të zhvendosura) në Serbi;
- Problemet e veçanta në Rajonin e Mitrovicës për sa i përket kushteve të përgjithshme të punës sidomos në gjykatën e qarkut e cila refuzon të pranojë ankesa për shkak të situatës

së tyre specifike; dhe

- Reagimi i mundshëm nga parashtruesit e ankesave dhe nga opinioni publik, në rast se lëndët e tyre pezullohen ose refuzohen të shumtën e rasteve.

Për të tejkaluar vështirësitë e shumta me të cilat ballafaqohet gjyqësori i Kosovës, dhe që ndërlidhen me këto raste, gjykatësit e EULEX-it e kanë përgatitur një strategji monitorimi, mentorimi dhe këshillimi për gjyqësorin e Kosovës për secilin hap të procesit në pajtueshmëri me sa vijon:

- ✓ Në fazën gjyqësore, gjykatësit e EULEX-it monitorojnë, mentorojnë dhe këshillojnë gjykatësit e Kosovës në tejkalimin e vështirësive siç janë: përcaktimi i adresave, verifikimi i ankesave në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm, inicimin e përfundimit të rasteve të hapura, fillimin e gjyqësorit të rasteve të cilat e kanë kaluar procedurën fillestare, kategorizimin e ankesave dhe dërgimin e njoftimeve në MD dhe në MEF, dhe dërgimin e urdhërave për korigjimin e ankesave;
- ✓ Në fazën kryesore të gjyqësorit, gjykatësit e EULEX-it monitorojnë, mentorojnë dhe këshillojnë gjykatësit e Kosovës mbi mundësitë e përsheptimit të përfundimit të rasteve, për shembull, përmes seancave të përbashkëta dëgjimore;
- ✓ Në fazën e pas gjyqësorit, gjykatësit e EULEX-it monitorojnë, mentorojnë dhe këshillojnë gjykatësit e Kosovës duke i shpërndarë vendimet e nxjerra mbi rastet e pazgjidhura në gjykata komunale, ato të qarkut dhe Gjykatën Supreme në të gjitha nivelet.

Për t'i motivuar gjykatat që ta intensifikojnë punën e tyre në këto lëndë, janë mbajtur takime me gjykatës me ç'rast është prezantuar strategjia e gjykatësve të EULEX-it. Për më shumë një listë për verifikim mujor i është shpërndarë të gjithë gjykatësve të caktuar për lëndët e mbetura, dhe përmes kësaj gjykatësit e EULEX-it kishin mundësinë t'i përcjellin zhvillimet në punë në akëcilën gjykatë.

Gjykatësit e EULEX-it komunikojnë me MD-në, MEF-in dhe KGJK-në, në mënyrë që të thjeshtëzohen procedurat e njoftimit të ministrive dhe që të tejkalohen pengesat në gjetjen e adresave të parashtruesve të ankesave që jetojnë jashtë Kosovës.

Puna në këto lëndë ka zënë fill në mbarë Kosovën. Në shumë gjykata rastet nuk u janë shpërndarë gjykatësve dhe ndaj dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim, meqë ekzistonte një hamendësim se UNMIK-u apo edhe organizatat tjera ndërkombëtare do të merreshin me to. Pas veprimeve të gjykatësve të EULEX-it, të përshkruara më sipër, lëndët tashmë u janë shpërndarë gjykatësve nëpër gjykata dhe hapat procedurale janë ndërmarrë në të gjitha gjykatat në mbarë Kosovën. Në disa gjykata rastet janë përmbyllur në shkallën e parë. Progresi në rastet është ndjekur nga afër në të gjitha regjionet.


Gjykatat e Kosovës kanë ndërmarrë veprime për të koordinuar punën e tyre. Në disa raste janë mbajtur takime ndërmjet gjykatave të ndryshme, që u ka mundësuar gjykatësve këmbimin e përvojave ndërmjet veti për sa i përket lëndëve të caktuara. Gjykatësit gjithashtu kanë komunikuar edhe me MD-në.

Zbrazëtira ndërmjet "lëndëve të mbetura" të proceduara dhe të pa proceduara në rajone është përmirësuar dukshëm, dhe ky është një zhvillim pozitiv dhe i rëndësishëm. Progresi i kësaj pune nëpër gjykata do të ndiqet në vazhdimësi në mbarë Kosovën. Me procedimin e rasteve në fazën tjetër të procedurës, EULEX-i do t'u ndihmojë gjykatësve të Kosovës që të merren edhe me raste të reja që mund të paraqiten. Atëherë kur rastet janë përmbyllur në gjykatën e shkallës së parë dhe janë ankimuar në instancën e dytë, personeli i EULEX-it monitoron zhvillimet në gjykatat e shkallës së dytë, në mënyrë që të jenë në gjendje të distribuojnë rastet të cilat mund të paraqesin një jurisprudencë të caktuar.

Lidhur me këtë, përfundimet që mund të dalin nga këto procedura dallojnë nga një gjykatës tek tjetri: disa gjykatës i kanë refuzuar këto ankesa si të papranueshme, duke i konsideruar UNMIK-un dhe KFOR-in imun nga paditë civile para gjykatave të Kosovës. Ata gjithashtu konsiderojnë se institucionet e Kosovës nuk janë përgjegjëse për ngjarjet e vitit 1999. Disa gjykatës i kanë pezulluar lëndët, për shkak se ankuesi ka vdekur, apo edhe për faktin se adresa e ankuesit ishte e panjohur. Disa gjykatës të tjerë kanë vendosur se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë dhe janë duke e aplikuar këtë vendim në rastet e ngjashme. Janë bërë ca përpjekje për të aranzhuar një seminar në tërë Kosovën lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me rastet e mbetura në mënyrë që, gjykatësit, të mësojnë dhe të këmbëjnë përvojat me njëri-tjetrin.

PROKURORËT PUBLIK

Në mënyrë që të riparohen dobësitë në realizimin e detyrave në prokuroritë publike (PP), është përpiluar një veprim MMK për të siguruar progresin e gjyqësisë kosovare *drejt një gjyqësie transparente, të pavarur dhe të besueshme; si dhe duke siguruar që krimet serioze hetohen në mënyrë të efektshme*. Kishte një përparim në përmbushjen e 4 qëllimeve të këtij veprimi MMK (2 veprime akoma nuk kanë arritur fazën e implementimit), përkundër problemeve që kanë të bëjnë me resurset e PP-së.



Menaxhimi i punës në lëndët e prokurorisë. Shumë nga dobësitë e identifikuara të prokurorisë kanë të bëjnë me proceset e menaxhimit të lëndëve. Prandaj, një Doracak për Administrimin e Prokurorisë (MAP) është përpiluar nga ana e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID)/Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore në partneritet me EULEX-in, ka filluar punën maj të vitit 2010. MAP-i është integruar në zyrat e ndryshme të prokurorisë dhe pritet që të ketë ndikim pozitiv në punët ditore. MAP-i ofron udhëzime të qarta mbi procesin e punës së prokurorisë dhe të menaxhimit të zyrës. Doracaku është kombinim i të gjitha politikave dhe procedurave të aplikueshme në një vend, të cilat gjenden në

tërësi të tillë për herë të parë. MAP duhet të dëshmojë se është një mjet jetik menaxherik për njëtrajtshmërinë e proceseve dhe të procedurave në të gjitha shërbimet e prokurorisë në Kosovë. Për më tepër, prokuroria është duke punuar në zbatimin e Sistemit Informativ të Menaxhimit të Prokurorisë (SIMP) paralelisht me Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML), që është në përdorim nga gjykatësit.

Emërimet. Emërimet dhe riemërimet e gjykatësve dhe të prokurorëve janë duke shënuar përparime dhe ato duhet të përmbyllen deri në fund të këtij viti.

Deri më tani janë emëruar, 8 gjykatës të Gjykatës Supreme, 4 prokurorë të shtetit, 10 prokurorë të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), 9 gjykatës të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe 5 prokurorë në Mitrovicë, Prokuroria Publike e Qarkut. Përfundimi i riemërimit së bashku me MAP-in, ligjet e reja mbi gjykatat, Ligji mbi Prokurorinë e Shtetit dhe Ligji mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës pritet të përbëjnë një bazë të mirë për menaxhimin e efektshëm të shërbimeve prokuroriale.

Marrëdhëniet ndërkombëtare. Në vitin 2009, zyra e kryeprokurorit të EULEX-it, me ndihmën e bashkëpunëtorëve vendas ka përfunduar përgatitjet dhe aspektet logjistike për nënshkrimin e disa marrëveshjeve të cilat përfshijnë:

- ✓ Memorandumin e Mirëkuptimit (MiM) ndërmjet Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe të Kryeprokurorit Shtetëror të Malit të Zi
- ✓ MiM mes të Prokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Drejtorisë Kombëtar Antimafia të Italisë
- ✓ MiM ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Prokurorit Publik të Republikës së Kroacisë për luftimin e krimeve trans-nacionale dhe larjes së parave
- ✓ Marrëveshjet ndërmjet Kryeprokurorit të EULEX-it dhe Agjencisë Kundër-korrupsion të Kosovës lidhur me bashkëpunimin ndërmjet prokurorëve të EULEX-it dhe Agjencisë Kundër-korrupsion të Kosovës

Puna e Ekipeve të Përbashkëta dhe MMK-së. Janë miratuar edhe gjashtë marrëveshje për zbatimin e rezultateve ndërmjet prokurorisë së BE-së dhe institucioneve vendase:

- Masat për të siguruar autonominë e prokurorëve të Kosovës;
- Integrimi i CMIS-së në punët ditore;
- Caktimi objektiv dhe transparent i lëndëve;
- Masat për të hetuar dhe proceduar krimet serioze;
- Masat për të hetuar dhe proceduar lëndët penale; dhe
- Masat për të fuqizuar besueshmërinë e gjyqësorit kosovar.

Disa rezultate janë në pritje të themelimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) – këto përfshijnë masat për të siguruar autonominë e prokurorëve të Kosovës, masat për të fuqizuar besueshmërinë e gjyqësisë së Kosovës dhe transparencën e sistemit të caktimit të lëndëve.

Nga dhjetori i vitit 2008, janë realizuar 436 lëndë nga Ekipet e Përbashkëta (EP), me ç'rast personeli i EULEX-it ka punuar bashkë me prokurorët e Kosovës në lëndët të përzgjidhura. Kjo ka nënkuptuar se një numër i teknikave prokuroriale si dhe standardeve janë bartur tek prokurorët vendas. Krahas kësaj prokurorët e EULEX-it i kanë monitoruar lëndët pa pasur nevojë për përfshirje më të thellë siç është rasti me ekipet e MT – gjë që lejon identifikimin e dobësive si dhe mbështetjen domethënëse bashkë me monitorimin për zbatimin e rasteve në mënyrë sa më të efektshme në të njëjtën kohë.

Procedura e testimit të dëshmime është miratuar në mbarë Kosovën. Testi vlerëson nëse ka mjaft të dhëna në secilën lëndë për të ofruar një perspektivë realiste për dënim. Kjo procedurë siguron realizueshmëri dhe relevancë të dëshmime të përdorura në lëndët penale dhe e zvogëlon kohën për procedimin e tyre, si dhe sjellë standarde të larta në drejtësinë për viktimë, dëshmitarë dhe të akuzuar, si dhe do të duhet të kontribuojë (për një kohë më të gjatë) në arritjen e besueshmërisë së komunitetit në shërbimet e prokurorisë.

Një tjetër çështje, e identifikuar, në raportin e programit, ishte edhe zbatimi i tepërt i paraburgimit në pritje të gjykimit, dhe në shumë raste nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit. Prokurori ka kërkuar paraburgimin në pritje të gjykimit në pak raste dhe, në vend të kësaj ka propozuar masa më pak të dhunshme si: arresti shtëpiak, deponimi i pasaportës, etj.

Për më shumë, reduktim i rasteve të mbetura të prokurorisë është venë re në shumë prokurori të qarkut.

Sfidat. Verifikimi dhe riemërimi i prokurorëve duhet të përfundojë para se të arrihet stabiliteti nëpër prokuroritë e Kosovës. E ardhmja e disa prokurorëve është e paqartë, dhe kjo nuk ishte e favorshme për reformat, të cilat ndërmerr organizata.

Prezantimi i ligjeve të reja – Ligji mbi Gjykatat, Ligji mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji mbi Prokurorinë e Shtetit – janë mirëpritur ngase do t'i prezantojnë masat për t'i adresuar edhe çështjet madhore.

Ligji mbi Gjykatat i cili e ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Kosovës, mëton të adresojë mosefikasitetin e shërbimit gjyqësor, duke krijuar një strukturë të re, e cila do t'i bashkojë gjykatat e qarkut dhe ato komunale.

Ligji mbi Prokurorinë e Shtetit akoma në formë të projekt-ligjit, mëton të harmonizojë strukturat e shërbimit prokurorial. Struktura e re parasheh 7 prokurori, përfshirë këtu edhe qarqet e reja të Gjakovës dhe Ferizajt, duke bashkuar prokurorinë komunale dhe atë të qarkut. Kjo strukturë e re pritet që të sjellë një sinergji të re ndërmjet prokurorive - të cilat, për momentin operojnë në dy nivele – dhe do të duhej që ta ngrit bashkëpunimin edhe me Policinë e Kosovës.

Ligji mbi Prokurorinë e Shtetit do të sjellë edhe një ndryshim madhor – prezantimin e vetëm një njësie për ankim të vendosur në Prokurorinë e Shtetit. Kjo do ta rrisë efikasitetin dhe njëtrajtshmërinë në kuadër të prokurorive duke e centralizuar procesin e ankimit. Besohet se ky ligj i ri do të kontribuojë, gjithashtu në zvogëlimin e numrit të ankesave dhe në dyfishimin e procesit.

Një çështje e debatuar shumë është edhe ngritja e pagave të prokurorëve (dhe gjykatësve); ligjet e reja parashohin një ngritje substanciale në paga. Ky është një element esencial në fuqizimin e autonomisë së prokurorëve dhe besojmë që do të sigurojë që prokuroria kosovare do ta mbajë stafin e tanishëm si dhe të tërheqë kuadro të reja të kualifikuara.

Ligji mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës është gjithashtu në përgatitje e sipër. Ligji do të sjellë të reja mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili – si KGJK-ja – do të jep mbështetjen e nevojshme dhe mbikëqyrjen e prokurorisë kosovare. Sekretariati për mbështetjen e KPK-së do të vendoset në Prokurorinë e Shtetit të Kosovës.

Ndryshimet strukturale në organizmin e shërbimeve prokuroriale me prezantimin e MAP-it dhe duke i përfshirë ato që burojnë drejtpërdrejt nga tri ligjet e lartpërmendura do të përfshihen në të gjitha

nivelet.

Niveli i personelit mbetet një çështje madhore për vite të tëra në të gjitha nivelet për shkak të siç është raportuar numrit të paplotësuar të vendeve të lira të punës. Ka nevojë urgjente për prokurorë, për zyrtarë ligjor, për administrator, menaxher dhe, në veçanti, për staf të teknologjisë informative për të siguruar mbarëvajtjen e procedimit të rasteve.

PROKURORIA SPECIALE E KOSOVËS (PSRK)

Sipas ligjit mbi prokurorinë speciale (neni 1.1), Prokuroria Speciale (në vazhdim PSRK) është themeluar si prokurori e përhershme dhe e specializuar dhe që vepron në kuadër të zyrës së Prokurorit të Shtetit.

PSRK-ja ka kompetenca ekskluzive në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve më të rënda siç janë krimet e luftës, shkeljet e rënda të Konventës së Gjenevës, terrorizmi, krimi i organizuar, trafikimi me qenie njerëzore si dhe pastrimi i parave.

Përveç kësaj, PSRK-ja ka një kompetencë shtesë që të hetojë dhe ndjek penalisht disa krime të caktuara nëse:

- krimi është pjesë e një aktiviteti më të gjerë kriminal ndërkombëtar gjë që e bën të domosdoshëm bashkëpunimin ndërkombëtar

ose

- kur krimi është pjesë e përpjekjeve të paligjshme për të ndikuar hetimet apo ndjekjen penale të krimeve në fjalë;

ose

- kur krimi rrezikon apo ka rrezikuar më parë funksionimin ose stabilitetin e institucioneve publike apo të organeve të tyre që veprojnë në Kosovë

ose

- në rastet kur ka arsye të besueshme se PSRK-ja, si rrjedhojë e rrethanave të veçanta apo ndërlikimit, apo natyrës së sjelljes së pretenduar kriminale, është zyra e vetme e cila mund të kryej një hetim të plotë apo ndjekje penale të krimit.

Me 9 dhjetor 2009 PSRK-ja ka shënuar përvjetorin e saj të parë. Sa i përket personelit të PSRK-së dhe strukturës organizative, personeli i PSRK-së dhe ai i EULEX-it është nën administrimin e rregulloreve të Kosovës dhe EULEX-it, mirëpo udhëhiqet nga kryesuesi i PSK-së i cili momentalisht është një prokuror i EULEX-it. Kryeprokurori i EULEX-it mbikëqyr udhëheqësin e PSRK-së gjatë periudhës kalimtare. Ndarja e buxhetit të përgjithshëm për kategoritë e ndryshme të stafit në Prokurorinë Speciale të Kosovës bëhet nga Ministria e Drejtësisë. Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë janë në një nivel shumë kënaqshëm.

Fillimisht aktivitetet e EULEX-it në PSRK janë të përqendruara në kryerjen e detyrave ekzekutive që ndërlidhen me kompetencat ekskluzive dhe ato shtesë. Megjithatë, me qëllim të ndërtimit të një institucioni të qëndrueshëm, dalëngadalë kanë filluar edhe aktivitetet e MMK-së. Momentalisht periudha e vlerësimit është në vijim e sipër, dhe do të finalizohet më vonë gjatë vitit 2010. Kjo do të nxis një numër aktivitetesh të synuara të MMK-së, të cilat janë planifikuar të nisin në fillim të vitit 2011.

Arritjet e PSRK-së. Periudha e raportimit për PSRK-në ishte shënuar me gjykime, posaçërisht me një gjykim të profilit të lartë për krime luftë, si dhe hapave kyç në hetimin e krimit të organizuar dhe rasteve të krimit financiar. Që nga korriku i vitit të kaluar PSRK-ja ka shqyrtuar 165 raste. Një pjesë të madhe të portofolit të PSRK-së e përbejnë rastet e trashëguara nga UNMIK-u; megjithatë, numri i rasteve të reja të PSRK-së është rritur për një të tretën e numrit të përgjithshëm të rasteve, gjë që është shenjë inkurajuese.

Deri në shkurt të vitit 2010 PSRK-ja punonte me gjashtë prokuror special të Kosovës dhe një mestare prej gjashtë prokurorësh special të EULEX-it. Ky numër ndryshonte nga muaji në muaj si rezultat i emërimeve të reja dhe dorëheqjeve. Prokurorët special të EULEX-it kanë kryer funksionet e tyre ekzekutive duke punuar në ekipe të përziera me homologët Kosovar dhe në përputhshmëri me ligjet që janë në fuqi në Kosovë dhe mandatin e EULEX-it.

Gjatë fazës së trajnimit, kushtet e marrëveshjes së nënshkruar nga Kryeprokurori Shtetëror i Kosovës, Kryeprokurori i EULEX-it dhe udhëheqësit e PSRK-së ishin zbatuar në tërësi. Gjatë trajnimit prokurorët special të Kosovës shfaqën zotësinë dhe vullnetin e tyre për të demonstruar shkathtësi pozitive në kryerjen e funksioneve të përditshme. Ata kanë treguar një nivel të mirë të udhëheqjes në hetimin e rasteve të caktuara.

Me 16 shkurt 2010, u emëruan dhjetë (10) prokurorë për të shërbyer si prokuror special të PSRK-së. Me këto emërimet përbërja e PSRK-së ishte në përputhshmëri të plotë me nenin 3 të ligjit mbi PSRK-në ku parashihet që PSRK të ketë në përbërje 10 prokuror kosovar. Nga dhjetë prokurorët, njëri do të emërohet si zëvendës udhëheqës i PSRK-së.

Prokurorët special të Kosovës kanë mirëpritur praninë e prokurorëve special të EULEX-it që do të shërbejnë si pjesë përbërëse e ekipit. Vendndodhja e tyre e përbashkët me prokurorët e EULEX-it në ndërtesë të njëjtë me homologët e tyre ka krijuar një komunikim dhe punë të shkëlqyer ekipore. Prokurorët special të Kosovës janë familjarizuar me homologët e tyre. Homologët Kosovar kanë pikëpamje të qartë lidhur me rolin dhe mandatin e EULEX-it.

Shkëmbimi i informatave me prokurorët special të Kosovës është i mjaftueshëm për t'iu mundësuar prokurorëve special të EULEX-it që të njihen me zhvillimet aktuale. Udhëheqësi i PSRK-së organizon takime të rregullta të menaxhmentit me prokurorët special të Kosovës: gjatë takimeve javore diskutohen çështjet organizative dhe ato ligjore, në mënyrë që ta ndihmojnë aktivitetin e PSK-së dhe t'i tejkalojnë vështirësitë.

Zhvillimi i bazës së të dhënave dhe sistemit të sigurisë është kompletuar. Sistemi informativ për menaxhimin e gjykatave SIMGJ i PSRK-së do të funksionalizohet menjëherë posa të plotësohet pozita e administratorit të bazës së të dhënave. Caktimi i rasteve dhe fillimi i hetimeve mund të konsiderohet si një arritje domethënëse për këtë zyrë. Prokurorët special kanë qenë të kyçur në raste të krimeve të rënda/organizuara dhe hetimeve financiare si dhe kanë përfaqësuar PSRK-në nëpër gjykime. Që nga 30 prilli 2010, prokurorëve special të Kosovës u janë caktuar pesëdhjetë e dy (52) raste.

Bashkërendimi i PSRK-së me policinë e EULEX-it dhe atë të Kosovës është qartësuar hap pas hapi, dukë tejkalar kështu vështirësitë e shumta. Puna në marrëdhëniet me jashtë ka hapur rrugën drejtë forcimit të bashkëpunimit me prokuroritë e huaja. Me 26 shkurt 2010 PSRK-ja miratoi vendimin për themelimin e departamentit special për anti-korrupsion i njohur po ashtu edhe si Task Forca anti-korrupsion.

Kjo Task Forcë do të ishte nën mbikëqyrjen e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK).

Duhet cekur së gjatë procesit të themelimit të kësaj Task Force, EULEX-i ka bashkëpunuar ngushtë

me Qeverinë për ta bërë këtë organ të ri funksional dhe efektiv sa më parë që është e mundur. Objektivi i Task Forcës është hetimi dhe luftimi i krimit të nivelit të lartë që ka të bëjë korrupsionin si dhe format e ndryshme të pjesëmarrjes në krime të tilla, të dënuara sipas nenit 9 të ligjit mbi Ndjekjen Penale. Sipas nenit 10.1 të ligjit të lartcekur, PSRK-ja do t'i ushtrojë kompetencat e saja shtesë atëherë kur është në interes të mbarëvajtjes së hetimeve apo ndjekjes penale të krimeve.

Task Forca anti-korrupsion e PSRK-së do të funksionojë në pajtim me nenet 1.1, 4.2 dhe 15.6 të igjit mbi PSRK-në dhe nenit 8 të ligjit mbi Prokurorinë Publike. Task Forca, si e tillë, do të përbehet nga tetë prokurorë, pesë (5) nga të cilët do të jenë vendor ndërsa tre (3) prokurorë të tjerë do të emërohen nga EULEX-i. Momentalisht PSRK-ja është në proces të rekrutimit të prokurorit të fundit për këtë seksion. Përveç këtyre tetë prokurorëve të Task Forcës, Qeveria e Kosovës është zotuar të angazhojë tridhjetë (30) policë të Kosovës nga hetuesia, të cilët do të shërbejnë si mbështetje për Task Forcën.

Që nga 20 prilli 2010, pesë policë të PK-së janë caktuar në Task Forcën anti-korrupsion të PSRK-së. PK-ja do të definojë procedurën e cila do të zbatohet me rastin e emërimit të 25 policëve të tjerë, ashtu siç është parashikuar me planin e burimeve.

Sfidat. Prokurorët special të EULEX-it kanë vërejtur nevojën e prokurorëve special të Kosovës për zhvillim të mëtejshëm të shkathtësive tyre për sa i përket hartimit ligjor. Posaçërisht kërkohet më shumë cilësi në përshkrimin e arsytimit dhe fakteve, siç janë paditë. Përveç kësaj, ekziston nevoja për të inkurajuar mbajtjen e trajnimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e shkathtësive menaxhuese në mesin e prokurorëve. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga ana e udhëheqësit të PSRK-së, deri në këtë pikë ata (prokurorët) ende nuk kanë mundur që në mënyrë të suksesshme t'ua delegojnë detyrat zyrtare të tyre ligjor dhe asistentëve administrativ. Duhet ngritur aftësia për të mbikëqyrë hetuesit policor.


Ekziston nevoja për trajnime të prokurorëve special të Kosovës për sa i përket përdorimit të teknologjisë informative (TI) dhe pajisjeve elektronike për komunikim. Edhe pse udhëheqësi i PSRK-së ka organizuar sesione të brendshme për trajnime individuale të TI-së për Prokurorët special të Kosovës, ende ka vend për përmirësime. Siguria e ndërtesës së PSRK-së është një nga sfidat që brengos këtë zyrë. Prandaj, projekti kapital i PSRK-së i titulluar "*Siguria e ndërtesës së PSRK-së*" është miratuar nga Ministria e Drejtësisë dhe pritet që të rris nivelin e sigurisë në këtë zyrë. Ky projekt pritet të jetë funksional me të mbaruar procedurat tenderuese.

Sistemi i infrastrukturës së TI-së ka nevojë për analizim dhe vlerësim të mëtejshëm të gjendjes dhe përdorimit të tij të tanishëm, identifikimin e pajisjeve ekzistuese të TI-së dhe nevojave infrastrukturale, si dhe identifikimin e nevojave për programe kompjuterike dhe nevojës për integrim të bazës së të dhënave. Mungesa e një zyrtari për TI në PSRK ka qenë pengesa kryesore për një prezantim dhe vlerësim të duhur të zyrës në çështjet që ndërlidhen me TI-në. Posti i administratorit të bazës së të dhënave duhet plotësuar në mënyrë që të mundësojë zbatimin e bazave të dhënave për të dhëna në PSRK.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Puna gjatë aktiviteteve të MMK të EULEX-it në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (MD) është e përqendruar drejtë objektivave të dyfishtë të politikës ligjore dhe hartimit të legjislacionit, me qëllim të përforcimit të aftësive për formulimin e politikave ligjore nga Ministria po ashtu, edhe ngritjen e kapaciteteve për hartimin e ligjeve. Ekspertet e EULEX-it po ashtu janë të interesuar ta rrisin bashkëpunimin ligjor në nivel ndërkombëtar. Kjo përfshin përforcimin e kapaciteteve për sa i përket

ndihmës juridike ndërkombëtare për Ministrinë e Drejtësisë, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në aspektin ligjor, duke përmirësuar kështu ato procedura (përfshirë këtu legjislationin primar dhe atë sekondar të Ministrisë së Drejtësisë) të cilat do ta ndihmojnë zhvillimin e drejtësisë në Kosovë si një partner plotësisht i besueshëm në rrjetin ndërkombëtar të bashkëpunim ligjor. Ekspertët e EULEX-it po ashtu duke ofruar mentorim dhe këshillim për mënyrat që do ti mundësojnë Ministrit të Drejtësisë ta përforcojë pajtueshmërinë e përgjithshme me instrumentet ligjore që janë fuqi në Kosovë. Për fund, EULEX-i është duke ndihmuar Zyrën për persona të pagjetur dhe mjekësi ligjore (OMPF) drejtë arritjes së qëllimit të saj për të zhvilluar një strategji efektive dhe efikase për departamentin e mjekësisë ligjore (DML), në ofrimin e shërbimeve profesionale të mjekësisë ligjore ndaj gjyqësorit dhe stafit të tij.



Një çështje kryesore në MD ka qenë mungesa e transparencës gjatë zbatimit të procedurave të aplikimit për rekrutim, gradim dhe punësim. Një numër i rekrutimeve janë centralizuar në nivel të lartë Ministrisë, pa u konsultuar fare me menaxherët që udhëheqin punën e përditshme.

Në fillim të muajit prill është emëruar Ministri i ri i Drejtësisë, kështu që EULEX-i është duke konsoliduar një marrëdhënie pune të re. Ministri i ri duket të këtë vullnet të kyçet në mënyrë konstruktive me EULEX-in dhe që tani ka nxjerrë disa vendime që kanë për synim zvogëlimin e rasteve të nepotizmit.

Politika ligjore & Strategjia legislative. Ekspertët EULEX-it për politika ligjore dhe legjislation morën pjesë në procesin hartimit të legjislationit, vlerësimin të draft ligjeve dhe komentimit të tyre. Ekspertët e EULEX-it për politika ligjore dhe legjislation kanë qenë të kyçur në mënyrë efektive në shumicën prej grupeve punuese ndërqeveritare të cilët kanë shqyrtuar draft legjislationin (në kuadër të strategjisë legislative të MD-së).

Gjatë periudhës raportuese ekspertët e EULEX-it për politika ligjore dhe legjislation kanë qenë të kyçur në mënyrë efektive në aktivitetet e monitorimit dhe mentorimit (si me pjesëmarrje në grupe punuese apo në mënyra të tjera) gjatë hartimit të draft ligjeve në vijim:

- ✓ Ligji mbi departamentin e mjekësisë ligjore – i cili është miratuar nga Kuvendi dhe ka hyrë

- në fuqi;
- ✓ Ligji mbi mjekësinë ligjore – i cili është miratuar gjatë shqyrtimit të parë në Kuvend;
- ✓ Ligji kundër korrupsionit – i cili është miratuar nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi;
- ✓ Kodi i drejtësisë për të mitur – i cili është miratuar gjatë shqyrtimit të parë në Kuvend;
- ✓ Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale – i cili është miratuar gjatë shqyrtimit të parë në Kuvend;
- ✓ Ligji mbi agjencionin për konfiskim dhe sekuestrim të pasurive – i cili është miratuar dhe ka hyrë në fuqi;
- ✓ Ligji mbi gjykatat – i cili u miratua në shqyrtimin e parë në Kuvend;
- ✓ Ligji mbi këshillin gjyqësor të Kosovës;
- ✓ Ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve – i cili është dërguar nga MD-ja për miratim në Qeveri;
- ✓ Ligji mbi obligimet (kontratat, ligji mbi detyrimet);
- ✓ Kodi i procedurës penale;
- ✓ Kodi penal;
- ✓ Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve;
- ✓ Ombudspersoni.

Ekspertet EULEX-it për politika ligjore dhe legjislacion kanë qenë të kyçur po ashtu edhe në dhënien e komenteve dhe rekomandimeve për draft ligjet në vijim që janë jashtë strategjisë legjislative të MD-së: Draft ligji kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, draft ligji mbi inspektoratin e policisë, draft ligji mbi gazetën zyrtare si dhe draft ligji mbi personat e pagjetur.

Sfidat. Sistemi i formulimit të politikave ligjore dhe hartimit të legjislacionit në kuadër të MD-së mbetet i ende i dobët. Çështje të ngjashme lindin vazhdimisht dhe është e qartë së ende ekzistojnë sfida themelore.

Është e nevojshme të këtë një kornizë ligjore për të zhvilluar politikat ligjore dhe legjislacionin. Ekziston një numër i rregulloreve dhe udhëzimeve administrative të Qeverisë (duke përfshirë edhe teknikat e konsultave me publikun dhe teknikat e hartimit) që kanë të bëjnë me atë së si duhet zhvilluar politikat ligjore dhe si duhet hartuar legjislacionin.

Shpesh këto rregullore apo udhëzime administrative nuk respektohen. Kjo ka një efekt të dyfishtë si në transparencën e procesit ashtu edhe në cilësinë e produktit final. Këto probleme do të jenë pikësypnim i monitorimit të mëtejshëm dhe do të adresohen gjatë muajve në vijim.

Legjislacioni i hartuar duhet të jetë në gjendje që të përdoret dhe të zbatohet. Në shumë shtete anëtare kjo detyrë merret përsipër nga një personel me kualifikime të lartë: Ministria e Drejtësisë ende ballafaqohet me sfida në rekrutimin dhe mbajtjen e stafit të kualifikuar.

Si versioni në gjuhën shqipe ashtu edhe ai në gjuhën serbe shërbejnë si bazë e legjislacionit të Kosovës. Megjithatë, ai është i përkthyer edhe në gjuhën angleze. Ekziston nevoja për metoda të reduktimit të çmimit dhe përmirësimit të cilësisë së përkthimit.

Kapaciteti i ndihmës juridike ndërkombëtare. Sipas udhëzimit të fundit administrativ ministror, të datës 30 shtator 2009, MD-ja mori përgjegjësitë për kërkesat prej dhe drejtë shteteve të jashtme, duke përfshirë edhe të ashtuquajturat “shtetet që nuk na njohin”. Si rezultat, kanali relevant për komunikim me Serbinë – që përbehet nga 30% i të gjitha kërkesave – është ndërprerë. Autoritetet serbe kanë refuzuar zbatimin e kërkesave që vijnë nga Kosova, ngase ato bartnin vulat apo simbolet e institucioneve të Kosovës. Kjo është një arsye për shqetësim serioz mu për shkak të numrit të madh të ndihmës juridike (NJN) me Serbinë: situata e tanishme në mënyrë efektive po e ndalon qasjen në drejtësi dhe po shpie drejtë mos ndëshkimit.

Divizioni për bashkëpunim juridik ndërkombëtar vazhdon të mos ketë njësinë e vet për përkthime dhe mundësinë e qasjes në ndonjë opsion tjetër alternativ. Kjo gjë është bërë faktor shqetësimi, meqë një numër shtetesh (siç janë: Austria, Gjermania dhe Zvicra) i kërkojnë Kosovës të respektojë standardet ndërkombëtare dhe kërkesat të dërgoj në njërin nga gjuhët zyrtare të atij shteti (p.sh. në Gjermanisht). Numri i stafit të këtij divizioni është i vogël gjë që e vë divizionin vazhdimisht në vështirësi për shkak të kapacitetit të tyre. Propozimi për shtim të numrit të stafit nuk është miratuar nga administrata e Ministrisë. Për më tepër, ka mungesë edhe të pajisjeve teknike të duhura për skanim ndërsa serveri për ruajtjen e të dhënave ka një hapësirë të vogël për të ruajtur dokumentet e skanuara. Një projekt i cili është në vijim ka për qëllim përmirësimin e situatës.

Korniza legislative mbi bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Ligjet dhe politikat ekzistuese janë rishikuar dhe modifikuar në pajtim me praktikën me të mira Evropiane, si pjesë e punës në vazhdim e sipër për zhvillimin e një legjislacioni të përmirësuar dhe mjeteve funksionale.

Strategjia legislative për vitin 2010 vë në pah katër ligje të ndryshme në fushën e NJN-së. Megjithatë, është vendosur që tri nga katër ligjet të shkrihen në një ligj të vetëm – Ligji gjithëpërfshirës mbi ndihmën juridike reciproke, duke përfshirë transferimin e personave të dënuar dhe ekstradimin. Ligji tjetër është ligji mbi rrëmbimin e fëmijëve. Grupet punuese ministrore kanë përgatitur draftet fillestare të cilat tani janë duke u rishikuar dhe konsoliduar nga grupet punuese ndër-ministrore. Qeveria e Kosovës ka për qëllim dërgimin e dy ligjeve në Kuvendin e Kosovës diku rreth fundit të korrikut 2010.

Marrëveshjet ndërkombëtare/ Kapacitetet juridike. Ekziston një fokusim i ritheksuar mbi kapacitetin juridik të Ministrisë për sa i përket konventave ndërkombëtare dhe *trupit ligjor* të BE-së, ngritjen mbi baza të marrëveshjeve ekzistuese apo të mundshme, si dhe vënien e një theksi të ri në praktikën me të mira Evropiane nëpërmjet mbështetjes aktive nga ana e aktiviteteve të MMK-së.

MD-ja ka propozuar 30 draft marrëveshje me shtete të ndryshme të BE-së apo të regjionit mbi transferimin e personave të dënuar. Një numër shtetesh kanë treguar interesim ose kanë filluar tashme negociatat me Kosovën mbi kushtet e hollësishme të marrëveshjes. Marrëveshjet e para për ndihmë juridike reciproke do të nënshkruhen së shpejti. Përveç kësaj, MD-ja momentalisht është duke negociuar me Shqipërinë, IRJM dhe Turqinë në arritjen e marrëveshjeve mbi ndihmën juridike reciproke, dhe ekstradimin në rastet që i përkasin çështjeve penale.

Ekstradimet. Një qëllim në vetvete ka qenë krijimi i një njësie Kosovare për përcjellje gjatë ekstradimeve. Deri me tani, në mungesë të njësisë për përcjellje në kuadër të MD-së, EULEX-i ka ndihmuar në përcjelljen e personave të ekstraduar në Kosovë. Krijimi i njësisë Kosovare për përcjellje gjatë ekstradimeve pothuajse është kompletuar. Pas kompletimit të procesit të përzgjedhjes së dhjetë policëve meshkuj dhe një femër, në prill të vitit 2010 Ambasada Francezë u ka dhënë atyre viza Shengen, duke u mundësuar kështu të udhëtojnë nëpër shtetet e zonës së Shengen-it në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Njësia korrektuese e EULEX-it momentalisht është duke i rishikuar nevojat për trajnime dhe angazhimet e saj në ekstradime, si dhe potencialin për mbajtjen e kurseve të specializuara. Pasi që të jenë trajnuar zyrtarët njësia për përcjellje do të bëhet funksionale.

Sfidat. Në përgjithësi puna e këtij divizioni është në rrugë të mbarë dhe po ashtu është arritur

një përparim domethënës, posaçërisht sa i përket hartimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bilaterale dhe përgatitjes së dy draft ligjeve në fushën e NJN-së. Megjithatë, divizioni ka nevojë për pajisje teknike me të mira dhe me shumë burime njerëzore si dhe ngritje të mëtejme të kapaciteteve. Më në fund, korniza e tanishme politike pengon funksionimin e divizionit në mënyrë të ndjeshme.

ZYRA PËR PERSONA TË ZHDUKUR DHE MJEKËSI LIGJORE (OMPF)

EULEX-i ka vendosur një numër të stafit të tij në OMPF, dhe në Raportin e fundit për programe, Rekomandimi JC/27/2009 vuri në pah këto qëllime:

- Hartimin e një plani strategjik i cili do të paraqes misionin dhe vizionin e OMPF-së;
- Krijimin e politikave të cilat luftojnë lëvizjen e stafit nga OMPF-ja; dhe
- Avancimin e shkathtësive udhëheqëse të stafit të lartë.

Plani strategjik që paraqet misionin dhe vizionin. Ka paqartësi rreth asaj së kush do të jetë në postin e drejtorit në departamentin e mjekësisë ligjore, dhe kjo çështje ka mbetur peng që disa muaj. Kjo gjë ka krijuar një situatë të atillë ku reformat e parapara të organizatës nuk janë çuar përpara. Homologët vendor, përderisa kanë mbështetur konceptin, kanë bërë shumë pak për sa i përket krijimit të një vizioni, misioni ose të ndonjë strategjie për OMPF-në apo departamentin e mjekësisë ligjore (DML). Megjithatë, sapo të jetë zgjedhur drejtori, do të punohet rreth këtij rekomandimi.

Politikat për të luftuar lëvizjen e madhe të stafit të lartë në OMPF. Se fundi, MD-ja ka aprovuar një rritje të pagave prej 30% për të gjithë stafin e punësuar në OMPF. Kjo rritje ende pret miratimin nga ana e Ministrisë së Administratës Publike. Nëse miratohet atëherë do të jetë rritja e parë e pagave për stafin e OMPF-së që nga krijimi i kësaj zyre. Duhet të mundësohen politika të atilla që të inkurajojnë ruajtjen e stafit dhe të mundësojnë një sistem karriere i cili bazohet më shumë në merita.

Shkathtësitë udhëheqëse / menaxhuese të stafit të lartë. Gjatë kësaj periudhës raportuese nuk ka dëshmi që tregojnë së MD-ja ka bërë diçka për të avancuar shkathtësitë menaxhuese të homologëve të lartë të EULEX-it.

Mbi themelimin dhe funksionalizimin e DML-së. Projekti i prezantimit të ligjit mbi themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore (DML) ishte shumë i rëndësishëm për të krijuar një kornizë ligjore që më parë nuk ekzistonte dhe nga e cila do të shërbente si bazë për funksionimin e mjekësisë ligjore dhe disiplinave që ndërliken më të. Ligji mbi themelimin e DML-së i paraqet qartë funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive, divizioneve dhe stafit të ndryshëm. Legjislati përkatës shtesë nuk është ndarë bashkë me homologët nga EULEX-i, edhe pse një gjë e tillë është kërkuar disa herë. Kështu që EULEX-i nuk ka ndonjë pasqyrë së çfarë

përmbajnë këto ligje shtesë.

Pronësia e ligjit mbi procedurat e mjekësisë ligjore – një shtesë kjo për ligjin e lartcekur – i cili ishte pranuar me entuziazëm nga mjekët vendor të cilët fillimisht e menduan si “ligji mbi autopsinë”. Ishte e nevojshme që të binden të gjitha palët përkatëse me interes lidhur me atë se sfera e ligjit duhej zgjeruar për të mbuluar të gjitha fushat e mjekësisë ligjore. Ekspertët ligjor dhe ata të mjekësisë ligjore në kuadër të EULEX-it kanë punuar nga afër me palët që kishin vullnetin për të rihartuar tërë dokumentin. Drafti rezultues në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si i përsosur, por ai shërben për të përvijuar kompetencat profesionale dhe përgjegjësitë e stafit të mjeko-ligjor, dhe (së bashku me ligjin mbi DML-së) mund të konsiderohet si një sukses domethënës, dhe po ashtu si hap domethënës drejtë profesionalizimit të mjekësisë ligjore të Kosovës.


OMPF-ja vuan nga udhëheqja e dobët. Ka shenja të ndërhyrjes politike në organizatë, në aspektin e marrjes së vendimeve dhe mungesës së një strukture të qartë komanduese. Për më tepër, në vitin e kaluar 60,000 € të buxhetit nuk janë realizuar. Ka mungesë të menaxhimit ditor të stafit nga ana e zyrës së ekzaminuesit mjekësor, duke rezultuar në shembuj të shumtë të mungesave pa arsye të stafit (posaçërisht mjekëve të rinj). Kjo praktikë e dëmton rendë mundësinë e EULEX-it për t’i monitoruar, mentoruar dhe këshilluar homologët.

MMK-ja ka qenë një proces i suksesshëm në laboratorin e toksikologjisë të mjekësisë ligjore ku është kryer i tërë procesi i bartjes së plotë të funksioneve tek stafi vendor i cili ishte paraparë të ndodh para përfundimit të qershorit 2010. Laboratori histopatologjik i mjekësisë ligjore u është bartur plotësisht stafit vendor, ndonëse ende ka nevoje për mbështetjen e EULEX-it. MMK-ja gjatë hartimit të ligjit mbi personat e pagjetur shënoi sukses për vitin 2009, deri kur koncepti i ligjit u tërhoq nga MD-ja dhe u dërgua në zyrën e Kryeministrit, ku ekspertet për mjekësi ligjore dhe persona të pagjetur të EULEX-it u përjashtuan përfundimisht nga ky proces.

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS (SHKK)

Qëllimi i përgjithshëm i këtij veprimi të MMK-së është arritja e një përparimi drejtë qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies në punën e SHKK-së, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi korrektues të sigurt dhe të pacenueshëm, duke u siguruar së SHKK-ja nuk do të ndikohet politikisht, dhe do të synoj arritjen e standardeve të pranura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane. Ekzistojnë 9 rezultate kyçe të cilat ekspertët e EULEX-it nga drejtësia duan t’i arrijnë. Këto rezultate kyçe përfshijnë mbikëqyrjen menaxhuese mbi Zyrën Qendrore të SHKK-së; menaxhimi i njësisë së sigurisë në kuadër të burgut të Dubravës; menaxhimi i pavijonit me rrezikshmëri të lartë të burgut të Dubravës; menaxhimi i njësisë për përcjelljen e të burgosurve në kuadër SHKK-së; krijimi i një qasjeje të sigurisë dinamike; krijimi i një “Komisioni për mbikëqyrjen e të burgosurve”; futja në përdorim e ri-integritimit në shoqëri; si dhe ndihma ndaj qendrës së paraburgimit në Mitrovicë.

Figura 1.9 - Progresi i Veprimit të MMK - Shërbimi Korrektues i Kosovës



Njësia korrektuese e EULEX-it. Është arritur marrëveshje me Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK) mbi planin e përbashkët për veprim në mënyrë që të arrihet një udhërrëfyes i përbashkët sa i përket bashkëpunimit në mes të SHKK-së dhe njësisë korrektuese (NJK) të EULEX-it. Ky plan paraqet të gjitha aktivitetet e nevojshme për të tejkaluar dobësitë e vlerësuara në SHKK.

Është rritur niveli i bashkëpunimit i cili ishte themeluar paraprakisht. Si rezultat i drejtpërdrejtë përgjatë vitit raportues komunikimi i përbashkët është përmirësuar, është rritur numri dhe frekuenca e takimeve të rregullta strategjike dhe të planifikimit si dhe janë krijuar grupe të ndryshme punuese të përbashkëta. SHKK-ja po tregon një qasje më proaktive në zhvillimin e shërbimit të tyre, duke marrë pjesë në të gjitha iniciativat e përbashkëta; me një besim në rritje për të dhënë ide dhe zgjidhje.

I një rëndësie të veçantë është inkurajimi në rritje dhe mbështetja që Zyra Qendrore (ZQ) i ka dhënë objektit më të madh, Dubravës, gjë që ka rezultuar në përmirësimin e disiplinës dhe krijimin e një qëndrimi më të mirë nga ana e stafit.

Administrimi i burgjeve. Një grup i përbashkët punues (SHKK/EULEX) është përqendruar në zhvillimin e dy fushave kryesore të administratës që kanë për qëllim avancimin e menaxhmentit të SHKK-së. Është dhënë këshillë e qartë sa i përket 1) zhvillimit të një sistemi për një bazë të dhënash në nivel kombëtar si dhe 2) decentralizimin e buxhetit dhe procedurave të prokurimit. Përfitimet shtesë nga vënia e fondeve nën kontrollin e drejtpërdrejtë të SHKK-së dhe ndërtesave të saj do të rrisin mundësinë e tyre që t'i përkushtohen më shumë planit afatgjatë.

Sa i përket fondit personal për të burgosurit, është nxjerrë një procedurë bashkërenduese që tani i mundëson SHKK-së të monitorojë dhe kontrollojë në mënyrë më efektive të gjitha transaksionet si dhe të jap balancë të saktë. SHKK-ja ka nxjerrë dymbëdhjetë udhëzime administrative dhe rregullore të përditësuara në fusha të ndryshme duke përfshirë, mes tjerash: Procedurat disiplinore, planifikimin e dënimeve, vizitave dhe trajtimin e të burgosurve në institucionet korrektuese. Pos kësaj, që nga qershori 2009 puna e panelit për lirim me kusht është monitoruar bashkërisht nga NJK-ja e EULEX-it

dhe gjykatësit e EULEX-it. Është shënuar përparim për sa i përket trajtimit të procedurave dhe përputhshmërisë me udhëzimet ekzistuese.

Menaxhimi i operimit dhe sigurisë. NJK-ja e EULEX-it është e bashkë vendosur në departamentin e sigurisë të burgut të Dubravës. Kjo NJK ka mbështetur SHKK-në në rishikimin e politikave dhe procedurave ekzistuese si dhe në kryerjen e vlerësimeve të ndryshme të sigurisë në kuadër të objektit. SHKK-ja ka bërë përparim dhe po bën përpjekje të përmirësojë rrjedhën e përgjithshme të informacioneve të sigurisë (mbajtja e një takimi javor të sigurisë për menaxhmentin e lartë konsiderohet të jetë praktikë e mirë).

Përpjekjet e përbashkëta kanë ndikuar në një kontrollë ditore më të kujdesshme të qelive; përmirësime në hyrjen kryesore të burgut dhe përmirësim të sigurisë fizike për pavijonin e ri (8) me rrezikshmëri të lartë; përmirësimi i dhomave të vizitave për të burgosur me rrezikshmëri të lartë në qendrën e vizitave (që kanë rezultuar në reduktimin e nivelit të frikësimit të stafit korrektues nga ana e burgosurve me rrezikshmëri të lartë).

Si pjesë e përpjekjeve për të reduktuar kontrabandën, EULEX-i i ka huazuar SHKK-së tri makina me rreze iks, 2 për Dubravë dhe 1 për Mitrovicë. SHKK-ja tani ka 4 zyrtarë "trajnuar të trajnerëve" po ashtu edhe stafi tjetër janë trajnuar për përdorimin e makinave. Kjo iniciative ka përmirësuar mjetet për zbulimin e aktiviteteve të kontrabandës. Ky përmirësim teknik është shoqëruar me themelimin e një grupi të përbashkët për të kompletuar rishikimin dhe përmirësuar procedurat në hyrjen për vizitorë.

Siguria strategjike. SHKK-ja në Dubravë ka rishikuar dhe ka përmirësuar planet për raste emergjente dhe ka kryer ushtrimin e parë në ambient të mbyllur me të gjitha agjencitë e sigurisë për të vlerësuar efikasitetin për të reaguuar në rast të ndonjë incidenti kritik. Ushtrimi i përbashkët në burgun e Dubravës i realizuar në mes të SHKK-së, Policisë së Kosovës (PK), Policisë speciale të EULEX-it, njësisë së EULEX-it për intervenim dhe njësisë K9 të EULEX-it ishte i suksesshëm. Janë identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim po ashtu NJK-ja e EULEX-it ka identifikuar 8 pjesëtar të stafit të lartë në SHKK që kanë nevojë për trajnime shtesë në komandim gjatë incidenteve të rënda.

Të burgosurit me rrezikshmëri të lartë. Në burgun e Dubravës është kryer rishikimi i përbashkët i të gjitha politikave dhe procedurave në lidhje me trajtimin e sigurte të të burgosurve më rrezikshmëri të lartë në pavijonin 1. Ky rishikim bëri që SHKK-ja të marrë vendim për hapjen e një pavijoni të ri për të burgosurit me rrezikshmëri të lartë në burgun e Dubravës, domethënë në pavijonin nr. 8. Një vendim i tillë është marrë për arsye që të mundësohet një trajtim modern dhe i sigurtë i të burgosurve me rrezikshmëri të lartë, dhe me qëllim që të reduktohet kontrabanda dhe varësia ndaj burgut. Të burgosurit janë lëvizur në pavijonin e ri me qëllim të zbatimit të rregullave dhe procedurave formale të cilat sigurojnë që të burgosurve do t'iu merren gjësendet e ndaluara.

Zyrtarët e SHKK-së kanë arritur të bëjnë përmirësime të mëdha në kushte mjaftë të vështira dhe burime të kufizuara. Duhet cekur se burgu i Dubravës nuk është i dizajnuar apo i përshtatshëm për strehimin e të burgosurve më rrezikshmëri të lartë. SHKK-ja së bashku me EULEX-in kanë këshilluar komisionin e BE-së në planet e tyre përfundimtare në krijimin e një burgu të ri për të burgosurit me rrezikshmëri të lartë në Kosovë.

Përcjellja e të burgosurve dhe Siguria e gjykatave. Grupi i SHKK-

së për përcjelljen e të burgosurve (GPB) ka tejkaluar mjaftë sfida (kryesisht burimet e kufizuara) gjatë ngritjes së një shërbimi profesional për përcjelljen e të burgosurve. GPB-ja ka paraqitur një procedurë efektive të vlerësimit të rrezikshmërisë së të burgosurve para çdo përcjelljeje. Kjo gjë ka reduktuar çmimin operativ ku tani përcjelljet mund të ndahen në përcjellje me rrezikshmëri të lartë dhe në ato me rrezikshmëri të ulët gjë që ka kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e sigurisë dhe jo-rrezikshmërisë. GPB-ja e SHKK-së mund të raportojë se gjatë kësaj periudhë raportuese nuk ka ndodhur asnjë arratisje. GPB-ja e SHKK-së e ka përmirësuar në mënyrë të ndjeshme komunikimin në të gjitha nivelet dhe ka një partneritet të ngushtë me GPB-në e EULEX-it.

Një tregues i mirë i qëndrueshmërisë është shkalla e transportimeve ekzekutive të kryera nga EULEX. Transporti ekzekutiv nga GPB-ja e EULEX-it është reduktuar për 25%, që kur menaxhmenti i GPB-së i SHKK-së është bërë më efikas në përmirësimin e shkathtësive të tyre planifikuese dhe koordinuese.

Qendra e paraburgimit në Mitrovicë/Ekipi regjional i

EULEX-it. NJK-ja e ekipit regjional të EULEX-it është vendosur në Mitrovicë dhe momentalisht është bashkëvendosur në qendrën e paraburgimit. Që nga vendosja e NJK-së së EULEX-it atje ka pasur një rritje të mbështetjes nga ana e ZQ-ja e SHKK-së. Këtë vit burgu është vizituar nga Ministri i drejtësisë, dhe po ashtu ka qenë nikoqir i disa vizitave të komisionarit dhe zëvendës komisionarit të SHKK-së, duke përfshirë edhe pjesëtarë tjerë të stafit lartë të SHKK-së.

Përmirësimet e përgjithshme të sigurisë kanë përfshirë rishikimin e plotë të planeve për rastet emergjente, kompletimin e vlerësimeve mbi nevojat e sigurisë, vendosjen e një makine me rreze iks; përmirësimet në mbledhjen e informacionit të zbulimit, dhe po ashtu falë paraqitjes së raporteve informative të sigurisë, ato edhe u regjistruan.

Struktura organizative dhe burimet njerëzore.

SHKK-ja nuk duket të ketë ndonjë strategji të menjëhershme apo afatgjate për burimet njerëzore. SHKK-ja ka vlerësuar se duhet bërë përmirësime. Është me rendësi thelbësore të bëhet një analizë e plotë e të gjitha nevojave të stafit, në mënyrë që t'i adresojmë dobësitë e tanishme në strukturën organizative. Struktura e hollësishme organizative në nivelin e ZQ-së; struktura e përgjithshme e gradave; mungesa e ekspertëve në fusha të veçanta të shërbimit korrektues dhe nevoja për planifikim të zgjerimit të SHKK-së (me futjen në shfrytëzim të ndërtesave të tjera), të gjitha këto janë çështje që kanë nevojë për shqyrtim të vëmendshëm.

Siguria. Fushat e sigurisë fizike dhe "dinamike" mbesin sfidat me të vështira të këtij shërbimi, e që përfshijnë të gjitha aspektet e ngritjes së kapaciteteve. Përmirësimi i sigurisë së objekteve dhe sigurimi i pajisjeve moderne të sigurisë janë po ashtu pjesë e kësaj ideje. Nevojitet përkrahje dhe përmirësim i vazhdueshëm sa i përket ndërtimit të marrëdhënieve konstruktive mes stafit dhe të burgosurve. Zyrtarëve, nganjëherë në mungese të mbështetjes nga menaxhmenti u duhet të përballen me frikësime. Kjo mund të shpie drejtë një gjendje vetëkënaqësie nga ana e disa individëve brenda këtij shërbimi. Ngurrimi në procedimin e raporteve informative të sigurisë dhe trysnia për të trafikuar gjësende kontrabandë brenda objekteve të burgut janë pasoja të drejtpërdrejta të një sjelljeje të tillë. Ky është problemi më akut në Dubravë.

Po ashtu ekziston nevoja që të krijohet një komunikim dhe bashkëpunim më zyrtar me Policinë e Kosovës (PK). Përderisa një memorandum i bashkëpunimit ekziston, ai duhet strukturuar më tej. Kjo gjë ka rendësi thelbësore në kuptimin e fushës dhe shtrirjes së mbështetjes së PK-së për SHKK-në posaçërisht në fushat me incidente kritike brenda objekteve, e po ashtu ndihmës dhe komunikimit me GPB-në e SHKK-së. Ende mbesin shqetësime rreth ngjarjeve të nepotizmit, nivelit të kuptimit të

korupsionit dhe pohimeve në lidhje me ndërhyrjet politike në marrjen e vendimeve në nivelet e larta të menaxhmentit.

Klasifikimi i të burgosurve. Komisioni për mbikëqyrjen e të burgosurve ka nevojë për ndihmë për shkak të llojllojshmërisë së sfidave që mund të paraqiten. Po ashtu të nevojshme janë edhe rishikimi i plotë i kornizës së rregullatorit, një metodologji që siguron përputhshmëri efektive me procedurat e klasifikimit, si dhe rishikimi i informatave për të gjithë kundërvajtësit.

Rishikimi i procedurave të plota për kategorizim dhe klasifikim të të burgosurve në të gjitha objektet do të ishte një hap thelbësor përpara. Kjo gjë do të siguronte që të burgosurit të jenë të strehuar ashtu siç duhet, duke përmirësuar kështu sigurinë dhe kushtet si për stafin ashtu edhe për të burgosurit, me një ndikim pozitiv në mundësitë për vlerësim të rrezikut.

Sistemet e Teknologjisë informative (TI). Zbatimi i disa këshillave të ndryshme administrative është i një rëndësie vitale për SHKK-në. Zhvillimi i një sistemi të centralizuar të një baze të dhënash/informatash është një projekt që kërkon ekspertizë dhe burime financiare të mëdha. Këtë gjë duhet parë si një faktor të rëndësishëm të suksesit në modernizimin e shërbimit. Mungesa e një baze të dhënash dhe e një sistemi për regjistrimin e tyre në nivel kombëtar ndikon në të gjitha fushat e mexhimit të burgjeve, administratës dhe operacioneve nga ana e SHKK-së. Investimi në teknologjinë moderne do të siguronte lidhje në mes të gjitha institucioneve dhe ZQ-së së SHKK-së. Shënimet mbi të burgosurit dhe planifikimi i vuajtjes së dënimit mund të vendosen në një linjë, informacionet e sigurisë dhe sistemet e zbulimit do të mund të zbatoheshin si dhe burimet njerëzore e shërbimet financiare do të përmirësoheshin.

Trajnimi. Trajnimi shihet si mjet kyç dhe jetik për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të SHKK-së, si në kuptim afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë, dhe po ashtu për ballafaqim me sfidat në fushën e sigurisë së burgjeve, menaxhmentit dhe administratës. SHKK-ja pranon dhe pajtohet së ka nevojë për përmirësime, pavarësisht se momentalisht ka mungesë ekspertësh me shkathtësi të duhura dhe kapacitete të kufizuara brenda shërbimit për të përmirësuar standardet e trajnimit. Për një trajnim gjithëpërfshirës të këtij shërbimi nevojitet studim, ndërsa një trajnim i tillë momentalisht është në fazën e planifikimit dhe si i tillë është hapi i parë në drejtim të adresimit të kësaj çështjeje.

Programet për të burgosurit. SHKK-ja ka nevojë për ndihmë në zhvillimin e programeve të rehabilitimit të bazuara në fakte (pikërisht për shkak të numrit në rritje të burgosurve të cilët kanë krijuar një varësi ndaj drogës), dhe trajnimeve me qëllim aftësimin profesional. Nevojitet po ashtu ndihmë në zhvillimin e nismave për t'i ndihmuar të burgosurit që kanë ndonjë dobësi dhe ata që janë me nevoja të posaçme.

Mitrovicë. Ri-integrimi i stafit dhe të burgosurve në burgun e Mitrovicës mbetet një çështje delikate, ku edhe përparimi i bërë është shumë i ulët. Transporti i të burgosurve ende kryhet nga GPB-ja e EULEX-it.

Shërbimi Sprovues i Kosovës. Shërbimi sprovues i Kosovës, një shërbim ky i pavarur nën Ministrinë e Drejtësisë, ishte ndarë nga Divizioni i menaxhimit penal të UNMIK-ut në vitin 2006. Edhe pse ky shërbim ka bashkëpunuar me shumë shtete anëtare aktualisht nuk ka mbështetje nga ndonjë ekspert i EULEX-it. NJK-ja e EULEX-it e konsideron bashkëpunimin me shërbimin sprovues

si një lidhje jetike në ri-integrimin e të burgosurve në shoqëri dhe si një alternative ndaj burgut. Ky shërbim ka treguar gatishmëri për pranimin e mëtejshëm të ndihmës nga ana e EULEX-i.

DOGANNA

Dogana e Kosovës (DK) mbetet një shërbim i themeluar mirë i cili i plotëson objektivat e tij për mbledhjen e të hyrave praktikisht çdo vit. Madje edhe në rrethana të vështira ekonomike ka arritur të mbledhë 635 milionë € ose 98,4% të të hyrave të parashikuara në vitin 2009 (30 milionë € më shumë krahasuar me vitin 2008), ose ka arritur një rritje prej 5%.

Lidhur me funksionimin e Doganës së Kosovës si institucion i sundimit të ligjit, EULEX-i e ka vlerësuar gjendjen ekzistuese dhe i ka formuluar rekomandimet për përmirësimin e efikasitetit.

Në verën e vitit 2009 ECLO e ka autorizuar hartimin e një Analize të BE-së për Boshllëqet dhe Nevojat e Strategjive të Doganës në mënyrë që ta vlerësojë pajtueshmërinë e shërbimeve me kriteret dhe standardet e doganës evropiane dhe për të ofruar udhëzime për planifikimin e aktiviteteve dhe të masave në drejtim të zhvillimit dhe të modernizimit të mëtejshëm të shërbimit.

Si programi i EULEX-it ashtu edhe rekomandimet e Raporteve Strategjive të ECLO/BE-së duket që i kanë drejtuar përpjekjet e Doganës së Kosovës në mënyrë efikase vitin e kaluar.

Ndonëse Raporti i Programit 2009 ka çuar te zhvillimi i planifikuar i Veprimeve MMK të EULEX-it, EULEX-i nuk i ka drejtuar të gjithat ato veprime. Në mënyrë që t'i shmanget dyfishimit të aktiviteteve, EULEX-i ka bashkëvepruar ngushtë me aktorët e tjerë, në veçanti me programin "Përkrahja e BE-së për Administratën Doganore dhe atë Tatimore" (EU-CTA), të financuar nga Komisioni Evropian, i cili ka filluar në fund të vitit 2009. Si rezultat në planin e veprimeve të EU-CTA janë përfshirë disa rekomandime të EULEX-it. Në disa raste, vetë Dogana e Kosovës ka ndërmarrë veprime në pajtim me rekomandimet dhe në rastet kur Komponentës së Doganës të EULEX-it i kanë munguar shkathtësitë apo ekspertiza specifike, Dogana e Kosovës ka mundur të llogarisë në ndihmën afatshkurtër të Instrumentit për Asistencë Teknike dhe Këmbim të Informatave të Komisionit Evropian (KE TAIEX).

Kodi për Doganë dhe Akcizë i Kosovë tashmë ka hyrë në fuqi në nëntor 2008 ndërsa Udhëzimi Administrativ që e përcakton zbatimin e Kodit është aprovuar dhe ka hyrë në fuqi në shtator 2009. Është arritur përparim i mirë në shqyrtimin e rregullave, të rregulloreve, të udhëzimeve dhe të direktivave të mëparshme doganore, përfshirë udhëzimet administrative në pajtim me legjislacionin e ri për doganë. Dogana e Kosovës është në dijeni që duhet të bëhet përditësimi i rregullt i të gjitha rregulloreve në mënyrë që të garantohet zbatimi unik i legjislacionit doganor. Sa i përket luftimit të piraterisë dhe falsifikimit, Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave Intelektuale (DI) ka hyrë në fuqi në dhjetor 2009 dhe procesi i hartimit të dispozitave zbatuese është në fazën përfundimtare. Ka filluar hartimi i ndryshimeve të Kodit për Doganë dhe Akcizë në mënyrë që t'i përfshijë nenet specifike të cilat e rregullojnë mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave në Doganë.

Edhe pse është pritur që Bordi i Pavarur për Shqyrtim (BPSH) do të bëhet funksional deri në mesin e vitit, nuk është arritur asnjë përparim në këtë aspekt dhe numri i ankesave të pashqyrtuara dhe të papërpunuara është ende duke u rritur. Prandaj vlen përfundimi i Analizës së BE-së për Boshllëqet dhe Nevojat e Strategjive të Doganës, i verës 2009, i autorizuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë: "vonesat do t'i shkurajojnë tregtarët nga paraqitja e ankesës lidhur me vendimet e doganës (në veçanti në rastin e përcaktimit të vlerës doganore) ashtu siç kanë të drejtë ligjore dhe në këtë mënyrë do t'i nxisin praktikën korruptuese". Gjatë takimit të Bordit të Përbashkët për Bashkërendimin e Sundimit të Ligjit (BPBSL) të mbajtur në maj 2010, Qeveria e përsëriti zotimin e saj që t'i mënjanojë pengesat në mënyrë që organi i ankesës të funksionojë si duhet.

Këshilltarët e EULEX-it e koordinojnë punën ngushtë me ekspertët e programit EU-CTA dhe me ekspertët afatshkurtër të TAIEX-it. EU-CTA së fundi e ka përfunduar vlerësimin e nevojave për aftësim në fushën e funksionimit dhe të menaxhimit, si vazhdim i ndihmës së mëhershme të TAIEX-it. Pjesa më e madhe e aftësimit, përfshirë aftësimin më të specializuar për zbatimin e ligjit, do të mund të kryhej në vend dhe/ose nga ekspertët e EU-CTA.

Përcaktimi i vlerës doganore është një fushë tjetër e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet EULEX-it, EU-CTA dhe personelit përkatës të Doganës së Kosovës, pasi që kjo është çështja kryesore juridike që ka ndikim të drejtpërdrejtë në mbledhjen e të hyrave. Mund të nevojitet ndihmë e mëtejshme në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i unifikuar i rregullave të përcaktimit të vlerës; e njëjta gjë vlen për zbatimin e auditimit pas zhdoganimit.

Si Raporti i Programit 2009 i EULEX-it ashtu edhe Analiza e Strategjisë Doganore të BE-së e theksojnë nevojën për sistem të integruar të burimeve njerëzore (BNJ): *"Sistemet e personelit të BNJ janë të pasigurta dhe të dobëta. Ato nuk janë të lidhura ndërmjet BNJ, Sektorit të Aftësimeve ose të sektorëve të tjerë, të cilët duhet të kenë qasje në ndonjë mënyrë përveç asaj manuale ose përmes postës elektronike. Kjo e fundit nuk e mundëson bartjen e sigurt të të dhënave sekrete."* Në këtë aspekt nuk është bërë ndonjë përparim i madh, edhe pse janë kërkuar zgjidhjet e mundshme. Një sistem i ngjashëm me Sistemin Informativ për Menaxhimin e Resurseve (SIMR), i cili i është ofruar Policisë Shqiptare me ndihmën e KE-së, me integrimin e financave, të buxhetit, të moduleve për menaxhimin logjistik/të inventarit dhe të depos, do t'i plotësonte nevojat e Doganës së Kosovës.

Komponenta e Doganës e EULEX-it ka rekomanduar fuqishëm zëvendësimin e Sistemit aktual për Menaxhimin e Informatave Tregtare, ashtu siç përmendet edhe në Analizën e BE-së për Strategjitë e Doganës. Vendimi i Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, pas vlerësimit të brendshëm të Doganës së Kosovës lidhur me funksionalitetin e disa sistemeve, për ta zëvendësuar atë me Sistemin Informativ të Integruar të Doganës (SIID), i cili është në pajtueshmëri me BE-në, i zhvilluar nga UNCTAD (Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin) mund të ketë ndikim pozitiv në efikasitetin e Doganës së Kosovës. Përveç aspektit funksional të procedimit të përmirësuar digjital të dokumenteve (p.sh. informatat para arritjes, procedurat e transitit, deklaratat e importit dhe të eksportit) kjo duhet ta mundësojë futjen në përdorim të konceptit të një sporteli; me përfshirjen e mundësive (të shumë agjencive) për menaxhimin e rrezikut do të mund të përmirësonte zgjedhjen e kontrolleve doganore duke e zbuluar në këtë mënyrë tregtinë e paligjshme dhe krimin e rëndë.

Përfaqësimi i pakicës etnike (12%) dhe ai gjinor (24% femra) në Burimet Njerëzore të Doganës së Kosovës ka mbetur mjaft stabil, ndërsa numri i plotë i personelit është rritur pak me 30 zyrtarë në vitin 2009. Për këtë vit është caktuar procesi i ri i rekrutimit të edhe 50 zyrtarëve dhe është shpallur në konkurs pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të DK-së (DP); procesin e zgjedhjes do ta monitorojë EULEX-i në pajtim me mandatin e tij.

Integrimi i Strategjive Qeveritare në Planet Operative.

Vlerësimi fillestar i planeve operative të drejtorive për vitin 2009, i kryer nga EULEX-i, ka zbuluar një llojllojshmëri të konsiderueshme të standardeve. Në disa raste aktivitetet kryesore janë përkufizuar shumë gjerësisht dhe atyre ju ka munguar referenca për rezultate të qarta. Në shumë aspekte ato ishin shumë të përgjithësuara dhe nuk i referoheshin afateve specifike kohore. Në përgjithësi, dukej që nuk kishte integrim apo konsolidim të planeve operative në një plan të vetëm, me objektiva të caktuara qartë për tërë Doganën e Kosovës.

Analiza e Strategjive të Doganës 2009 e kryer nga BE ka ardhur në përfundime të ngjashme, p.sh. mungesa e një plani operativ (të veprimit) në nivelin e DP i cili është i lidhur me planin strategjik, përveç në nivelin më të ulët të Drejtorit, dhe përkufizimi i paqartë i përgjegjësisë.

Si përgjigje ndaj këtyre dobësive të vërejtura është vendosur që Veprimi MMK të përqendrohet në përditësimin e planeve operative, përfshirë integrimin e strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) dhe të strategjisë kundër Krimin të Organizuar (KO). Ky Veprim MMK ka për qëllim mentorimin dhe këshillimin e Doganës së Kosovës lidhur me përditësimin e kornizës strategjike dhe të planeve operative, përfshirë integrimin e planeve të ndryshme të Drejtorive në një plan të konsoliduar i cili i përkufizon qartë objektivat dhe përgjegjësitë. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet përfshirjes së të gjitha elementeve të Strategjisë të aprovuar nacionale MIK (maj 2009) dhe të Strategjisë kundër KO (korrik 2009).

Rezultatet kryesore që kërkohen sipas Veprimit MMK e përfshijnë një Kornizë të përditësuar Strategjike të Doganës së Kosovës 2009-2011 (përfshirë strategjinë MIK dhe atë kundër KO), të Planeve Operative të Drejtorive të Doganës së Kosovës (Zbatimi i ligjit, Operacionet e të hyrave, çështjet ligjore dhe financiare) për vitin 2010, dhe garantimin që Strategjia MIK e Doganës dhe Strategjia KO janë në dispozicion dhe plotësisht të integruara në Kornizën Strategjike të Doganës dhe në Planet Operative.

Ky Veprim MMK është i lidhur me veprimin e DK-së si përgjigje ndaj analizës së KE-së lidhur me boshllëqet dhe nevojat e planeve të doganës të KE-së, sidomos lidhur me treguesit e organizimit dhe të menaxhimit (përfshirë fushën e planifikimit dhe të raportimit).

Në fillim të vitit 2010, Dogana e Kosovës ka hartuar një Kornizë Operative Strategjike (KOS) për periudhën 2010-2012. Kjo KOS është vlerësuar nga këshilltarët e EULEX-it në mars 2010 dhe komentet i janë dërguar Doganës së Kosovës. Dukej që dokumenti ishte përqendruar në masë të madhe në vitin aktual, kështu që i mungonte vizioni specifik dhe fushat kryesore të përmbushjes për periudhën e menduar për tri vjetët e ardhshëm. Në rekomandime përfshihet kërkesa për strukturimin e KOS-it në "Vizion, Mision, Vlera dhe Qëllime Strategjike" ndërsa i zhvillon tri strategjitë kryesore: biznes/klient, strategjinë për zbatimin e ligjit (përfshirë kontrollin e doganës) dhe atë për resurse. Planet e veprimit ose planet operative pastaj do t'i kishin teorikisht afatet e njëjta kohore si edhe KOS-i. Versioni përfundimtar i KOS-it është nxjerrë; në ndërkohë Dogana e Kosovës e ka hartuar një Plan të Veprimit 2010; natyra integruese e këtij plani të ri të përbashkët ishte e dobishme, meqë ajo e shfrytëzon KOS-in. Megjithatë, sipas KOS-it të aprovuar ndoshta do të duhet të ndryshohet edhe më tej.

Edhe pse janë përmendur strategjia MIK dhe ajo për krimin e organizuar mbetet përshtypja që ato ende nuk janë zhvilluar plotësisht në Plan të Veprimit. EULEX-i sugjeron që KOS-i dhe Planet e Veprimit duhet të zhvillohen në fillim të vitit paraprirës dhe me një pjesëmarrje më të madhe (p.sh. edhe brenda Doganës dhe, kur është e mundur, edhe me aktorët e jashtëm). Për më tepër, sugjerohet që të bëhet ndryshimi i procesit përgatitor dhe që grupi punues të krijohet nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, në mënyrë që hartimi i KOS-it dhe i Planit të ardhshëm të Veprimit të fillojë në fund të verës 2010.

Përmirësimi i komunikimit të brendshëm.

Raportet e Doganës së EULEX-it e theksojnë përparimin e kufizuar në fushën e përmirësimit të komunikimit të brendshëm dhe të rrjedhës së informatave. Vlerësimi i EULEX-it ka zbuluar që disponueshmëria dhe shfrytëzimi i të dhënave të zbulimit në Doganën e Kosovës mbeten relativisht të papërpunuara dhe që ekziston nevoja për rritjen e reagimit operativ në fushën e krimit të rëndë/të organizuar. Po ashtu është zbuluar që Doganës së Kosovës i mungon baza gjithëpërfshirëse e të dhënave e cila është në pajtim me nevojat e saj për zbulim. Këtyre problemeve ju shtohet fakti që komunikimi, shpërndarja e informatave të zbulimit dhe këmbimi i të dhënave ndërmjet Drejtorisë për Sundimin e Ligjit dhe të asaj për Operacione të të Hyrave duket se kanë nevojë për përmirësim.

Në mënyrë që ta mbushë këtë boshllëk EULEX-i ka filluar një Veprim MMK mbi "shtimin e komunikimeve të brendshme dhe të këmbimit të të dhënave, në mënyrë specifike të komunikimeve dhe shpërndarjes së informatave të mbledhura nga zbulimi". Objektivi i përgjithshëm është mentorimi dhe këshillimi i Drejtorive të Doganës së Kosovës për Zbatimin e Ligjit dhe për Operacione të të Hyrave mbi shtimin e komunikimit të tyre të brendshëm dhe të këmbimit të të dhënave. Në mënyrë specifike ky objektivi referohet komunikimit dhe shpërndarjes të informatave të zbulimit, si edhe këmbimit të të dhënave në mënyrë që të merren me krimin e organizuar në mënyrë pro-aktive, dhe identifikimit të grupeve kriminale që janë në shënjestër. Po ashtu do ta shtonte kapacitetin e DK-së në profilizimin dhe përparimin e vlerësimit të rrezikut dhe të përzgjedhjes së kontrolleve.

Gjatë kërkimit të objektivit të përgjithshëm të Veprimit MMK janë identifikuar pesë përfundime kryesore:

- 1) Një veprim lidhur me nevojat e shfrytëzuesve nga Drejtoria për Zbatimin e Ligjit e DK-së me qëllim që t'i miratojë parimet dhe praktikën e "Punës policore të bazuar në inteligjencë" (PBI) si edhe ta zbatojë Modelin Nacional të Zbulimit si procedurë standarde të operimit (PSO);
- 2) Një plan i progresit për ta monitoruar zbatimin e direktivave të aprovuara të zbulimit;
- 3) Një bashkëpunim i shtuar me Policinë e Kosovës për këmbimin e informatave në nivelin e politikave dhe në atë operativ (përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit), në mënyrë që ta ndalojnë krimin e organizuar dhe grupet kriminale në mënyrë pro-aktive.
- 4) Planet e konsoliduara operative (2010) të Drejtorive për Zbatimin e Ligjit dhe për Operacione të të Hyrave do t'i pasqyrojnë nevojat dhe zbatimin e mekanizmave specifik për këmbimin e të dhënave ndërmjet Drejtorive.
- 5) Duhet të zbatohen veprimet nga takimet e sapokrijuara të përmuajshme të Drejtorisë për Sundimin e Ligjit dhe të asaj për Operacionet e të Hyrave.

Ka pasur përparim të kufizuar në zhvillimin e këtij veprimi po ashtu për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme njerëzore në kuadër të Komponentës të Doganës së EULEX-it. Në pranverë 2010 EULEX-i ka ndarë më shumë burime dhe zbatimin e plotë të Veprimit MMK do të fillojë gjatë verës. Zyrtarët e Doganës së Kosovës, për më tepër, tashmë janë përfshirë në modulet e aftësimit të cilat janë duke u ofruar nga Projekti i Binjakëzimit i KE-së "Forcimi i Sundimit të Ligjit" me Policinë Kufitare të Kosovës. Në këto aftësime përfshihet aprovimi i parimeve të punës policore të bazuar në inteligjencë; informatat e para kthyese nga ky aftësim tregojnë që zyrtarët doganorë janë duke e kryer punën në mënyrë pozitive.

Bashkëpunimi me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit.

Ky Veprim MMK përqendrohet në Drejtorinë Ligjore dhe në atë për Zbatimin e Ligjit të Doganës së Kosovës në mënyrë që ta intensivizojë bashkëpunimin me agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit, në veçanti me Prokurorinë Publike.

Gjatë ndjekjes së këtij objekti të përgjithshëm është arritur pajtimi që Dogana e Kosovës të përpiqet t'i arrijë shtatë rezultate kryesore:

- 1) Një program të aktivitetit që e drejton Drejtorinë e DK-së për Zbatimin e Ligjit gjatë krijimit dhe zbatimit të marrëveshjeve dhe të protokolleve me homologët e PK-së në mënyrë që të ndërmarrin veprime të përbashkëta për zbatim.
- 2) Një program aftësimi i përbashkët i policisë dhe i doganës mbi krimin e organizuar për vitin 2010 do të zbatohet si pjesë e Planit Qeveritar të Veprimit kundër Krimin të Organizuar.
- 3) Një njësi e re në Drejtorinë Ligjore që funksionon si duhet, e krijuar në veçanti për ndërlidhje dhe bashkëpunim me Prokurorinë Publike dhe për të ofruar këshilla juridike në kuadër të DK-së në lidhje me procedurat para-hetimore.
- 4) Zhvillimi i bazës ligjore që i jep DK-së kompetenca për ta hetuar krimin e organizuar që ka të bëjë me doganën (Kodi për Doganë dhe Akcizë i ndryshuar dhe i plotësuar si duhet).
- 5) Një rishikim i memorandumeve ekzistuese të mirëkuptimit dhe i organizimit operativ, përfshirë rekomandimet për zgjerim të mëtejshëm sipas nevojës.
- 6) Krijimi i marrëveshjeve dhe i protokolleve mbi ndihmën reciproke dhe bashkëpunimin me disa shërbime doganore të BE-së dhe të vendeve të tjera, me qëllim që ta zhvillojë bashkëpunimin e qëndrueshëm në luftimin e aktiviteteve kriminale.
- 7) Zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet DK-së dhe agjencive të tjera për zbatimin e ligjit (p.sh. policisë, prokurorisë) në nivelin e politikave, në mënyrë që ta sigurojë një bashkëpunim funksional mbi krimin e organizuar. Për këtë qëllim duhet të nënshkruhet një memorandum i mirëkuptimit me Policinë dhe Prokurorinë Publike dhe në këto dokumente duhet të ketë dispozita që kanë të bëjnë me takimet e rregullta dhe këmbimin e rregullt të informatave.

Ky Veprim MMK ka lidhje të drejtpërdrejtë me Veprimin tjetër MMK për Doganë "Zbatimi i Planit të Veprimit për MIK", sidomos në lidhje me bashkëpunimin dhe bashkërendimin në fushën e luftimit të krimin të

organizuar.

Edhe pse pajtimi për detyrat kryesore është arritur me vonesë për shkak të burimeve të kufizuara të EULEX-it, është arritur përparim në zbatimin e këtij Veprimi. Dogana e Kosovës e ka krijuar një plan për veprimin e përbashkët me Policinë e Kosovës për ta hetuar importin dhe eksportin e paligjshëm të shumave të mëdha të parave nga udhëtarët në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. "Operacioni Kontrolli i Parave të Gatshme" ka filluar në fund të prillit 2010 dhe është dëshmuar që është efikas.

Është marrë vendimi për krijimin e një Njësie të re në kuadër të Drejtorisë Ligjore të Doganës së Kosovës për ndërlidhje dhe bashkëpunim me prokurorët publik dhe për të ofruar ndihmë juridike në lidhje me procedurat para-hetimore. Kjo Njësi nuk është ende funksionale për shkak të diskutimeve për përshkrimin përfundimtar të vendit të punës për Shef të Njesisë që ende është duke vazhduar. Njësia duhet të ketë rol këshillues në organizatë por nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive për ta mbikëqyrur Njësinë hetuese të Drejtorisë për Zbatimin e Ligjit (si përcaktohet në draftin e parë të përshkrimit të vendit të punës). Meqë kjo Njësi duhet t'i udhëheqë bisedimet me prokurorët publik parashihen përgatitjet për një memorandum të mirëkuptimit për bashkëpunimin me Prokurorinë Publike.

Është krijuar një grup punues, i cili i ka propozuar ndryshimet dhe plotësimet relevante për Kodin për Doganë dhe Akcizë, por Bordi Menaxhues i DK-së duhet të pajtohet me këto propozime. Nga EULEX-i është kërkuar të ofrojë ndihmë dhe mentorim lidhur me këtë temë në mënyrë që ta konsolidojë punën dhe ta lehtësojë dorëzimin e shpejtë të propozimeve në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

Në tetor 2009 është nënshkruar një Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet Doganës së Kosovës, të Policisë së Kosovës dhe të Administratës Tatimore të Kosovës; ai i vendosë themelet për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të tri agjencive dhe, në veçanti, për mbështetje reciproke në fushat siç është logjistika, burimet njerëzore dhe këmbimi i informatave të zbulimit.

Aktivitetet e doganës mbi bashkëpunimin ndërkombëtar dhe marrëveshjet për ndihmë reciproke janë duke u përgatitur që nga viti 2009. Këto marrëveshje janë në faza të ndryshme. Një marrëveshje bilaterale me Shqipërinë është nënshkruar në tetor 2009 dhe ato me Turqinë dhe Malin e zi janë nënshkruar në janar përkatësisht në mars 2010. Një marrëveshje me Finlandën është e gatshme për nënshkrim dhe bisedimet janë duke u zhvilluar me Shërbimin Doganor të Italisë, atë të Kroacisë dhe të Polonisë.

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK).

Strategjia Nationale mbi MIK– në harmoni me Direktivat e Komisionit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Kufirit në Ballkanin Perëndimor – e përfshinë bashkëpunimin shtetëror dhe ndërkombëtar me qëllim që ta ndalojë krimin ndërkufitar dhe krimin e organizuar. Për këtë qëllim, Plani i Veprimit për Doganën e Kosovës i ka përfshirë disa fusha të zhvillimit, siç është korniza ligjore, procedurat e organizimit dhe të menaxhimit, burimet njerëzore dhe aftësimi, komunikimi, teknologjia informative dhe infrastruktura dhe pajisjet.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Veprimi MMK është mentorimi dhe këshillimi i personelit të Doganës së Kosovës lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe në veçanti për veprimet që janë përgjegjësi e Doganës së Kosovës, me theks të posaçëm në përmirësimin e infrastrukturës dhe të pajisjeve në stacionet doganore.

Në ndjekje të këtij Veprimi MMK, EULEX-i i ndihmon Doganës së Kosovës në punën e saj për t'i arritur katër objektivat kryesore.

1. Krijimi i një plani të përbashkët për zhvillimin e infrastrukturës dhe të pajisjeve në vendkalimet kufitare dhe në pajtueshmëri me MIK.
2. Vendosja e shkallës aktuale të bashkëpunimit dhe të bashkërendimit në aktivitetet operative përmes

organizimit dhe menaxhimit në vendkalimet kufitare.

3. Zbatimi i plotë i planit aktual të përbashkët të aftësisë në nivelin operativ.

4. Të siguruarit që niveli i komunikimit dhe i këmbimit të informatave operative është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm.

Ky Veprim MMK lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e Strategjisë Nacionale mbi Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe me Planin e Veprimit që ka të bëjë me të, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet agjencive me agjencitë e tjera të përfshira në të (Policia Kufitare, Agjencia e Veterinës dhe e Ushqimit) dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Edhe pse bashkëpunimi ndërmjet agjencive për MIK mbetet i kufizuar dhe marrëveshjet bilaterale kryesisht e mbulojnë bashkëpunimin ndërmjet agjencive të ngjashme (p.sh. shërbimet doganore), është arritur ca përparim në zbatimin e atyre veprimeve "brenda" agjencisë të Doganës së Kosovës që kanë të bëjnë me MIK (p.sh. hartimi i udhëzimeve administrative ose procedurat e aplikueshme të operimit). Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës janë pajtuar që t'i këmbëjnë të dhënat e kontrollit (kur të përfundojë përditësimi i sistemit të teknologjisë informative në DK); kapaciteti i harduerit të TI-së në vendkalimet kufitare tashmë është përmirësuar. DK i ndanë objektet e kontrollit (dhomën e operacioneve, CCTV) me Policinë Kufitare të Kosovës dhe në disa korsi të vendkalimeve kufitare janë ndërtuar kabina të përbashkëta me qëllim që gradualisht ta fusin në përdorim këtë koncept në të gjitha vendkalimet kufitare ku teknikisht është e mundur të bëhet kjo.

SHOQËRIA CIVILE

SHOQËRIA CIVILE NË VEPRIMET MMK

Shoqëria civile ndikon tërthorazi në aktivitetet MMK të të gjitha komponentëve. Ndonëse nuk ka ndonjë Veprim MMK mbi partneritetet me organizatat vendase joqeveritare, në shumë dokumente programore thuhet që bashkëpunimi me vëzhguesit e Kosovës ishte i kënaqshëm. Si rezultat i këshillimeve me aktorët e shoqërisë civile, me institucionet e Kosovës dhe me personelin MMK të EULEX-it, në qasjen programore janë përfshirë një numër i rezultateve dhe i aktiviteteve të veprimeve të ndryshme të MMK duke e përmendur në mënyrë të posaçme shoqërinë civile.

Sa ju përket çështjeve gjyqësore, aktivitetet programore i konsiderojnë organizatat joqeveritare si partnerë për këshillime lidhur me çështjet e veçanta të MMK, duke u përpjekur në këtë mënyrë t'i nxisin ndërveprimet ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve vendase të sundimit të ligjit.

Megjithëse aktorët joqeveritarë kanë rol të kufizuar në aktivitetet MMK të doganës – dhe nuk përmenden në mënyrë specifike në Veprimet MMK të komponentës – roli i tyre në Programin MMK për Policinë është më i dallueshëm.

Ndërlidhja e Veprimeve MMK të EULEX-it me shoqërinë civile

KOMPONENTA E DREJTËSISË E EULEX-IT

Veprimi MMK	Ndërlidhja e shoqërisë civile
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Bashkëpunimi i KGJK-së me shoqërinë civile në takimet e rregullta dhe përfshirja e shoqërisë civile në procesin e reformave në drejtësi.
Prokurorët	Prokurorët e EULEX-it dhe të Kosovës duhet t'i informojnë rregullisht homologët përkatës të shoqërisë civile lidhur me gjendjen e përgjithshme të rasteve të sjelljes së keqe gjyqësore.
Shërbimi Korrektues i Kosovës	Disa OJQ janë duke punuar në sferën e shërbimeve korrektuese dhe gjetjet e tyre do të merren parasysh nga EULEX-i.

KOMPONENTA E POLICISË E EULEX-IT

Veprimi MMK	Ndërlidhja e shoqërisë civile
Strategjia për Zvogëlimin e Krimin	Procesi i këshillimit të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, i zhvilluar në faza, për hartimin e strategjisë së shkruar për zvogëlimin e vëllimit të përgjithshëm të krimin dhe të numrit të disa krimeve kryesore.
Përmirësimi i menaxhimit të patrullave	Ofrimi i ndihmës PK-së për ta menaxhuar si duhet shpërndarjen e burimeve për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetet për shërbime policore; dhe të këshilluarit me komunitetet lokale lidhur me objektivat e patrullimit.
Planet vjetore për patrullime – stacionet policore	Secili komandant i stacionit duhet ta krijojë një listë të objektivave për ta drejtuar shfrytëzimin efikas të patrullave me uniformë, në bazë të shqetësimeve të përfaqësuesve të komunitetit lokal.
Shërbimet policore në bashkësi	Të zhvilluarit e shërbimeve policore në bashkësi dhe të një mekanizmi raportues, duke e lidhur strategjinë e PK-së për shërbimet policore në bashkësi me nevojën për këshillime me komunitetin lokal në Ligjin për Policinë.

Plani për shpërndarjen e burimeve

Të siguruarit e mbajtjes dhe të përkrahjes së sundimit të ligjit, duke i ndihmuar PK-së ta menaxhojë si duhet shpërndarjen e burimeve si përgjigje ndaj nevojave të komunitetit për shërbime policore.

Përveç përmendjes specifike të përfshirjes së shoqërisë civile në Veprimet MMK, EULEX-i është përpjekur ta përkrahë ndërgjegjësimin e qasjes programore në mesin e organizatave të interesuara joqeveritare (OJQ-ve). Për këtë qëllim, më 15 dhjetor 2009 është organizuar një punëtori që kishte për synim përvijimin e përmbajtjes së Veprimeve MMK dhe kërkimin e informatave kthyesë të dobishme dhe konstruktive nga aktorët e shoqërisë civile. Të ftuara ishin gjithsej 44 OJQ të cilat u njoftuan nga personeli i EULEX-it dhe nga homologët e Kosovës lidhur me katalogun e veprimeve në Drejtësi, në Polici dhe në Doganë. Shumica e pjesëmarrësve ishin të interesuar në prezantimin e Veprimit MMK të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili u bë nga një këshilltar i EULEX-it në KGJK dhe nga 5 anëtarë të KGJK-së.

Qasja programore në kontekst. Qasja programore e misionit në përgjithësi ka marrë informata kthyesë pozitive nga OJQ-të vendase. Një vlerësim i kryer në mesin e organizatave të shoqërisë civile nga ana e Zyra për Programe dhe Politika të EULEX-it pas marrëveshjes për Protokollin e Policisë me Republikën e Serbisë (shtator 2009) ka zbuluar zhgënjim të madh me misionin. Çështja e protokollit mund të merret si shembull se si marrëdhëniet me shoqërinë vendase civile janë të paqëndrueshme dhe mund të ndikohen nga ngjarjet të cilat nuk kanë të bëjnë me fushën MMK.

Si rrjedhojë, në javët pasuese pas nënshkrimit të Protokollit për Policinë, Zyra për Programe ka pasur vështirësi në kontaktimin me organizatat të cilat më parë e kishin shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me EULEX-in, duke shkaktuar në këtë mënyrë ndërprerje të bashkëpunimit normal për çështjet MMK.

Një situatë e ngjashme u krijua edhe në shkurt 2010, kur filloi gjykimi kundër z. Albin Kurti, udhëheqësit të lëvizjes Vetëvendosje. Misioni pranoi një deklaratë të përbashkët të 13 organizatave joqeveritare, e cila tregonte shenja të një hutimi në rritje lidhur me prioritetet e zgjedhura të misionit. Deklarata, e lëshuar më 9 shkurt, u nënshkrua nga disa prej vëzhgueseve më aktiv shqiptarë të Kosovës, të cilët u ftuan më 16 shkurt që t'i këmbëjnë këndvështrimet e tyre me zyrtarët e EULEX-it. Në anën tjetër, në mesin e pjesëmarrësve u vërejt një shkallë e përgjithshme e kënaqësisë me aktivitetet programore të EULEX-it, të cilët megjithatë theksuan që mungesa e vazhdueshme e rezultateve konkrete, e ndërprerë me veprime të tilla siç është çështja e Protokollit ose gjykimi i Kurtit, do të kishin për pasojë rënien e mbështetjes së shoqërisë civile për përpjekjet MMK të EULEX-it.

Për kontrollet e fundit në Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit të Kosovës, të kryera nga Policia e EULEX-it, shoqëria vendase civile dha komente pozitive: shumë OJQ të cilat e nënshkruan deklaratën e përbashkët në shkurt e shprehën "mbështetjen e tyre të plotë për Prokurorinë Speciale të Kosovës dhe EULEX-in në zotimin e tyre për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë" në një deklaratë të re të përbashkët të lëshuar më 13 maj. Përveç vlerësimit të tyre për hetimet që janë duke u zhvilluar, OJQ-të rekomanduan që të ketë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet hetueseve të EULEX-it dhe të atyre të Kosovës në aktivitetet kundër korrupsionit, duke e treguar kështu një interesim të përqendruar në partneritetet programore ndërmjet misionit dhe të autoriteteve të Kosovës.

Institucionet për sundimin e ligjit, në veçanti lufta kundër korrupsionit, mbesin prioritet i lartë për shumë organizata joqeveritare në Kosovë; gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar ka pasur shumë analiza, raporte dhe rekomandime të politikave lidhur me këto tema. OJQ-të kanë treguar një kapacitet të jashtëzakonshëm në identifikimin e anëve të mira dhe të dobësive të mekanizmave të Kosovës për sundimin e ligjit.

Në mesin e publikimeve të ndryshme të nxjerra gjatë periudhës raportuese, e vlen të përmendet "Trekëndëshi i brishtë: koordinimi i policisë, i gjykatësve dhe i prokurorëve gjatë procedurës penale në Kosovë", i nxjerrë nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) në shkurt 2010. Raporti merret me të metat e zbuluara gjatë rrjedhës së komunikimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për hetime penale. Një plan i cili do t'i paraqiste në hollësi burimet njerëzore dhe financiare për trajtimin e nevojave të sistemit gjyqësor të Kosovës – së bashku me një bazë të përbashkët të të dhënave për ruajtjen dhe bashkërendimin e të gjitha rasteve penale në Kosovë – është rekomandimi kryesor i raportit, i cili i prekë çështjet thelbësore të disa veprimeve MMK të EULEX-it në Komponentën e Drejtësisë dhe në atë të Policisë.

'Lëvizja FOL' një nismë qytetare me seli në Prishtinë ka filluar një varg të raporteve mbi aktivitetet kundër korrupsionit, duke ofruar shifra për rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe një analizë të të arriturave nga aktorët institucionalë të përfshirë në luftën kundër korrupsionit. FOL e ka pranuar përkushtimin e EULEX-it në këtë fushë, duke e përmendur në buletin e shkurtit 2010 numrin e rasteve të krimit të organizuar me të cilat është marrë misioni deri tani, si edhe duke i përmendur aktivitetet e tjera relevante të EULEX-it. Edhe pse nganjëherë ka pasur qëndrim kritik ndaj misionit (FOL ishte në mesin e OJQ-ve të cilat e kanë nënshkruar deklaratën e përbashkët të shkurtit 2010 të përmendur më sipër), FOL ka qenë në dispozicion për këmbime të rregullta të këndvështrimeve dhe të informatave me misionin dhe ka raportuar në mënyrë objektive në publikimet e veta.

'Instituti Demokratik i Kosovës', ka themeluar një grup këshillimor, duke e kopjuar modelin e Sistemit Nacional të Integritetit i cili është zbatuar nga Transparency International në shumë vende. Grupi Këshillimor i mbledhë institucionet dhe organizatat të cilat janë të përkushtuara për luftimin e korrupsionit dhe e shqyrton legjislacionin, strategjitë dhe praktikën përkatëse. Ndonëse misioni ka vendosur të mos marrë pjesë në Grupin Këshillimor, megjithatë do t'i përkrahë kërkimet që kanë të bëjnë me këtë temë dhe ka shprehur gatishmërinë për t'i diskutuar rezultatet e projektit.

REKOMANDIMET E KORRIKUT 2009

Nëse rekomandimet teknike për homologët institucionalë të EULEX-it janë adresuar drejtpërdrejt përmes hartimit dhe zbatimit të veprimeve specifike MMK, të katër rekomandimet e shënuara në kapitullin e shoqërisë civile (Raporti i Programit 2009) janë bërë çështje të ndërlidhura të cilat do të trajtoheshin nga misioni dhe partnerët vendas të tij kurdo që të ishte e përshtatshme. Paragrafi në vijim e shtjellon përparimin e arritur në secilin prej katër rekomandimeve, duke i nënvizuar veprimet dhe palët e përfshira.

REKOMANDIMI I EULEX-it 2009

Të inkurajojë dialog dhe shkëmbim të informacionit me qëllim të identifikimit dhe fuqizimit të qëllimeve dhe synimeve të përbashkëta. MD dhe SHKK të fusin politikën e llogaridhënies dhe me këtë të sigurojnë publikun se ato janë në përputhje me procedurat.

Ky rekomandim bazohet në rezultatet e paraqitura në Raportin e Programit 2009 të EULEX-it dhe është përmendur në studimet e kryera nga organizatat joqeveritare mbi standardet operative në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Raportet e vitit 2008 të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRT) mbi standardet e të drejtave të njeriut në qendrat korrektuese, në qendrat e paraburgimit dhe në dhomat e policisë për ndalime ishin një burim veçanërisht i saktë i informatave mbi Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe aty janë paraqitur disa fusha të cilat duhej të përmirësoheshin. Raportet e QKRT-së të vitit 2008

nuk kanë mundur ta testojnë kontributin e EULEX-it në këtë fushë, pasi që misioni ka filluar të funksionojë në dhjetor 2009. Prandaj kërkimi i kryer nga kjo OJQ më 2009 është një tregues i mirë i përmbushjes së EULEX-it kundruall udhëheqjes së qendrave të paraburgimit. Megjithëse larg nga përmbushja e standardeve optimale, QKRT në raportin e vitit 2009 mbi standardet e të drejtave të njeriut tregon se ka përmirësime në qendrat korrektuese, në qendrat e paraburgimit dhe në dhomat e policisë për ndalime. Në disa qendra janë përmirësuar kushtet higjienike dhe po ashtu është shënuar ca përparim i vogël në infrastrukturë. QKRT e ka mirëpritur rënien e rasteve të keqtrajtimit të pohuar të të burgosurve nga personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës. Edhe pse monitoruesit e QKRT-së ende i theksojnë pohimet e përdorimit të tepruar të forcës nga Njësia për Intervenime Speciale e QKK-së, niveli i pohimeve të tilla ka qenë më i ulët se vitin e kaluar. Duket që QKRT ka zbuluar një lidhje ndërmjet aktiviteteve MMK të EULEX-it dhe këtyre prirjeve, duke e përfunduar përvijimin e vet me një vlerësim pozitiv “të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) i cili kohët e fundit ka filluar t’i mentorojë këto njësi”.

REKOMANDIMI I EULEX-it 2009

Përmirësimi i dialogut dhe i komunikimit me qëllim të adresimit të shqetësimeve dhe të përmirësimit të llogaridhënies për komunitetet e serbëve të Kosovës

Gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar aktivitetet programore të EULEX-it po ashtu i kanë marrë parasysh nevojat e komunitetit serb të Kosovës, duke e siguruar qasjen në shërbimet e sundimit të ligjit të Kosovës dhe duke e përkrahur ndërgjegjësimin lidhur me strategjitë MMK të misionit. Në punëtorinë e organizuar në dhjetor 2009 me qëllim që t’i prezantohet shoqërisë civile niveli i veprimeve MMK në fushën e policisë, të drejtësisë dhe të doganës, kanë marrë pjesë po ashtu edhe organizatat joqeveritare serbe. Pjesëtarët serbë ishin kryesisht të interesuar për planet lidhur me policinë dhe gjyqësorin, duke e konfirmuar natyrën e pritjeve të këtij komuniteti në lidhje me sundimin e ligjit.

Të ndërtuarit e besimit në mesin e qytetarëve serbë të Kosovës ndaj policisë dhe gjyqësisë vendase është njëra prej sfidave më të vështira për qasjen programore të EULEX-it. Rezultatet e procesit priren të jenë të pabarabarta dhe rastet individuale mund të ndikojnë në mënyrë dramatike në shkallën e përpjekjeve në këtë drejtim. Deri sa në njërin anë qëllimi kryesor i misionit është të punojë ngushtë me institucionet e Kosovës dhe t’i mbështes ato në zbatimin e standardeve dhe të procedurave të pajtueshme pavarësisht nga prejardhja etnike e qytetarëve, në anën tjetër nga komuniteti serb i Kosovës EULEX-i shpesh perceptohet si palë e tretë e ngarkuar me funksione të ndërmjetësimit dhe si agjenci që duhet të shfrytëzohet për zgjidhjen e kontesteve të sjelljes së pohuar të keqe nga organet e Kosovës për sundimin e ligjit. Prandaj, EULEX-i ka vazhduar t’i përkrahë marrëdhëniet me shoqërinë civile të serbëve të Kosovës në mënyrë që ta sqarojë mandatin e misionit dhe njëkohësisht t’i njoftojë qytetarët për nevojën që shqetësimet e tyre t’i drejtojnë tek organet e duhura. Për shembull, përhapja e natyrës së marrëdhënieve me Rrjetin Kosovar të Veprimit për Politikën - i cili i mbledhë përafërsisht 60 organizata joqeveritare të serbëve në mbarë Kosovën dhe të cilat tani rregullisht e përditësojnë misionin me informata dhe raporte nga shoqëria civile e serbëve të Kosovës. Në janar Zyra për Programe filloi të jetë e pranishme edhe në zyrën e misionit të EULEX-it në Mitrovicën e veriut dhe vuri kontakte me OJQ-të. Duke e pasur parasysh nivelin e kufizuar të aktiviteteve MMK në këtë rajon – shtrirja e institucioneve të Kosovës për sundimin e ligjit deri tani ka qenë e pjesshme – përpjekjet kryesisht janë përqendruar në shënimin e strukturës së shoqërisë civile vendase dhe në zbulimin e partnerëve të përshtatshëm për bashkëpunim në të ardhmen. Si gjatë në Kosovë, EULEX-i ka ndihmuar në shpërndarjen e informatave për thirrjen për propozime 2010 lidhur me Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (IEDDNJ), një program i menaxhuar nga Komisioni Evropian dhe i cili ka për qëllim përkrahjen dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut dhe të demokracisë. Nisma ju është përcjellë organizatave joqeveritare të cilat janë aktive në sundimin e ligjit dhe kanë njohuri për përpjekjet MMK të EULEX-it; Zyra për Programe i ka vazhduar diskutimet me OJQ-të e interesuara në mënyrë që t’i nxisë propozimet për projekte të cilat janë në

njëfarë mase të lidhura me veprimet përkatëse MMK ose me nismat e sundimit të ligjit. Informatat fillestare kthyesë kanë dëshmuar për një interesim të shtuar dhe gjatë muajve të ardhshëm mund të sjellin zhvillime.

Ndonëse mbetet edhe shumë për t'u bërë në mënyrë që serbët e Kosovës të integrohen më mirë në sistemin e sundimit të ligjit, gjatë periudhës raportuese janë vërejtur shenja premtuese. Pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në punën e Këshillave Komunal për Siguri të Komuniteteve (KKSK) – një tipar i ligjit të zbatueshëm – është duke u rritur në mënyrë të dukshme, si dëshmohet me hapjen e KKSK-së në Komunën e Kllokotit-Vërboc, një zonë me shumicë të banorëve serbë të Kosovës.

REKOMANDIMI I EULEX-it 2009

Të inkurajojë dialog dhe shkëmbim të informacionit me qëllim të identifikimit dhe fuqizimit të qëllimeve dhe synimeve të përbashkëta.

Konteksti i nismave ndëretnike të shoqërisë civile që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në Kosovë mbetet i kufizuar, duke e vështirësuar punën e misionit në zhvillimin e programit të tij MMK përreth partneriteteve adekuate. Sidoqoftë, ekzistojnë shenja të hershme që njëlloj bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve të shumta të Kosovës lidhur me çështjet e sigurisë po dëshmohet funksional, sidomos në nivel lokal. Qasja programore e EULEX-it në Këshillat Komunalë të Sigurisë do të mund të gjente një vend ideal për zbatimin e disa prej veprimeve MMK për Departamentin e Fuqizimit të Policisë.

Me ligj kërkohet themelimi i KKSK-ve në tërë komunat e Kosovës; ato duhet t'i organizojnë diskutimet ndërmjet autoriteteve komunale, Policisë së Kosovës dhe aktorëve të shoqërisë civile mbi çështjet e sigurisë. KKSK-të në mënyrë të hollësishme e parashikojnë përfshirjen e përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve etnike të cilat jetojnë në territorin e komunës dhe kjo është vërtetuar me praninë e përfaqësuesve shqiptarë, serbë dhe romë në mbledhjet e KKSK-së në të cilat kanë marrë pjesë zyrtarët e EULEX-it. Shumë organizata joqeveritare – përfshirë Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Institutin për Menaxhim Lindje Perëndim – kanë punuar për t'i mbështetur kapacitetet e KKSK-ve dhe EULEX-i ka kontribuar në realizimin e disa prej këtyre aktiviteteve. Një prezantim i qasjes programore të misionit është bërë në aftësimin treditor për anëtarët e KKSK-ve të organizuar nga Instituti për Menaxhim Lindje Perëndim në Vushtrri, prej 23 – 25 mars 2010. Anëtarët e KKSK-së nga Obiliqi, Peja, Mitrovica dhe Gjilani kanë marrë informata lidhur me strategjitë përkatëse të Departamentit për Fuqizimin e Policisë. Aftësimi ishte po ashtu një rast për ta planifikuar rrjetëzimin e ardhshëm me KKSK-të. Veprimet MMK të DFP, siç janë ato për planet vjetore të patrullimit, menaxhimi i përmirësuar i patrullave ose shërbimet policore në komunitet mund të përfitojnë shumë nga bashkëpunimi me këshillat.

Duke e pasur parasysh rolin kryesorë të Policisë së Kosovës në krijimin e KKSK-ve, përfshirja MMK e EULEX-it në këto struktura është një hap i natyrshëm përpara: kjo do ta zgjerojë kapacitetin e misionit për mbledhjen e informatave nga komunitetet lidhur me strategjitë MMK dhe do të kontribuojë në krijimin e ndërgjegjësimit për anën programore të misionit në mesin e bashkëbiseduesve nga shoqëria civile.

REKOMANDIMI I EULEX-it 2009

Të iniciojnë mekanizma të konsultimit formal me qëllim të adresimit të shqetësimeve të banorëve lokal.

Shumë organizata të shoqërisë civile e kanë vërtetuar interesimin e tyre për reformën gjyqësore dhe për raportet lidhur me gjendjen në degë të ndryshme. Shoqëria civile shpall veten si vëzhgues i vëmendshëm i këtyre çështjeve dhe bën thirrje që institucionet përgjegjëse, përfshirë EULEX-in, t'i përmirësojnë edhe më tej shërbimet gjyqësore. Për këtë arsye nuk është befasues dialogu i rregullt, i cili zhvillohet në nivele formale dhe jo formale, ndërmjet OJQ-ve, gjyqësorit vendas dhe personelit MMK të EULEX-it. Një takim i mbajtur më 9

shkurt 2010 kishte si rezultat komunikim më specifik me sektorët e interesuar të shoqërisë civile të Kosovës dhe të personelit të Komponentës të Drejtësisë të EULEX-it të përfshirë në çështjet MMK.

Më 17 maj 2010 është organizuar një takim joformal në të cilin ka marrë pjesë ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të misionit (dhe udhëheqësi i ekipit për veprimin MMK të prokurorëve) dhe pesë vëzhgues vendas joqeveritarë. Pas këtij takimi u vendosën kontakte me Lëvizjen "FOL" qëllimi i të cilave ishte hulumtimi i fushën së bashkëpunimit në monitorimin e rasteve të korrupsionit në nivelin e gjykatës komunale. U shqyrtuan disa propozime, në mesin e të cilave ishte krijimi i një grupi punues për çështjet e korrupsionit që do të bashkërendohej nga EULEX-i dhe të cilit do t'i bashkoheshin dy përfaqësues nga OJQ-të.

Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) i ftoi OJQ-të vendase në një prezantim të të arriturave të shënuara në raportin e saj gjashtë-mujor. Punëtorja e mbajtur më 7 tetor 2009 ishte një rast për të debatuar lidhur me përparimin dhe dështimet në disa fusha të interesit të përbashkët. Në të njëjtën temë, Kryesia e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it organizoi një prezantim më 12 maj 2010 lidhur me Raportin Vjetor mbi aktivitetet gjyqësore të EULEX-it.

Nismat e tilla janë dëshmi të përpjekjeve të misionit për të arritur funksionim transparent të institucioneve për sundimin e ligjit dhe për të vendosur praktika të cilat duhet të respektohen dhe të fuqizohen gjatë muajve të ardhshëm.

QASJA PROGRAMORE DHE SHOQËRIA CIVILE –RRUGA PËRPARA

Bashkëpunimi me shoqërinë civile në aktivitetet MMK për periudhën e ardhshme do të vazhdojë të varet nga programet e Komponentit të Policisë dhe të Drejtësisë. Bashkërendimi i përpjekjeve do të bëhet në dy nivele:

- a) *përditësimi i vazhdueshëm lidhur me përparimin e Veprimeve MMK.* Pjesa më e madhe e Veprimeve MMK janë planifikuar me afate kohore jo më gjatë se 12 muaj, prandaj paraqesin mjete të reformës afatmesme. Këmbimi i informatave me organizatat joqeveritare lidhur me tendencat për zbatim krijon mundësi për ta vërtetuar pajtueshmërinë e planeve me pritjet e shoqërisë civile. Për më tepër, një njoftim më i hollësishëm lidhur me aktivitetet programore të misionit mund t'i nxisë edhe më shumë nismat monitoruese nga OJQ-të vendase dhe ta përmirësojë bashkërendimin ndërmjet aktorëve relevantë. Shumë Veprime MMK parashohin këmbim të rregullt të informatave me aktorët e shoqërisë civile dhe takimet e sipërpërmendura ndërmjet OJQ-ve dhe përfaqësuesve të EULEX-it, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë, paraqesin një model që duhet të përsëritet në mënyrë më intensive gjatë muajve të ardhshëm.
- b) *Nismat e përbashkëta.* Partneritetet operative me organizatat vendase të shoqërisë civile mbi aktivitetet monitoruese janë dëshmuar si sfidë për disa arsye. Mungesa e fondeve të disponueshme për ta mbështetur punën e OJQ-ve do të thotë që partneritetet duhet të varen nga burimet e OJQ-ve ose nga fondet e jashtme. Për më tepër, vetëm një numër i vogël i OJQ-ve ka kapacitet të mjaftueshëm për ta mbështetur misionin në punën në terren në mbarë Kosovën. Megjithatë do të kërkohet bashkëpunim në fushat specifike duke ju referuar në mënyrë të posaçme Veprimeve MMK të Policisë: në objektiv do të jenë organizatat e shoqërisë civile të cilat janë aktive në KKSK-të e përmendura më sipër në mënyrë që t'i harmonizojnë aktivitetet përkatëse MMK me nevojat e komuniteteve specifike.

Falënderim

Raporti i Programit 2010 i EULEX-it është përgatitur nga:

Alessio Zuccarini – Shef i Zyrës për Programe

Zyra për Programe:

**Emel Abazxhik, Arben Abdurahmani,
Jesper Stig Andersen, Enisa Dervisevic, Camila Ferrini, Francis Harris,
Amir Kovaci, Annachiara La Greca,
Ardian Latifaj, Richard Lundgren,
Venera Mehmeti, Alessandro Tedesco,
Dirk Teerlinck**

Një falënderim i posaçëm për komponentën e Policisë, të Drejtësisë dhe të Doganës të EULEX-it t Zyrën e Shefit të Stafit të EULEX-it dhe Zyrën e EULEX-it për Shtyp dhe Informim Publik.

Faqosja është kryer nga:

Amir Kovaçi

Është bërë çdo përpjekje për verifikimin e saktësisë së informacionit që e përmban ky raport. Deri në qershor 2010 i gjithë informacioni besohet të ketë qenë i saktë. Megjithatë, EULEX-i nuk mund ta marr përgjegjësinë për pasojat e përdorimit të tij për qëllime të tjera ose në kontekste tjera..

© 2010 EULEX. Të gjitha të drejtat e rezervuara.